



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar auditimi financiar dhe përputhshmërie në
Bashkinë Kuçovë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË
PËRPUTHSHMËRISË
NË
BASHKINË KUÇOVË

Qershor 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-10
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
II.1.	Objekti i auditimit	10-14
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14-138
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-15
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	15-112
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	15-18
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	18-21
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	21-47
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2022	47-47
III.2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	48-111
III.2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	111-125
III.2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)	125-133
III.2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	133-138
III.2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	138-138
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	138-157
V.	ANEKSE	158-169

Shkurtime

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
DSHP	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Aksionare
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
STTV	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore
SPE	Sistemi i Prokurimeve Elektronike
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TNI	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ZK	Zonë Kadastrale

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Kuçovë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 08.02.2023 deri në datën 27.03.2023 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të Bashkisë Kuçovë” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022, auditim përputhshmërie, si dhe auditim financiar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 13 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

-Për projekt raportin e auditimit nga subjekti i audituar me shkresën nr.120/6 prot., datë 05.06.2023, janë paraqitur observacione, të cilat janë trajtuar dhe pasqyruar në Kapitullin “Anekse”. Në shkresën e konfirmimit të njohjes së projekt raportit të auditimit dhe përcjelljes së observacioneve, nga subjekti i audituar nuk është kërkuar takimi i ballafaqimit.

Në mënyrë të përmbledhur, u konstatua se në:

-11 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

-6 raste OE është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.

-2 raste në auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike të lidhura nga Bashkia Kuçovë, rezultoi se nga Bashkia Kuçovë janë kryer likujdime në vlerën **1,605** mijë lekë, për punime të pakryera, me efekt dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kuçovë.

-7 raste nuk është zbatuar plotësisht kuadri rregullator i fushës dhe sektorial, në miratimin e aplikimeve për deklarata paraprake për kryerje punimesh, lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit.

-Kontratat e qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kuçovë me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 84 subjekte debitorë për vlerën 965,162 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 116 subjekte për vlerën 21,717,246 lekë.

-Të ardhurat e realizuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022, u konstatua se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 590 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 22,093,685 lekë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga verifikimi i librezës së masave për shkollën Fshati Tapi, u konstatuan mangësi si më poshtë: - Sipas zërit 1.3 “Prishje çati ekzistuese” dhe I.12 “Çati vendi e zakonshme HD deri 8 m, mbuluar me tjegulla vendi”, është certifikuar sasia 492 m2. Nga përlllogaritjet rezulton se sipërfaqja faktike është 478 m2. Gabimi në llogaritje ka ardhur si pasojë e përfshirjes së strehës në mesin e çatisë, nga llogaritja e sipërfaqes me dy	48-111	I Lartë	Bashkia Kuçovë të marrë masa për zbritjen në situacionin përfundimtar dhe pagesën përkatëse të vlerës 1,512,112 lekë, certifikuar më tepër kontraktorit “A” Sh.P.K.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>seksione. Vlera 67,550 lekë [14 m² (495 lekë/m² + 4,330 lekë/m²)] është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>- Sipas zërit 1.10 “Shtresë mermeri 2 cm Janina”, është përlloritur sasia duke marrë në konsideratë gjatësinë e dritareve 1.6 m, ndërkohë që referuar zërit furnizim dhe vendosje dritare gjatësia është 1.45 m. Sasia 3.5 m² (10 ml x 0.35 ml), me vlerë 18,165 lekë (3.5 m² x 5,190 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Nga verifikimi i punimeve në objekt u konstatuan mangësi si më poshtë:</p> <p>- Në shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi, nuk është realizuar zëri i punimeve 3.58 “F.V shtylla metalike për ndriçim H = 7 m, d = 160 mm” në sasinë 10 copë. Vlera 188,540 lekë (10 copë x 18,854 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Sipas zërit 3.59 “Ndriçues smart 250 w, 230 v”, nga 10 të parashikuar janë vendosur vetëm 4. Vlera 140,316 lekë (6 copë x 23,386 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Nuk janë punimet sipas zërit 3.65 “F.V puseta plastike 40 x 40 cm”. Vlera 33,990 lekë (10 copë x 3,399 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Sipas zërit 3.56 “Konstruksione metalike të thjeshta për portën hyrëse”, është certifikuar sasia 1 ton. Nga përlloraritjet mbi dimensionet e realizuara në objekt, rezulton se pesha faktike është 0.19 ton. Vlera 108,345 lekë (0.81 ton x 133,760 lekë/ton) , është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Nga verifikimi sipas zërit 3.49 “Shtresë asfaltbetoni me ngjyrë, t = 4 cm...”, rezulton se nuk është realizuar shtresë asfaltbetoni, por shtresë betoni, me një shtresë boje në sipërfaqe të saj. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike dhe përcaktimet në projektin e zbatimit. Bazuar në manualet e çmimeve të punimeve të ndërtimit, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manueleve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, sipas zërit 2.262/4 “Shtresë betoni C 16/20” është përcaktuar çmimi 8,525 lekë/m³. Referuar trashësisë 4 cm, çmimi 8,525 lekë i korrespondon sasisë 25 m², duke përcaktuar një çmim të përafërt 341 lekë/m³. Duke marrë në konsideratë lyerjen e sipërfaqes së betonit sipas zërit 2.237/a “Lyerje beton me hyperdesimo”, çmimi përcaktohet 797 lekë/m². Në këto kushte, punimet e realizuara konsiderohen me çmim 1,138 lekë/m² (341 lekë/m² + 797 lekë/m²). Vlera 123,060 lekë [420 m² x 1,431 lekë/m² – 1,138 lekë/m²], është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Nuk janë realizuar zërat 3.52 “F.V porta + rrjetë basketbolli” copë 2 dhe 3.53 “F.V tabelë + rrjet volejbolli”, copë 1. Vlera 157,060 lekë (125,380 lekë + 31,680 lekë), është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>- Nga verifikimi i punimeve në Kopshtin e Fshatit Tapi, rezulton se nuk janë realizuar punimet sipas zërit 5.87 “Shtresë me pllaka grez porcelanato”, në sasinë 46 m². Pllakat e shtruara nuk janë sipas specifikimeve dhe janë realizuar me punime të kryera më parë në këtë objekt. Vlera 100,096 lekë (46 m² x 2,176 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.</p> <p>Nga verifikimi i punimeve në Shkollën 9 vjeçare të Fshatit Vodëz, rezulton se fusha e basketbollit nuk është realizuar me asfalt me bojë, por shtresë betoni, me lyerje në sipërfaqe. Vlera 123,060 lekë [420 m² x (1,431 lekë/m² – 1,138 lekë/m²)], është certifikuar</p>			

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>padrejtësisht.</p> <p>- Sipas zërit 10.167 “F.V kanxhella rrethimi” ishte parashikuar që mbi muret prej betoni të rrethimit të vendoseshin kanxhella me çmim 2,394 lekë/ml. Nga verifikimi i punimeve rezultoi se në vend të kanxhellave, është ndërtuar mur me blloqe betoni, në lartësi nga 70 deri 90 cm, me gjerësi 20 cm. Bazuar në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit pika 2.88 “Mur me blloqe betoni 20 cm, deri në 3 m...”, çmimi për këtë zë punimi është 7,395 lekë/m³, ose 1,479 lekë/m². Duke marrë në konsideratë lartësinë mesatare 80 cm, për çdo metër rrethim është ndërtuar 0.8 m² mur me blloqe betoni. Çmimi i referencës duhet të jetë 1,183 lekë/ml (1,479 x 0.8). Vlera 226,420 lekë [187 ml x (2,394 lekë/ml – 1,183 lekë/ml)], është certifikuar padrejtësisht. Nga verifikimi i disa zërave të realizuar në objekt u konstatuan diferenca si më poshtë:</p> <p>Nga verifikimi sipas zërit 10.175 “F.V shtylla metalike për ndriçim”, rezultoi se nuk është realizuar vendosja e 7 shtyllave të parashikuara. Vlera 131,978 lekë (7 x 18,854 lekë/copë).</p> <p>Po ashtu nuk janë vendosur ndriçuesit smart. Vlera 163,702 lekë (Vlera 7 copë x 23,386 lekë), është certifikuar padrejtësisht.</p>			
2	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 11 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p>	48-111	I Lartë	<p>Njësia e Prokurimit Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.</p>
3	<p>Nga auditimi rezultoi se në 6 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke sjellë në total lidhjen e 6 kontratave me vlerë 436,874 mijë lekë pa TVSH, me OE të cilët janë shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.</p>	48-111	I Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Kuçovë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.</p>
4	<p>Gjatë zbatimit të kontratës “Rikualifikim urban i Lagjes “Llukan Prifti” është bërë azhurnimi i punimeve nga ku kanë rezultuar shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar aktet përkatëse. Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt, u konstatua se, sipas zërit III.8 “F.V puseta plastike 40 cm x 40 cm”, janë të dëmtuara dhe pa kapakë, dëmtime të cilat dukshëm rezultojnë se janë bërë pas ndërtimit të tyre. Për këtë nga AK nuk janë marrë masa për eliminimin e dëmtimeve</p>	48-111	I Lartë	<p>Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t’i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.</p> <p>Bashkia Kuçovë t’i kërkojë kontraktorit riparimin dhe pajisjen me kapakë të pusetave plastike, duke qenë se punimet janë në periudhën e riparimit të defekteve. Të merren masa për njoftimin e organeve kompetente për identifikimin e dëmtuesve dhe parandalimin e dëmtimeve të</p>

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
				mëtejshme të infrastrukturës.
5	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumështi dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr.733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë; 2."Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr.1854/1,datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë; 3. "Ndërtim Lokal Shërbimi 1kat + Ndërtim Fushë futbollit" me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr.1307/1,datë 22/04/2022, Nr.3933/1,me datë 19/12/2018; Nr.3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr. 1044/1 prot., datë 08/04/2020.	111-125	I Lartë	Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.
6	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohet e njëjta situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt:1."Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat",për të cilën është marrë certifikatë përdorimi me Vendimin Nr.1420/1, datë 10/05/2021, me zhvillues dhe aplikues EB, në fshatin Kozare, Kuçovë; 2."Objekt shërbimi dhoma zhvëshje", për të cilën është marrë vendimi Nr.2123/1, datë 07/07/2021, me zhvillues dhe aplikues R.Z dhe E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë.	111-125	I Lartë	Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendjen e duhur aplikimin e lejeve të ndërtimit në mënyrë që tipologjia e ndërtimit të jetë në përputhje me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm. Gjithashtu Bashkia Kuçovë dhe strukturat përkatëse të marrin masa për të ndjekur zhvillimin e lejeve të miratuara edhe gjatë fazave të zbatimit, në mënyrë që tipologjia e ndërtimit dhe objekti të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.
7	Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan 2 praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklarata paraprake punimesh.	125-133	I Lartë	Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.
8	Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në datën 31.12.2022 është 23,346,297 lekë për 592 subjekte, që përfshin debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 dhe të viteve të mëparshme, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar 82 subjekte debitor për vlerën 1,850,387 lekë. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga DAV Bashkia Kuçovë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për 65% të debitorëve të rezultuar, por nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.	21-47	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 23,346,297 lekë për 592 subjekte (principal dhe kamatë vonesë).
9	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kuçovë me palët e treta,	21-47	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përllogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 84 subjekte debitorë për vlerën 965,162 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 116 subjekte për vlerën 21,717,246 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Gjithashtu u konstatua se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përbarimit.			Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 21,717,246 lekë (principlal dhe kamatë vonesë). Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.
10	Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022, u konstatua se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3578 familje debitorë për vlerën 52,670,603 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë krijuar 3222 familje debitorë për vlerën 1,613,391 lekë. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifave për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme. -Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultoi se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Kuçovë, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Berat – Kuçovë, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Kuçovë. Përfunduar familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Sa i përket familjeve debitorë, rezultoi se nga DAV dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitorë.	21-47		Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Berat –Kuçovë, për arkëtimin e tyre. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare prej 52,670 mijë lekë.
11	Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kuçovë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive vlera debitorë është 18,593,279 lekë dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3285 familje debitorë për vlerën 22,337,349 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 është krijuar 3,744,070 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksën e tokës bujqësore, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e kësaj takse. Sa i përket familjeve debitorë, rezultoi se nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitorë. DAV Bashkia Kuçovë	21-47		Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 22,337 mijë lekë nga taksat e tokës bujqësore.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari ose personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë bashkisë për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinion mbi përputhshmërinë për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Kuçovë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar të përputhshmërisë.

Baza për Opinionin:

Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:

Në auditimin e veprimtarisë së subjektit Bashkia Kuçovë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriteret të plotësuar, në miratimin e aplikimeve për deklarata paraprake për kryerje punimesh, lejeve të ndërtimit, si dhe inspektimeve për kontrollin e punimeve të ndërtimit.

- Në auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike të lidhura nga Bashkia Kuçovë, rezultoi se nga Bashkia Kuçovë janë kryer likuidime në vlerën 1,605 mijë lekë, për punime të pakryera, me efekt dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kuçovë.

- Në 11 procedura prokurimi të audituara me vlerë kontrate 507,061 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP.

- Në 6 procedura prokurimi të audituara me vlerë kontrate 436,874 mijë lekë, OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura.

- Mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për asete të marra me qira, në vlerën 21,717 mijë lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

- Bashkia Kuçovë në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në 7 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për deklarata paraprake për kryerje punimesh, si dhe të lejeve të ndërtimit.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar.

Opinion për pasqyrat Financiare të vitit 2022

Vlerësimi dhe opinioni për pasqyrat financiare të vitit 2022 nuk është bërë, për shkak se subjekti Bashkia Kuçovë, nuk ka përfunduar hartimin e tyre brenda afatit që KLSH ka kryer auditimin në subjekt.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kuçovë

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Kuçovë, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit¹.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 120/1 datë 31.01.2023 prot., i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Kuçovë” nga data 08.02.2023 deri në datën 27.03.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022, auditim përputhshmërie, si dhe auditim financiar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.K., Auditues, Përgjegjës Grupi.
2. O.F., Auditues, Anëtar.
3. A.G., Auditues, Anëtar.
4. A.D., Auditues, Anëtar.
5. A.T., Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

-Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

-Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbimeve e investimeve, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

II.2. Qëllimi i auditimit.

-Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

-Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, miratimin e lejeve të

¹ Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryej ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).

zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe kontrollin e territorit për ndërtimin e objekteve pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi, ose deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, për periudhën objekt auditimi.

-Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kuçovë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Planifikimi, realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i kontratave të lidhura për investime në punë publike;
5. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
6. Planifikimi dhe zhvillimi i teritorrit;
7. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Kuçovë (Kryetari i bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontroleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit. Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Kuçovë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit,

duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërrputshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose raportin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit: **Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore.**

Standardet e auditimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
Manuali i Auditimit të Përrputshmërisë, KLSH me ndryshime;
Ligje: Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

VKM: VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;

VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar;

VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”;

VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve

të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;

Udhëzime:

Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Udhëzimi i MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQ-ve”;

Udhëzimi i MFE nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;

Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Rregullore:

Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë, etj.

II.7.Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, 400, Manualit të Auditimit të Financiar dhe të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
4. Kontrolli i vlerësimeve.
5. Konfirmimi nga të tretët.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
7. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 13 gjithësej dhe akt-verifikimeve 1 gjithësej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumatat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënime shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhura.

III.PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Kuçovë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.

Zona Gjeografike: Bashkia Kuçovë kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Belsh, në lindje me Bashkinë Gramsh, në jug me Bashkinë Berat dhe në perëndim me Bashkinë Dimal. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Kuçovës. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative.

Administrata e Bashkisë Kuçovë, përbëhet nga:

- Sekretari i Këshillit Bashkiak (1);

- Kryetari i Bashkisë, Punonjës Sekretarie, Zv. Kryetari, Këshilltar, 8 Drejtori, Njësia e auditimit të brendshëm, Njësi Administrative, Policia Bashkiak, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Gjendja Civile, Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi, Sektori i Arsimit, Çerdheve, Kopshteve.

Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë:

Ndërmarrja Komunale;
Qendra Ekonomike e Arsimit.

Funksionet kryesore të Bashkisë Kuçovë kryhen në fushën e:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
- Shërbimeve sociale.
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
- Mbrojtjes së mjedisit.
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.
- Zhvillimit ekonomik vendor.
- Sigurisë publike.

Financat.

Bashkia Kuçovë ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;
- ç) mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

-Për vitin 2022 nga Bashkia Kuçovë janë shpenzuar gjithësej 868,860 mijë lekë, nga të cilat:
273,882 mijë lekë për investime;

231,196 mijë lekë për transferta në ndihmë ekonomike për familje në nevoj, invalidë etj.

214,281 mijë lekë për paga;

111,853 mijë lekë për mallra të ndryshëm;

-Për vitin 2022 Bashkia Kuçovë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej 203,653 mijë lekë.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin të Brendshëm.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;

8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetëtori i Vetëvlerësimit.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kuçovë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit².

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i Kontrollit”

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Për vitin 2022 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
- Në Bashkinë Kuçovë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Për vitin 2022 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Kuçovë.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kuçovë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

² Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Aneke” – “Aneksi nr.1” të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Në Bashkinë Kuçovë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Në Bashkinë Kuçovë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, kjo evidentuar nga lista e projekteve në PBA 2022-2024, të cilët nuk i nënshtrohen një analize kosto-përfitim.

“Informimi dhe Komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

“Monitorimi dhe Raportimi”

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Znj. H.SH, Drejtore e Financës dhe Buxhetit, Z. K.L, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe A.C, Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e regjistrit të riskut.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Kuçovë.

III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kuçovë;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;

3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 u miratua me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 31 datë 17/12/2021, si pjesë përbërëse e strukturës organizative për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 86 datë 23/12/2021 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Kuçovë, Institucioneve në varësi dhe Njësi Administrative dhe Funksionet e deleguara për vitin 2022. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Kuçovë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartën e Auditimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 47, me nr. 659 prot., datë 24.02.2022.

Auditi i Brendshëm i Bashkisë Kuçovë është i organizuar me 3 (tre) punonjës, 1 (një) përgjegjës auditit dhe 2 (dy) specialist auditit duke u bazuar në nenin 10 në Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe në pikën 3 të VKM -së nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Nga auditimi u konstatua se struktura e Auditit të Brendshëm për vitin 2022, nuk ka në organikën e vetë 3 auditues sipas VKM -së sipër cituar, por është e organizuar me 2 auditues, z. A.C i pa certifikuar, i cili është emëruar përgjegjës sektori me vendim nr. 30, me nr. 3884/3 prot., datë 06.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë dhe zj. E.F e cila është emëruar si specialiste e auditit të brendshëm, e pa certifikuar. Si rezultat funksionimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm nuk është në nivelin e duhur në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Kuçovë, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me gërmën “c” në nenin 10, në gërmën “b” dhe “c” të pikës 2 në nenin 11 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Pika 3 në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe gërma “a” në nenin 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e sektorit të Auditit të Brendshëm, si vijon;

Struktura e njësisë AB për vitin 2022

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2022							
1	A.C	P/Njësisë	13.12.2021	Master Prof. Ekonomi	25	1	Në proces	Po
2	E.F	Specialiste	05.01.2021	Master Prof. Juridik	7	2	Jo	Jo
3	E.L	Specialiste	12.12.2022	Master Prof. Ekonomi	1	0	Jo	Jo

Burimi: NJAB Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2022.

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin Publike”, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Nga auditimi rezultoi se:

Për vitin 2022, nuk administrohet plani vjetor i auditimeve si dhe nuk është përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE, raporti i veprimtarisë së AB, sipas planit strategjik 2022-2024 janë planifikuar për t’u kryer 6 auditime dhe janë realizuar 3, si dhe me urdher nr. 249 datë 23.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, u realizua një angazhim auditimi jashtë planifikimit për Klubi i Futbollit “Naftëtari” sha, (Shoqëri aksionere me 100% të aksioneve të Bashkisë Kuçovë), pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin	
1	Njësia Administrative Perondi	1	Njësia Administrative Perondi	1	1					1
2	Drejtoria e Zhvillimit Rural	1								
3	Drejtoria e Të Ardhurave	1								
4	Drejtoria e Mjedisit, Kontrollit të Ushqimit e Veterinar	1	Drejtoria e Mjedisit, Kontrollit të Ushqimit e Veterinar	1	1					1
5	Spektori i Prokurimit Publik, Drejtoria Juridike	1	Spektori i Prokurimit Publik, Drejtoria Juridike	1	1					1
6	Drejtoria e Kordinimit dhe Zhvillimit Strategjik	1								
7	Klubi i Futbollit "N" sh.a	1	Klubi i Futbollit "N" sh.a	1					1	1
		7	Totali	4	3	0	0	0	1	4

Burimi: NJAB Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 253/1 prot., datë 13.02.2023.

-Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.3337/1 prot., datë 13.10.2021.

-Karta e auditimit të brendshëm është miratuar nga Titullari i Bashkisë Kuçovë me urdhrin nr.47 prot., datë 24.02.2022.

-Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Kodi i Etikës për audituesit e brendshëm me nr. 46 prot., datë 24.02.2022.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, konstatojmë se janë dhënë 45 rekomandime gjithsej, Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave nuk është zbatuar asnjë rekomandim, 41 janë në proces zbatimi dhe 4 rekomandime nuk janë zbatuar. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2021	45		41	4	4		4	
TOTALI		45		41	4	4		4	

Burimi: NJAB Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kuçovë, përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022.

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është hartuar plani vjetor i auditimit të brendshëm për vitin 2022.

-Për vitin 2022, numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë 2 punonjës të punësuar;

-Për vitin 2022, përgjegjësi i sektorit dhe specialisti i auditit të brendshëm kanë qenë të pa certifikuar;

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar;

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2022-2024 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas

strukturës së përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore;

-Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme;

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2022, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit;

-Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kuçovë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

-Për vitin 2022 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 6 auditime dhe janë kryer 3 gjithësej.

Nr	Planifikuar	Kryer
1	Njësia Administrative Perondi	Njësia Administrative Perondi
2	Drejtoria e Zhvillimit Rural	
3	Drejtoria e Të Ardhurave	
4	Drejtoria e Mjedisit, Kontrollit të Ushqimit e Veterinar	Drejtoria e Mjedisit, Kontrollit të Ushqimit e Veterinar
5	Spektori i Prokurimit Publik, Drejtoria Juridike	Spektori i Prokurimit Publik, Drejtoria Juridike
6	Drejtoria e Kordinimit dhe Zhvillimit Strategjik	
		Totali

Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura rezultoi se, përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, “Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB)”, pasi në dosje administrohen dokumente që vërtetonin se në çdo auditim është zbatuar programi i sigurimit të cilësisë së AB, në përputhje me Kap. VII, pika 7.1, dhe 7.1.1, të MAB.

Kriteri: Shkronja “ç” në nenin 6, shkronja “ç” pika 2 në nenin 11, nenin 12, nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhri e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

-Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Ndikimi/Efkti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

- Çertifikimin e audituesve të NJAB;
- Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kuçovë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.120/6 prot., datë 05.06.2023, konkretisht nga Z. A.C, Përgjegjës i Sektorit të NJAB, për sa më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

1. Sa i përket mungesës së “Çertifikimit” të punonjësve të NJ.A.B, duhet të ripohoj faktin që nga muaji Tetor 2022, Përgjegjësi i Njësisë së A.B është regjistruar dhe vijon ndjekjen e “Programit të Çertifikimit si Auditues i Brendshëm”, organizuar nga DH/AB në ministrinë e Financave. Kjo në zbatim të gërmës “c” të pikës 2 në nenin 11 të ligjit nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”.
2. Mungesa në planifikimin e realizimin për vitin 2022 e një programi angazhimi specific auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme është trajtuar nga Njësia e A.B dhe në këtë drejtim është gjykuar që zbatimi i rekomandimeve të jetë pikë më vete në programin e auditimit për 4 subjektet e audituara. Gjithashtu në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe specifikisht të Standartit 2500 të IIA-së “Monitorimi i zbatimit rekomandimeve”, është vepruar që; Përgjegjësi i NJ.A.B me datën 07.03.2022, i ka drejtuar kërkesën drejtorive dhe sektorëve të audituar për progresin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëposhtme.
3. Sa konkludoni që: nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për çdo drejtori dhe më pas gjetjet e mangësitë e evidentuara kanë përcaktuar dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e situatës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH-së, shprehet se çështjet e ngritura në observacion janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në mënyrë shteruese dhe kemi të njëjtin qëndrim.

III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022.

➤ **Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimine zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “EXCEL”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2022 për përgatitjen e PBA 2022-2024 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.85, datë 23.12.2021, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 03/2 prot., datë 14.01.2022. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.*
- b. *Ndërtimi i veprave publike (ujësjellës).*
- c. *Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore.*
- d. *Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve.*
- e. *Mirëmbajtjen e kanaleve kulluese e ujitëse.*
- f. *Shtimin e fondeve për mbështetjen e shtresave në nevojë.*
- g. *Kërkesa për strehim.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisive të Qeverisjes Vendore*”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2022 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.74, datë 24.11.2021.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Kuçovë për vitin 2022 është 868,860,284 lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2022, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionët e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2022-2024 sipas programeve ekonomike që menaxhon
Bashkia Kuçovë

Nr.	Kodi	Emërtimi	PBA	Buxheti vjetor 2022	Realizimi i	Diferenca
			Plan viti 2022	(Plani i Rishikuar)	periudhës progresiv	
			(1)	(2)	(3)	(3-2)
1	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	54,928,418	50,029,730	39,081,212	10,948,518
2	01120	Çeshtje financiare dhe fiskale	14,265,000	14,623,836	13,174,067	1,449,769
3	01170	Gjendja Civile	0	4,835,810	4,438,214	397,596
4	01620	Zgjedhjet vendore	0	0	0	0
5	03140	Policia bashkiake	4,367,000	4,502,500	4,473,011	29,489
6	03280	MZSH	15,195,000	34,959,400	19,808,739	15,150,661
7	04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	3,818,500	3,882,500	3,305,773	576,727
8	04240	Ujitja dhe kullimi	26,108,717	27,563,273	24,557,851	3,005,422
9	04260	Administrimi i Pyjeve	3,481,000	3,616,966	3,565,656	51,310
10	04520	Mirëmbajtje rruge e trotuare	51,441,800	70,513,356	52,054,523	18,458,833
11	05100	Menaxhimi i mbetjeve	32,856,157	34,042,602	28,517,148	5,525,454
12	05630	Mjedisi	5,051,000	5,179,755	4,505,028	674,727
13	06140	Planifikimi urban	8,061,000	8,608,501	7,729,548	878,953
14	06190	Banesa sociale	7,241,592	24,636,527	22,595,596	2,040,931
15	06210	Zhvillimi I komunitetit	55,970,464	75,069,464	74,252,559	816,905
16	06260	Shërbimet publike	33,892,012	35,137,767	33,755,816	1,381,951
17	06370	Furnizim me uje dhe kanalizime	0	125,824,001	125,824,000	1
18	06440	Ndriçimi rrugor	26,139,804	26,271,819	16,191,783	10,080,036
19	08130	Sporti dhe argetimi	12,776,440	12,874,640	12,205,754	668,886
20	08220	Shërbime kulturore	8,755,440	10,028,088	9,420,266	607,822
21	09120	Arsimi parashkollor, baze & QKF	123,794,552	134,036,721	122,791,412	11,245,309
22	09230	Arsimi i mesem	7,243,000	7,242,998	7,195,781	47,217
23	10430	Mbrojtja sociale	25,697,821	245,247,541	239,416,547	5,830,994
Totali i Shpenzimeve të Njësisë			521,084,717	958,727,795	868,860,284	89,867,511

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 89,867 mijë lekë. Diferencë rezulton në programin ekonomik për “Mirëmbajtje rruge e trotuare”, “MZSH”, “Arsimi Parashkollor bazë dhe QKF”, “Planifikim, Menaxhimi, Administrimi”, “Ndriçimi Rrugor”, “Mbrojtja Sociale”.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2022-2024 Bashkia Kuçovë ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2022
Te ardhura tatimore	71,414
Te ardhura jotatimore	137,561
TOTAL	208,975

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024.

Situata: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

-Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 nuk janë marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;

-Për PBA 2022-2024 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

-Procedura e përgatitjes së PBA 2022-2024 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kuçovë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;

-Në buxhetin vjetor të vitit 2022 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor.

Kriteri: Pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Kuçovë.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Kuçovë.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kuçovë.

2.2.2 Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kuçovë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke

argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Kuçovë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Berat.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3 Planifikimi i buxhetit për vitin 2022, Bashkia Kuçovë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar VKB nr.85. 23.02.21	Buxheti shtesë VKB Nr.7 dt 10.02.22	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, VKB nr.85 dt 23.2.21	Buxheti shtesë VKB: Nr.7 dt. 10.02.2022	Vlerat e buxh fillestar + buxh shtesë
	1	2			4	5	
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	208,975	200	209,175	Art. 600 Paga	214,433	5,562	219,995
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për vitin 2022	8,371	17,135	25,506	Art.601	36,129	941	37,070
Të ardhurat e veta të planifikuara për shpenzim për vitin 2022				Art.602	132,775	5,436	138,211
Total të ardhurat e veta	217,346	17,335	234,081	Art. 603			
Të ardhura të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar	168,659	12,387	181,046	Art.604	5,465	-3,471	1,994
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	11,954	6,255	18,209	Art. 606	11,672		11,672
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022				Art. 230-231	119,111	23,729	142,840
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2022	123,126		123,126	Fondi Rezervë + Kontigjencës	1,500	3,780	5,280
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	303,739	18,642	322,381				
Totali i të Ardhurave	521,085	35,977	557,062	Total i Shpenzimeve	521,085	35,977	557,062

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezultoni se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **557,062 mijë lekë**.

Për vitin 2022, kanë ndodhur 4 ndryshime buxhetore me vlerë 42,660 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4 Ndryshimet buxhetore për vitin 2022

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe rishpërndarja e fondeve													
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë					Shtesat dhe Pakësimet në total	Rishpërndarjet: Shtesa/Pakësime të Buxhetit					Buxh fillest buxh shtesë
	VKB Nr.85 dt.23.12.2021	VKB Nr.7 dt.10.02.2022	VKB Nr.8 dt.10.02.2022	VKB Nr. 48 dt.4.10.2022	Shkrese Nr.130 dt.05.01.23	Vendim nr.23, dt 09.09.22		VKB Nr. 38. dt 28.07.2022	VKB Nr. 43 dt.23.08.2022	VKB Nr.76 dt 30.11.2022	Vendim 26, 05.01.22	Rishpërndarje total	
	1	2	3	4	5	6=2+3+4-5	7	8	9	10	11	11=7+8+9+10	13=1+6+11
600	214,434		5,561	1,140		6,701	41.5				-3,100	-3,059	218,076
601	36,129		941	201		1,142	6.9				-244	-237	37,034
602	132,775	200	5,236	500		5,936	-48			-1,918	-1,445	-3,411	135,300
604	5,465		-3,471			-3,471							1,994
606	11,672				1,580	1,580				4,789		4,789	18,041
230-231	119,111		23,729	-500	19,099	42,328		812	400	15,764		17,191	178,630
(609)	1,500		3,780			3,780		-812	-400			-1,427	3,853
Totali	521,085	200	35,377	1,340	20,679	57,997	0	0	0	13,486	0	13,486	592,927

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Kodi	Emërtimi	Buxheti Vjetor 2022 (Plani i rishikuar)	Realizimi	Në %
1	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	50,029,730	39,081,212	78%
2	01120	Çeshtje Financiare dhe Fiskale	14,623,836	13,174,067	90%
3	01170	Gjendja Civile	4,835,810	4,438,214	92%
4	01620	Zgjedhjet Vendore	0	0	0%
5	03140	Policia Bashkiake	4,502,500	4,473,011	99%
6	03280	MZSH	34,959,400	19,808,739	57%
7	04220	Shërb. Bujqësore, Inspekt, Ushq dhe Mbrojtja e Kons	3,882,500	3,305,773	85%
8	04240	Ujitja dhe Kullimi	27,563,273	24,557,851	89%
9	04260	Administrimi i Pyjeve	3,616,966	3,565,656	99%
10	04520	Mirëmbajtje Rruge e Trotuare	70,513,356	52,054,523	74%
11	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	34,042,602	28,517,148	84%
12	05630	Mjedisi	5,179,755	4,505,028	87%
13	06140	Planifikimi Urban	8,608,501	7,729,548	90%
14	06190	Banesa Sociale	24,636,527	22,595,596	92%
15	06210	Zhvillimi I Komunitetit	75,069,464	74,252,559	99%
16	06260	Sherbimet Publike	35,137,767	33,755,816	96%
17	06370	Furnizim me Uje dhe Kanalizime	125,824,001	125,824,000	100%
18	06440	Ndriçimi Rrugor	26,271,819	16,191,783	62%
19	08130	Sporti dhe Argetimi	12,874,640	12,205,754	95%
20	08220	Sherbime Kulturore	10,028,088	9,420,266	94%
21	09120	Arsimi Parashkollor, baze & QKF	134,036,721	122,791,412	92%
22	09230	Arsimi i Mesem	7,242,998	7,195,781	99%
23	10430	Mbrojtja Sociale	245,247,541	239,416,547	98%
Totali i Shpenzimeve të Njesisë			958,727,795	868,860,284	91%

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

Për vitin 2022 realizimi i buxhetit është në nivelin 91%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime”, “Policia Bashkiake”, “Zhvillimi i Komunitetit”, “Administrimi i Pyjeve, Arsimi i Mesëm”. Programi me realizimin më të ulët është “MZSH”;

2.2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kuçovë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kuçovë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.


Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2022-2024, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2022

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	221,376	214,281	97
601	Sigurime Shoqërore	37,584	35,951	96
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	135,300	111,853	83
604	Transferta Korente të Brendshme	2,890	1,698	59
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	236,277	231,196	98
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	321,449	273,882	85
TOTAL		958,728	868,860	91

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku nr.1 Pesha e secilit artikull ndaj totalit
(F11) SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK (BRUTO)



Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 91%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, kapitale të trupëzuara, mallra dhe shpenzime si dhe realizimin më të ulët e kanë Transferrat Korrente të Brendshme. Vihet re se për vitin 2022 art. (602) transferta korente të brendshme paraqiten 59 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.

Buxheti sipas burimeve të financimit 2022

Art.	Emertimi	Fakt 2022						
		Gjithesëj	Të ardhurat e veta	Tr.Pakushtëz	Tr. kushtëz. Specifike	Sponsoriz	Tr.Kushtëz për funksionet e deleguara	Tr.Kushtëz për Investime
600	Paga	214,281	61,454	58,913	90,956		2,958	
601	Sigurime Shoqërore	35,951	9,642	10,865	14,950		494	
602	Shp. Operative	111,853	53,042	47,106	11,505	200		
604	Transf. Korrente të Brendshme	1,698	15	787			896	
606	Transf. për familje dhe individ	231,016	7,003	7,429	2,462		214,122	
230-231	Investime	273,882	66,364	46,180	18,519			142,819
	Total	868,860	197,520	171,280	138,572	200	218,470	142,819

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara, në vlerën 218,470 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Kuçovë, ndjekur nga të ardhurat e veta në vlerën 197,520 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 171,280 dhe transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 138,572 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 218,470 mijë lekë, ose 25% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transferta për familje dhe individ, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime korrente të brendshme.

Transferta e kushtëzuar për Investime.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për investime për vitin 2022 është realizuar në vlerën 142,819 mijë lekë, ose 16% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për investime, e zënë shpenzimet për investime.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transferata e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 171,280 mijë lekë, ose 20% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transferatës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar në vlerën 197,520 mijë lekë, ose 23% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

Transferta kushtëzuar specifike.

-Buxheti nga transferata specifike për vitin 2022 është realizuar në vlerën 138,572 mijë lekë, ose 16% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transferatës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Me miratimin e buxhetit për vitin 2022, Bashkia Kuçovë nuk ka parashikuar dhe miratuar fond rezervë/dhe kontigjencës. Për vitin 2022, Bashkia Kuçovë ka miratur fond për mbrojtjen civile në vlerën 895,750 lekë.

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Kuçovë.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Kuçovë përgjatë periudhës 2022 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ Realizimi i Investimeve.

Titulli gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 91 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kuçovë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

➤ Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.

Në zbatim të nenit 48 “*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*” të ligjit 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “*Për Procedurat standarde të Monitorimit të*

Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44³, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për vitin 2022 Bashkia Kuçovë me shkresën nr. 1649 datë 24.05.2022, ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2022, me shkresën nr. 2969/1 datë 26.09.2022 ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit si dhe me shkresën nr. 787 datë 28.02.2023 ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë raportin vjetor të monitorimit të buxhetit.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Kuçovë, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2022 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka ardhur duke u rritur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2022.

Detyrimet e prapambetura për periudhën 2022

Detyrime e NJQV 2022	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja gjate 2022	Mbetja në fund të vitit 2022
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrime për vendime gjyqësore		1,026,290	1,026,290		1,026,290
Detyrime për shërbime	1,927,211	928,319	2,855,530	1,887,211	968,319
Detyrime për mirembajtje					
Detyrime për investime	104,058,603	30,007,628	134,066,231	96,494,003	37,572,228
Detyrime te tjera					
Total Detyrime që kanë si burim të ardhurat e veta	105,985,814	31,962,237	137,948,051	98,381,214	39,566,837
b	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrime për Investime nga Ministria e Linjës (Min. Infrastrukturës)	14,267,661	135,635,214	149,902,875	14,180,841	135,722,034
Detyrime për shpërbllim lindje (Min. Brendshme për punonjës të GJ.Civile)	3,920,000		3,920,000		3,920,000
Total i Detyrimeve që kanë si burim financimi Min. Linjës	18,187,661	135,635,214	153,822,875	14,180,841	139,642,034
Total i Detyrimeve nga të ardhurat e veta + granti	124,173,474	167,597,451	291,770,926	112,562,055	179,208,871
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2022					66,063,267

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr.787 prot., datë 28.02.2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kuçovë ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **38,540,547 lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Situata Financiare për vitin 2022

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	-		
a	Hua sfatgjatë	-		

³ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	-		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	38,540,547		
a	Shpenzime korrente			
a,1	Mallra dhe shërbime	968,319		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale			
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	37,572,228		
c	Vendime gjyqësore			
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	38,540,547	592,927,242	6.5%

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore si dhe pasqyrimin e vendimeve gjyqësore në raportin e monitorimit dërguar në MFE.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022, detyrimi për likuidimin e tyre, është në vlerën 1,026,290 lekë ose rreth 3% mbi totalin e detyrimeve të raportuara.

Konstatohet se vlera e detyrimeve gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk është pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Kuçovë ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 26, datë 07.12.2022 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Kuçovë është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “E.SH”, në vlerën 587,570 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 236, datë 12.10.2022 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Kuçovë është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “A.SH”, në vlerën 438,720 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Kriteri: Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të

procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

-Shpronësimet për interes publik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit rezultoi se ndaj Bashkisë Kuçovë është krijuar detyrimi për shpronësimin e 10 subjekteve në vlerën 5,034,221 lekë. Ky detyrim duhej të likujdohej brenda vitit 2022, por nga verifikimi i ditarit të bankës, si dhe rialokimit të fondeve buxhetore, u konstatua se nga Bashkia Kuçovë nuk është bërë rialokim i fondeve me qëllim likuidimin e detyrimeve për shpronësim. Më poshtë pasqyrohet në formë tabelare vlera e shpronësimit për çdo subjekt:

Pronari	Vlera e shpronësimit	% e pjesëmarrjes në financim Bashkia	Likuidimet nga Bashkia 2023	Vlera e mbetur e palikujduar deri në 31.12.2022
1	1,838,693	100	0	1,838,693
2	536,000	100	0	536,000
3	146,792	100	0	146,792
4	294,160	100	0	294,160
5	294,160	100	0	294,160
6	24,120	100	0	24,120
7	60,300	100	0	60,300
8	8,040	100	0	8,040
9	1,020,939	100	0	1,020,939
10	811,017	100	0	811,017

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

➤ **Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.**

Titulli gjetjes: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Kuçovë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 23 raste për vlerën 179,208,871 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike nr.12, në Kapitullin “Anekse”.

Tabela nr.10 Përmbledhëse e faturave për vitin 2022

Artikulli	Sasia	Viti2022/lekë
230-231	12	177,214,262
602	11	1,994,609
Totali	23	179,208,871

Burimi: Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2022 janë 23 fatura të palikujduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 179,208,871⁴ lekë.

-Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë, ilustruar me disa raste.

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

- OE S shpk, faturë e datës 17.09.2021 në vlerën 13,106,858 lekë, likujduar më datë 04.08.2022, ndërkohë që deri më datë 04.08.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si p.sh., subjekti D shpk me faturë të datës 07.12.2021 në

⁴ Analitikisht pasqyruar në Anekse.

vlerë 15,000,000 lekë, likujduar më datë 26.07.2022, subjekti P shpk me faturë të datës 26.11.2021 në vlerë 100,171 lekë, likujduar më datë 18.01.2022 si dhe subjekti VG shpk me faturë të datës 15.12.2021 në vlerë 850,000 lekë, likujduar më datë 10.02.2022;

- V shpk, faturë e datës 27.02.2021 në vlerën 1,073,982 lekë, likujduar më datë 12.04.2022, ndërkohë që deri më datë 12.04.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë sesa fatura e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti F shpk me faturë të datës 30.04.2021 në vlerë 6,000,000 lekë, likujduar më datë 23.02.2022;

- D shpk, faturë e datës 01.12.2021 në vlerën 15,000,000 lekë, likujduar më datë 21.04.2022, ndërkohë që deri më datë 21.04.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë sesa fatura e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti VG me faturë të datës 15.12.2021 në vlerë 850,000 lekë, likujduar më datë 10.02.2022;

- SH 07 shpk me faturë të datës 30.06.2015 në vlerë 105,600 lekë dhe subjekti Z 06 shpk faturë e datës 17.04.2016 në vlerën 72,000 lekë nuk janë likujduar deri më 31.12.2022 ndërkohë janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se faturat e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti Ed K shpk me faturë të datës 31.03.2020, likujduar më datë 22.02.2022, subjekti K shpk me faturë të datës 31.08.2021, likujduar më datë 23.02.2022 etj.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Kriteri: Pikat 8, 106 dhe 107 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Efekti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

2.2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vitin 2022, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Kuçovë ka marrë 3 financime projektsh nga FSHZH/FZHR.

Fonde të deleguara për vitin 2022 për investime të cilat kanë filluar periudha të mëparshme dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2022, ose janë në proces gjatë vitit 2022

Nr	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Dt. Lidhjes Kontrates	Ofert. Fituese	Situacionuar deri 31.12.2022	Likujduar 31.12.2022
1	Ndertim i ujesjellesit: Lumas, Pellumbas	Fshzh	27,11,2020	422,451,858	323,486,363	296,319,725
2	Permiresim i banesave egzistuese per komunitete te varfra e te pafavorizuara	Buxhet i shtetit	08,10,2021	14,998,837	11,999,070	11,129,689
3	Ndertim banesa sociale, shtese kati	Buxhet i shtetit	10,10,2022	22,368,755	15,938,825	15,922,303
	Totali			459,819,450	351,424,258	323,371,717

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për vitin 2020, Bashkia Kuçovë ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt “Ndërtim i Ujësjesit; Lumas, Pellumbas” me burim financimi nga FSHZH.

Vlera e investimit është 422,451,858 lekë, deri në 31.12.2022, për këtë objekt janë likujduar fondet e përcjella nga FSHZH në vlerën 296,319,725 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2020, ka vazhduar në 2021 dhe përfundon në vitin 2022.

-Për vitin 2021, Bashkia Kuçovë ka lidhur kontratë për investim me objekt “Përmirësimin e banesave egzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara” me burim financimi 80% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe 20% me burim nga Buxheti i Bashkisë. Vlera e investimit është 14,998,837 lekë, deri në 31.12.2022 janë likujduar fondet e përcjella nga MFE dhe të ardhurat e Bashkisë në vlerën 11,129,689 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në 2021 dhe përfundon në vitin 2022.

-Për vitin 2022, Bashkia Kuçovë ka lidhur kontratë për investim me objekt “Ndërtim i banesave sociale, shtesë kati” me burim financimi 80% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe 20% me burim financimi nga të ardhurat e Bashkisë. Vlera e investimit është 22,368,755 lekë, deri në 31.12.2022 janë likujduar fondet e përcjella nga MFE dhe të ardhurat e Bashkisë në vlerën 15,922,303 lekë.

-Kontratat e mësipërme janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Kuçovë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

-Buxheti i Bashkisë Kuçovë dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2022;

-Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;

- Për hartimin e PBA 2022-2024 janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Kuçovë, por nuk janë dokumentuar, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kuçovë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në PBA, si dhe buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor;

-Për vitin 2022 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 91%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ”, duke vijuar me shpenzime për Paga dhe Sigurime Shoqërore, Kapitale të Trupëzuara, Mallra dhe Shpenzime si dhe realizimin më të ulët e kanë Transfertat Korrente të Brendshme. Vihet re se për vitin 2022 art. (602) Transferta Korrente të Brendshme paraqiten 59%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi likujdimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezulton se përgjatë vitit 2022 janë 2 vendime gjyqësore ndaj Bashkisë Kuçovë në vlerën 1,026,290 mijë lekë, nga shqyrtimi i ditarit të bankës për vitin 2022 nuk janë kryer likujdime të plota/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 1,026,290 lekë ose rreth 3% mbi totalin e

detyrimeve të raportuara. Konstatohet se detyrimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk janë pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE.

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Kuçovë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat nuk është respektuar në 23 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 179,208,871 lekë, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. K.H, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe znj. H.SH me funksion Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në zbatim të pikës II.2, nënpika 2.6, të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1)Evidencat analitike të llogarive debitore për taksat dhe tarifave vendore.
- 2)Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.
- 3)Evidencat e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare.
- 4)Të tjera dokumente për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore.
- 5)Vendimin e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.
- 6)Vendimet e Këshillit të Bashkisë për strukturën organike.

I.Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave (DAV), Bashkia Kuçovë.

Për vitin 2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.86, datë 23.12.2021, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Berat me shkresën nr.03/2, datë 14.01.2022. Me urdhrin nr.31, datë 17.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe drejtoria e të ardhurave (në vijim DAV).

-DAV ka në përbërjen e saj, 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori, 3 specialist dhe 7 agjent tatimor.

Struktura e DAV Bashkia Kuçovë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2022 nëse ka pasur
1	S.L	Drejtor i Drejtorise se te Ardhurave	13.12.2021	
2	E.G	Pergjegjes i kontabilitetit dhe i rakordimit	07.12.2009	
3	D.S	Specialist i sherbimit te taksapaguesve	17.02.2011	
4	H.M	Specialist IT	04.04.2016	larguar 22.04.2022
5	E.M	Specialist i menaxhimit te boxhit	07.02.2020	
6	M.A	Pergjegjes i sektorit te kontrollit dhe masave shtrenguese	14.04.2022	
7	T.B	Agjent tatimor	13.1.2015	
8	K.SH	Agjent tatimor	04.10.2019	
9	B.S	Agjent tatimor	28.04.2016	
10	A.Q	Agjent tatimor	27.03.2020	Leje 24.2 - 2.10.2022
11	B.SH	Agjent tatimor tregu i lire	24.05.2017	
12	K.P	Administrator tregu	13.09.2018	
13	SH.B	Agjent tatimor	24.2.2022	larguar 2.10.2022

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-DAV Bashkia Kuçovë, për vitin 2022 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë nga taksat dhe tarifave.

Veç DAV, në Bashkinë Kuçovë janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si më poshtë vijon:

Struktura	Lloji i të ardhurës	Plani	Fakti
Drejtoria e te Ardhurave	Taksa dhe tarifa Vendore	171,311,000	164,251,148
Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Leje ndertimi, Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga aluizni, certifikata perdorimi, tarifa e privatizimit te banesave, piketime objekti dhe akte kontrolli	9,000,000	9,037,907
Drejtoria e Qendres Ekonomike te Arsimit	Te ardhura nga kopshte dhe cerdhe	4,980,000	4,678,550
Drejtoria e Sherbimit	Te ardhura nga leje transporti, licensa karburante, parkimi, tarife per mirembajtje varrezash, qera per banesa sociale	3,620,000	2,580,745
Drejtoria e Zhvillimit Rural	tarifa per kanalet kulluese, vaditjen, te ardhura nga qeraja e tokes pyjore	3,630,000	1,051,257
Njesa Administrative Perondi	Tatim toke bujqesore, qera toke bujqesore, shitja e lendes drusore, tarifa per vaditjen	7,255,000	3,785,385
Njesia Administrative Lumas	Tatim toke bujqesore, qera toke bujqesore, tarifa per ujin e pijshem, taksa dhe tarifa vendore, shitja e lendes drusore	4,832,000	2,526,108
Njesia Administrative Kozare	Tatim toke bujqesore	4,347,000	2,137,503

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

II. Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Kuçovë.

Përgjatë vitit 2022, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

-Paketa fiskale për vitin 2022 është miratuar me VKB nr.74, datë 24.11.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr.03/2 prot., datë 14.01.2022.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Kuçovë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 30 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2022 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kuçovë dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

1. Biznes;

2. Ambulant;

3. Familjar;

4. Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2021
1	Biznesi i Madh	111
2	Biznesi i Vogël	621
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	170
4	Institucione	21
5	Familje	12286
	Total	13209

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në lekë, për vitin 2022, pasqyrohen në kapitullin Anekse – Aneksi nr.3, bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për vitin 2022 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **208,975 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **203,653 mijë** lekë, ose 97% / rreth 5,321 mijë lekë më pak nga plani.

Nëse do t'i referoheshim vetëm realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore (ndërtes, tokë bujqësore, ndikimi në infrastrukturë, pastrim, gjelbërim, ndriçim, ndotje, tabelë, reklam, qira), plani i të cilave zë 83% të totalit të planit të të ardhurave, rezulton se realizimi i taksave dhe tarifave të mësipërme është 85%, ose 24,052,258 lekë.

Në tërësinë e taksave dhe tarifave të mësipërme që janë realizuar më pak, përmendim disa prej tyre, të cilat janë më të rëndësishmet, pasi përbëjnë burimin kryesor dhe të qëndrueshëm të të ardhurave të Bashkisë Kuçovë, si përshëmbull:

- Taksën e ndërtesave të banimit, realizuar në masën 64%;
- Taksën e tokës bujqësore, realizuar në masën 46%;
- Tarifën e pastrimit nga familjet, realizuar në masën 73% (8,642,671 lekë) ku vlenë të theksojmë se të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit në masën 8,642,671 lekë, janë vetëm nga tarifa e pastrimit për familjet e qytetit të Kuçovës, e cila mbledhet nëpërmjet faturës së ujit. Ky rezultat tregon punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në mbledhjen e tarifës së pastrimit për familjet në NJA.

Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Kuçovë sipas kategorive të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Përmbledhëse makro për debitorët				
Në fund të vitit 2021 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
	8021	156,137,511	148,416,095	7,721,416
Biznesi	508	20,243,298	19,840,789	402,509
Institucione	2	1,156,492	1,140,407	16,085
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	3752	51,057,212	51,057,212	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	321	9,095,646	9,095,646	
Taksa e tokës bujqësore	3285	18,593,279	18,593,279	
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	88	34,100,000	34,100,000	
Qira toke bujqësore	32	20,752,084	13,449,262	7,302,822
Gjoha të policisë bashkiake	31	39,500	39,500	
Tarifa e licencimit për karburantet	2	1,100,000	1,100,000	
Krijuar brenda vitit 2022	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
Biznesi	219	1,850,387	1,697,603	152,784
Institucione	1	96,120	96,120	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	3222	1,613,391	1,613,391	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	223	6,483,920	6,483,920	
Taksa e tokës bujqësore		3,744,070	3,744,070	
Qira toke bujqësore	66	656,812	656,812	
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	11	1,170,000	750,000	420,000
Gjoha të policisë bashkiake	8	12,000	12,000	
Tarifa e licencimit për karburantet	2	400,000	400,000	
Në fund të vitit 2022 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
Biznesi	614	22,093,685	21,538,392	555,293
Institucione	1	1,252,612	1,236,527	16,085
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	3578	52,670,603	52,670,603	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	544	15,579,566	15,579,566	
Taksa e tokës bujqësore	3285	22,337,349	22,337,349	
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	20	35,270,000	34,850,000	420,000
Qira toke bujqësore	98	21,408,896	14,106,074	7,302,822
Gjoha të policisë bashkiake	8	51,500	51,500	
Tarifa e licencimit për karburantet	3	1,500,000	1,500,000	
Total	8151	172,164,211	163,870,011	8,294,200

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2022 është 172,164,211 lekë për taksat dhe tarifat vendore, qiratë, gjodat, kamatëvonesa etj. Në krahasim me fundin e vitit 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitore me 16,026,700 lekë.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

- Në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor të vlerësuar, për taksa dhe tarifa vendore (gjelbërim, pastrim, ndriçim, ndërtesë, truall, toka bujqësore, ndikim në infrastrukturë, reklam, tabelë, zënie të hapësirës publike, licencim i karburanteve), progresivisht deri më datë 31.12.2022 është në vlerën 115,433,815 lekë, ndërsa detyrimi tatimor i krijuar brenda vitit 2022 është në vlerën 14,187,888 lekë.

III.1. Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.

Titulli gjetjes: Debitorët “Biznes”, “Institucione” dhe “Qiramarrës” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Situata: Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DAV, rezulton se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 508 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 20,243,298 lekë dhe 2 institucione në vlerën 1,156,492 lekë.

-Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 590 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 22,093,685 lekë dhe 2 institucione në vlerën 1,252,612 lekë, pra gjithësej **23,346,297 lekë** për **592** subjekte, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2022 janë debitor 508 subjekte për vlerën 20,243,298 lekë, ndërkohë në fund të vitit 2022, janë 590 subjekte në vlerën 22,093,685 lekë. **Konkretisht gjatë vitit 2022 janë krijuar 82 subjekte debitor për vlerën 1,850,387 lekë.**

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga DAV Bashkia Kuçovë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për 65% të debitorëve të rezultuar, por nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S.L, Drejtor i DAV dhe z.M.A, Përgjegjës i sektorit të kontrollit dhe masave shtrënguese.

“Subjektet qiramarrës”.

Qira në fond pyjor.

Bashkia Kuçovë administron 31 kontrata qiraje në fond pyjor/kullosor. Të gjitha këto kontrata janë lidhur përgjatë fundit të vitit 2021/gjatë fillimit të vitit 2022, me afat 1-vjeçar. Kontratat janë lidhur për dhënie me qira të fondit pyjor/kullosor për ushtrimin e aktivitetit kultivimin e bimëve.

-Nga auditimi i marrëdhënieve kontraktore të Bashkisë Kuçovë me palët e treta, për dhënie me qira të pasurive të paluajtshme (fond pyjor/kullosor), u konstatuan 2 mangësi, përlllogaritje e gabuar e tarifës së qirasë dhe mosadministrimi i mandat-pagesës së tarifës vjetore, si më poshtë vijon:

Në kontratën e qirasë nr.552 prot., datë 18.02.2022 me subjektin “N.L”, me afat 1 vjeçar, nuk është përlllogaritur tarifa e qirasë për rrugën e kalimit, sipas përlllogaritjeve kemi $0.45 \text{ Ha} * 25,000 \text{ lekë/Ha} = 11,250 \text{ lekë}$.

Në kontratën e qirasë nr.509 prot., datë 15.02.2022 me subjektin “P.L”, me afat 1 vjeçar, nuk është përlllogaritur tarifa e qirasë për rrugën e kalimit, sipas përlllogaritjeve kemi $0.35 \text{ Ha} * 25,000 \text{ lekë/Ha} = 8,750 \text{ lekë}$.

Në kontratën e qirasë nr.4233 prot., datë 21.12.2021 me subjektin “SH.H”, me afat 1 vjeçar, nuk është përlllogaritur tarifa e qirasë për rrugën e kalimit, sipas përlllogaritjeve kemi $0.21 \text{ Ha} * 25,000 \text{ lekë/Ha} = 6,250 \text{ lekë}$.

Në kontratën e qirasë nr.4234 prot., datë 21.12.2021 me subjektin “K.H”, me afat 1 vjeçar, nuk është përlllogaritur tarifa e qirasë për rrugën e kalimit, sipas përlllogaritjeve kemi $0.21 \text{ Ha} * 25,000 \text{ lekë/Ha} = 6,250 \text{ lekë}$.

Në kontratën e qirasë nr.498 prot., datë 14.02.2022 me subjektin “P.R”, me afat 1 vjeçar, nuk administrohet mandat pagesa e tarifës së qirasë në vlerën 7,200 lekë.

-Gjithësej 39,700 lekë rezultojnë si rrjedhojë e veprimeve/mosveprimeve të mësipërme, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. N.S, Drejtor i Zhvillimit Rural dhe z.P.R, Përgjegjës i sektorit të pyjeve, pranë Bashkisë Kuçovë.

Qira për hapësirën publike.

Bashkia Kuçovë administron 36 akt-marrëveshje qiraje për hapësira publike. Tarifa e dhënies së hapësirës publike është sipas përcaktimit në Paketën Fiskale të vitit 2022, konkretisht 60 lekë/m² në muaj. Hapësirat publike janë dhënë në përdorim për 8 muaj të vitit, pra 480 lekë/m² për 8 muaj. Nga auditimi i akt-marrëveshjeve për dhënien e hapësirës publike, u konstatua se në 13 raste subjektet të cilët kanë marrë në përdorim hapësirat publike, nuk kanë likujtuar aspak/plotësisht tarifën përkatëse, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, në vlerën 268,650 lekë. Subjektet debitore janë si më poshtë vijon:

- K.C – 9,600 lekë
- A.D – 19,200 lekë
- B.M – 5,760 lekë
- E.G – 115,200 lekë
- E.L – 21,120 lekë
- I.H – 7,200 lekë
- G.V – 19,200 lekë
- J.B – 16,800 lekë
- K.Z – 11,520 lekë
- M.J – 6,720 lekë
- M.T – 26,400 lekë
- N.Z – 4,950 lekë
- S.K – 4,980 lekë

-Sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të Paketës Fiskale të Bashkisë Kuçovë për vitin 2022, subjektet të cilat marrin hapësirë publike për përdorim, duhet që të kryejnë pagesën në momentin e lidhjes së akt-marrëveshjes, por në rastet e mësipërme nuk ka ndodhur në këtë mënyrë. Deri më datë 31.12.2022 nga DAV Bashkia Kuçovë nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e detyrimit të mësipërm, megjithëse subjektet kanë vazhduar përdorimin e hapësirës publike.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S.L, Drejtor i DAV dhe z.M.A, Përgjegjës i sektorit të kontrollit dhe masave shtrënguese.

Qira për tokën bujqësore.

Bashkia Kuçovë administron 441 kontrata qiraje për tokën bujqësore në NJA Perondi dhe Lumas, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2012-2013 dhe me afat kryesisht 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas përcaktimit në Paketën Fiskale të vitit 2022, konkretisht 6,000 lekë/Ha/vit.

Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Kuçovë nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithësej 2,657,735 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, u konstatua se në fund të vitit 2021 janë debitor 32 subjekte në vlerën 20,752,084 lekë. Në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 konstatohet se janë debitor 98 subjekte për vlerën 21,408,896 lekë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar 66 subjekte për vlerën debitore 656,812 lekë. Gjithashtu konstatohet se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t'i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbartimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. N.S, Drejtor i Zhvillimit Rural dhe z.P.R, Përgjegjës i sektorit të pyjeve, pranë Bashkisë Kuçovë, zj. R.B, Administratore e NJA Perondi dhe z.A.C, Administrator i NJA Lumas.

Kriteri: Lidhja 2, tabela 2 në VKM nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar;

Paketa fiskale e vitit 2022, pika 4, pika 17, shkronja “b”;

Neni 3 dhe neni 4 në Ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar;

Pika 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Efekt: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 44,755,193 lekë, nga të cilat 2,603,319 lekë janë krijuar brenda vitit 2022.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 44,755,193 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Rekomandimi: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.

Situata: Në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Berat dhe Drejtoria e Vendore e ASHK Kuçovë, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2022, i paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë. Nga DVASHK Berat dhe DVASHK Kuçovë, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Konkretisht nga DVASHK Berat/Kuçovë për subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2022, janë dërguar shkresat nr.413 prot., datë 07.01.2022, nr.121/1 prot., datë 31.01.2022, nr.357/1 prot., datë 30.03.2022, nr.712 prot., datë 07.06.2022, nr.824/1 prot., datë 30.06.2022, nr.1127/1 prot., datë 31.08.2022, nr.1216 prot., datë 21.09.2022, nr.4137 prot., datë 09.11.2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës nuk është zbatuar pika 4 në paketën fiskale të Bashkisë Kuçovë për vitin 2022 dhe Urdhri i brendshëm i Kryetarit të Bashkisë Kuçovë nr.200, datë 01.08.2022, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2022, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër situata ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe sa i përket arkëtimin të TNI për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2021, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Kuçovë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t’i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitore progresive dhe e ndarë sipas viteve.

TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2022

Debitor TNI	Subjekte	Vlera
Gjithësej progresive	544	15,579,566
Nga të cilat në 2022	223	6,483,920
Nga të cilat progresive deri në 2021	321	9,095,646

Burimi: Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Kuçovë konstatohet se:

-Vlera debitore progresive është 15,579,566 lekë për 544 subjekte (nga të cilat 223 subjekte për vlerën 6,483,920 lekë krijuar në vitin 2022).

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi z.O.Z, Specialist pranë Drejtorisë së Urbanistikës, zj.P.K, specialiste pranë Drejtorisë së Urbanistikës dhe z.F.P, Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës.

Kriteri: Paketa Fiskale 2022, Pika 4.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 15,579,566 lekë.

Shkaku: Mungesa e marrjes së masave shtrënguese në mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit t'i përcjellë Drejtorisë së të Ardhurave listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës debitore prej 15,579 mijë lekë.

Për tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Kuçovë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kuçovë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr.212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”;

-VKB për miratimin e paketës fiskale;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Kuçovë dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2022-31.12.2022), akti teknik; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimin dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Paketa Fiskale e vitit 2022 dhe rregullore e brendshme e Bashkisë Kuçovë;

-Gjithashtu u kryqëzua informacioni me databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve.

Titulli i Gjetjes: Menaxhimi i të ardhurave nga tarifa e licencimit të subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, si dhe mangësi në përditësimin e regjistrimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve në Bashkinë Kuçovë.

Situata: Në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Kuçovë dhe në Njësitë Administrative, Drejtoria e Transportit në

Bashkinë Kuçovë, strukturë e cila jep autorizimet për tregtimin e karburantit me pakicë/të njësisive të shitjes së lëndëve djegëse, vendosi në dispozicion të grupit të auditimit, dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2022 në Bashkinë Kuçovë

Nr.	Karburanti	Vendi ku është ndertuar
1	"V - 2006" shpk	Lumas (Rruga Çiflik-Vodez)
2	"D-2009" shpk	Lumas, ne qender te fshatit
3	"A P" shpk	Rruga Naftetari, perballe N/Stacioni Elektrik
4	"C 2011" shpk	Kucove, ish Karburanti Shtetit
5	"P" shpk	Kucove, prapa N/Stacionit, Elektrik
6	"F.D" shpk	Kucove, te kthesa te Karburanti
7	S Oil shpk	Kucove, Postbllok
8	"A" shpk	Kucove, te Meteori
9	"B Oil 2013" shpk	Kucove, te Varrezat Publike
10	"R 2018 "shpk	Kucove, poshte Kishes Ortodokse
11	"B" shpk	Dikater, rruga e Geges
12	"A-Oil" shpk	Perondi, rruga per ne Magjate
13	"Q Oil" shpk	Kozare, poshte Ures se Kozares
14	"M Oil" shpk	Kozare, Salce Kozare
15	"T kucova" shpk	Rruga Stanislav Zuber

Burimi: Drejtoria e Transportit, Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura në Bashkinë Kuçovë, për vitin 2022 ushtrojnë këtë aktivitet 15 subjekte. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022, janë debitorë 3 subjekte për vlerën 1,500,000 lekë gjithësej. Konkretisht subjektet janë:

1.C Sh.P.K, subjekt i cili është pajisur me autorizim 5 vjeçar në vitin 2018, si njësi e shitjes së lëndëve djegëse, faturuar 100,000 lekë nga Bashkia Kuçovë dhe likujduar 100,000 lekë, ndërkohë sipas shkresës nr.3758 prot., datë 28.10.2020, subjekti duhet të licencohet si stacion i shitjes së karburantit me pakicë dhe në këto kushte tarifa e licencimit është 1,000,000 lekë. Pra subjekti është njoftuar për likujdimin e vlerës së mbetur 900,000 lekë.

Për këtë subjekt konstatohet se përgjatë vitit 2022 nga Drejtoria e Transportit nuk janë marrë masat në mënyrë shteruese, pasi nuk ka kërkuar bashkëpunim nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), nuk ka kërkuar bashkëpunim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, me qëllim bllokimin e llogarive të subjektit.

Drejtoria e Transportit i është drejtuar për bashkëpunim, me qëllim bllokimin e aktivitetit të subjektit Policisë Bashkiake, e cila është penguar nga subjekti në ushtrimin e detyrës. Për këtë nga Bashkia Kuçovë është bërë kallëzim penal, për pengimin e zyrtarëve në ushtrimin e detyrës së tyre, por jo edhe kallëzim penal për mospagesën e detyrimit, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi S.V, Drejtor i Drejtorisë së Transportit.

2.M Oil Sh.P.K ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën:

13.07.2021-13.07.2022, si dhe 13.07.2022-në vijim, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 400,000 lekë. Për këtë subjekt administrohet kërkesa e Bashkisë Kuçovë drejtuar ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, por në vijim nuk administrohet asnjë masë e marrë dhe në këto kushte Bashkia Kuçovë duhet t'i drejtohej Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Drejtoria e Transportit nuk ka kërkuar bashkëpunim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, me qëllim marrjen e masave shtrënguese nga DAV, ndaj subjektit të mësipërm.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi S.V, Drejtor i Drejtorisë së Transportit.

-Drejtoria e Transportit i është drejtuar për bashkëpunim Policisë Bashkiake për bllokimin e aktivitetit të subjektit M Oil. Nga Policia Bashkiake, konkretisht punonjësit e policisë bashkiake B.S dhe K.V, në datë 15.09.2022 pranë ambjenteve të subjektit është mbajtur akt-kontrolli, nr., seria 00343, ku vetëm është pasqyruar situata dhe i është kërkuar subjektit kryerja e pagesës, por jo të jetë kryer bllokimi i veprimtarisë së tij. Gjithashtu në këtë

kontroll dy policët, në zbatim të Kreut III, tabela 25, pika 1, shkronja “b” duhet të ishte vendosur gjobë në vlerën 20,000 lekë, por nuk është vepruar në këtë mënyrë. *Vlera prej 20,000 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e policisë bashkiake B.S dhe K.V.*

3.A Oil Sh.P.K ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën:

01.11.2022-në vijim, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet, nga Drejtoria e Transportit nuk janë marrë masa, si njoftimi drejtuar ISHTI-t, kërkesa për bashkëpunim nga DAV dhe Policisë Bashkiake.

-Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2022) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 3 subjekte për 3 stacione shitje të karburantit nuk kanë aplikuar për rilicencim/nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 1,500,000 lekë.

-Në mënyrë të përmbledhur, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin Bashkisë Kuçovë, gjithësej 1,500,000 lekë.

Kriteri: Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Rregullore e brendshme e Bashkisë Kuçovë “Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit”, pika 1, si dhe shkronja d, si dhe “Policia Bashkiake”, neni 5 dhe neni 8.

Pika 10 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kuçovë, për vitin 2022.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 1,500,000 lekë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,500 mijë lekë.

Për realizimin e të ardhurave nga tarifave vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kuçovë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kuçovë mbi arkëtimin e tarifës së ndotjes së mjedisit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private në Bashkinë Kuçovë, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Paketa fiskale e vitit 2022, Kreu II, pika 20;

-Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2021 - 31.12.2022;

-Leje ndërtimi, njoftim i fillimit dhe përfundimit të punimeve;

-Faturimi i detyrimit dhe pagesa, sipas regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1.Përshkrimi i situatës.

Bashkia Kuçovë në paketën fiskale të vitit 2022, ka përcaktuar tarifën e përkohshme të ndotjes së mjedisit, duke bërë dy kategorizime, si më poshtë vijon:

1.Tarifa e përkohshme për ndotjen e mjedisit, do të zbatohet për subjektet fizike e juridike që me veprimtarinë e tyre ndotin dhe dëmtojnë mjedisin, duke aplikuar tarifën 150 lekë/m²/vit dhe/ose 150 lekë/m³. *Për faturimin dhe arkëtimin e kësaj tarife, është ngarkuar Drejtoria e Mjedisit dhe Drejtoria e të Ardhurave.*

2.Tarifë për subjekte jashtë bashkisë fitues në tendera e investime me vlerë kontrate, sipas intervalit 0-5 milion lekë, detyrimi është 30,000 lekë për tender; 5.1-10 milion lekë, detyrimi është 50,000 lekë për tender; 10.1 milion lekë dhe në vijim, detyrim është 100,000 lekë për tender. *Për arkëtimin e kësaj tarife, është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.*

Me qëllim auditimin e veprimtarisë së strukturave të mësipërme në faturimin dhe arkëtimin e tarifës së ndotjes, u kryqëzua informacioni i marrë nga Njësia e Prokurimit (procedurat e prokurimit për punime ndërtimi dhe subjektet fitues), Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për njoftimin e fillimit dhe përfundimit të punimeve, lejeve të ndërtimit të dhëna, si dhe Drejtoria e të Ardhurave, për regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, viti 2022, për kategorinë “biznes”.

Nga auditimi u konstatua se përgjatë periudhës 2022, (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2021, por kanë përfunduar në vitin 2022) nuk janë tarifuar 8 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kuçovë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 534,934 lekë⁵.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi 3 struktura të Bashkisë Kuçovë, përkatësisht, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (për 3 subjekte fitues të tenderave), për mostarifimin e subjekteve që kanë fituar tendera; Drejtoria e Mjedisit dhe Drejtoria e të Ardhurave për mostarifimin e 5 subjekteve të tjera që kanë kryer punime ndërtimi.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.F.P, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. S.L, Drejtor i DAV dhe z. B.S, ish Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit.

Kriteri: Kreu II, pika 20 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kuçovë.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 534,934 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Kuçovë (shkëmbimi informacionit ndërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së të Ardhurave), si dhe puna e pamjaftueshme e inspektimit në terren nga inspektorët e Drejtorisë së të Ardhurave.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 534,934 lekë.

Debitor nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake Kuçovë, është në vlerën 51,500 lekë, nga të cilat në vitin 2022 janë 8 gjoba në vlerën 12,000 lekë.

Gjobat e Policisë Bashkiake Kuçovë

Debitor deri në 2022	Subjekte	Vlerë
Gjithësej	39	51,500

⁵ Pasqyruar tabela në kapitullin Anekse – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të cilat në 2022	8	12,000
Nga të cilat deri në 2021	31	39,500

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake Kuçovë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 51,500 lekë, nga të cilat në vitin 2022 janë krijuar 8 gjoba në vlerën 12,000 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse⁶.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj. B.K, Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

Kriteri: Neni 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 51,500 lekë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës dhe mosndjekja plotësisht e procesit të arkëtimin të gjobave të vendosura.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryeinspektori i Policisë Bashkiake Kuçovë, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 51,500 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

III.2.Familjet.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Kuçovë dhe NJA, për vitin 2022 janë taksuar 12286 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile
Qendër	5472	10640
Lumas	1313	2530
Perondi	3503	3387
Kozare	1998	2105
Total	12,286	18,662

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Kuçovë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Kuçovë me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

-Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Kuçovë dhe NJA janë 18662 familje, pra ndërkohë në vitin 2022 janë taksuar 6376 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kuçovë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 700 lekë * 6376 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,463,200 lekë planifikuar më pak.

⁶ Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DAV Bashkia Kuçovë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018⁷, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Kuçovë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Kuçovë dhe NJA.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S.L, Drejtor i DAV, z. E.M, z.M.A, z. K.P, z. B.S, zj.A.Q dhe z.K.SH, agjent tatimor pranë NJA-ve.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Kreu II në Paketën Fiskale të Bashkisë Kuçovë.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i numrit të familjeve për efekt taksimi të tyre ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojë Bashkia Kuçovë nga kategoria “Familjar”.

Shkaku: Mungesa e përditësimit të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjar, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga DAV Bashkia Kuçovë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njërive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, rezultojnë 4,463,200 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Titulli i gjetjes: Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Kuçovë.

Situata: Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit, taksën e ndërtesës, truallit etj (përfshijë taksën e tokës bujqësore).

Numër familje debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	Në fund të vitit 2021 (progresive)		Krijuar brenda vitit 2022		Në fund të vitit 2022 (progresive)	
	Nr	Vlerë				
	3752	51,057,212	3222	1,613,391	3578	52,670,603

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3578 familje debitorë për vlerën 52,670,603 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë 3222 familje debitorë për vlerën 1,613,391 lekë.

-Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitorë e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifatat vendore, në krahasim me fundin e vitit 2021 është rritur me 1,613,391 lekë, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Kuçovë, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Berat –Kuçovë, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Kuçovë. Përfshijë familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfutuar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të

⁷ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

“Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga DAV dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitore.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S.L, Drejtor i DAV, z. E.M, z.M.A, z. K.P, z. B.S, zj.A.Q dhe z.K.SH, agjent tatimor pranë NJA-ve.

Kriteri: Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 52,670,603 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Berat –Kuçovë, për arkëtimin e tyre.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 52,670 mijë lekë.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas DAV Bashkia Kuçovë janë 5539 Ha, sipërfaqe e ndarë me AMTP. Kjo sipërfaqe duhet të shërbejë për Bashkinë Kuçovë për planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Ndarja e tokës bujqësore me AMTP, sipas Njësisë Administrative të Bashkisë Kuçovë, pasqyrohet si me poshtë:

Nr	NJA	Sipërfaqja e tokës, ndarë me AMTP
1	Lumas	1702
2	Perondi	1558
3	Kozare	2278
	Shuma	5538

Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAT Bashkia Kuçovë, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kuçovë

Kategoria e tokës	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Vlera/Ha	Plani/Lekë
	Nj.A. Lumas	Nj.A. Perondi	Nj.A. Kozare	Nj.A.		
Kategoria II		993	40	1033	3,500	3,615,500
Kategoria III		0	138	138	2,800	386,400
Kategoria IV		391	450	841	2,300	1,934,300
Kategoria V	828	138	712	1678	1,900	3,188,200
Kategoria VI	528	329	663	1520	1,600	2,432,000
Kategoria VII	346	265	275	886	1,400	1,240,400
e. Totali sip. ha sipas planifikimit	1702	2116	2278	6096		12,796,800

Sa më sipër konstatohet se në NJA Perondi, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përlllogaritjen e planit, është 558 Ha më pak, ku nëse do ta kthenim në vlerë monetare (çmimi mesatar 3,500 lekë + 2,300 lekë + 1,900 lekë + 1,600 + 1,400 lekë / 5) = 1,194,120 lekë më pak duhet të ishte planifikimi i taksës së tokës bujqësore për NJA Perondi.

Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj. R.B, Administratore e NJA Perondi.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i sipërfaqes së tokës bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj, duke rritur shpresat për më tepër të ardhura dhe për rrjedhojë ndikon negativisht në planifikimin e shpenzimeve të Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

Titulli i gjetjes: Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likujtuar detyrimet për taksën e tokës bujqësore.

Situata: Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për taksën e tokës bujqësore.

Taksa e tokës bujqësore	Në fund të vitit 2021 (progresive)		Krijuar brenda vitit 2022		Në fund të vitit 2022 (progresive)	
	Nr	Vlerë				
	3285	18,593,279		3,744,070	3285	22,337,349

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive vlera debitore është 18,593,279 lekë dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3285 familje debitorë për vlerën 22,337,349 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 është krijuar 3,744,070 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitore për taksën e tokës bujqësore, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e kësaj takse.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitore.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. F.D, Administrator i NJA Kozare, z.A.C, Administrator i NJA Lumas, zj.R.B, Administrator i NJA Perondi, z. B.S, zj.A.Q dhe z.K.SH, agjent tatimor pranë NJA-ve.

Kriteri: Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 22,337,349 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 22,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Përdorimi i të ardhurave.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar përkatësisht në vlerën 197,520 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime.

Përdorimi i të ardhurave – viti 2022 (000 lekë)

Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Nga të ardhurat e veta
1	Paga 600	61,454

2	Sigurime shoqërore 601	9,642
3	Shp. Operat 602	53,042
4	Transferta Korrente te brendshme 604	15
5	Transferta per familje dhe individe 606	7,003
6	Investime 230-231	66,364
	Totali	197,520

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Vlerësimi dhe opinionin për pasqyrat financiare të vitit 2022 nuk është bërë, për shkak se subjekti Bashka Kuçovë, nuk ka përfunduar hartimin e tyre brenda afatit që KLSH ka kryer auditimin në subjekt.

III.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.

4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për periudhën **01.01.2021 – 31.12.2021**, Bashkia Kuçovë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **35** procedura prokurimi me fond limit **420,001,320 lekë pa TVSH**, me vlerë kontrate **406,664,697 lekë pa TVSH**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **13,336,623 lekë pa TVSH**, ose 3%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2021 – 31.12.2021	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	35	420,001,320	406,664,697
-Të hapura	3	393,096,796	380,625,874
- Kërkesë me propozim	0		
- Shërbim konsulence	1	21,666,666	21,520,000
- Negocim pa shpallje	0		
- E hapur e thjeshtuar	0		
- Me vlerë të vogël	31	5,237,858	4,518,823
Sipas objekteve			
-Objekte në fushën e punëve publike	3	378,647,179	366,716,340
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	32	41,354,141	39,948,357

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **293 OE/BOE**, nga të cilat janë s'kualifikuar **169 OE/BOE**. Procedura me 1 (një) OE është vetëm 1 procedura, ose 3% e tyre.

-Për periudhën **01.01.2022 – 31.12.2022**, Bashkia Kuçovë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **24** procedura prokurimi me fond limit **84,355,163 lekë pa TVSH**, me vlerë kontrate **67,910,595 lekë pa TVSH**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **16,444,568 lekë pa TVSH**, ose 19.5%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2022 – 31.12.2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	32	84,355,163	67,910,595
-Të hapura	3	56,985,652	55,633,993
- Kërkesë me propozim			
- Shërbim konsulence			
- Negocim pa shpallje			
- E hapur e thjeshtuar	5	21,317,818	20,047,541
- Me vlerë të vogël	24	6,051,693	4,532,393
Sipas objekteve			
-Objekte në fushën e punëve publike	4	51,198,826	48,762,641
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	28	33,156,337	19,147,954

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **292 OE/BOE**, nga të cilat janë s'kualifikuar **183 OE/BOE** dhe OE të kualifikuar janë gjithsej **32**. Procedura me **1 (një) OE** janë gjithsej 5 procedura, ose 14 % e procedurave të zhvilluara.

4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

-Gjithësej 18 procedura me fond limit 524,496,356 lekë, ose 98% të totalit.

Periudha 01.01.2021-31.12.2022⁸

Prokurimet me vlerë të lartë

- 1.Tenderi me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 2.Tenderi me objekt: “Shërbim për mirëmbajtjen e varrezave publike”;
- 3.Tenderi me objekt: “Blerje automjet zjarrëfikës” për MZSH (Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi);
- 4.Tenderi me objekt: “Blerje eskavatori për ujitjen dhe kullimin;
- 5.Tenderi me objekt: “Ndërtim shtesë kati në objekt ekzistues për strehim social”;
- 6.Tenderi me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve”;
- 7.Tenderi me objekt: “Rikualifikimi urban i sheshit të kombinatit, rrugët Simon Ziu, Hazbi Seranaj, rruga e Poliklinikës, rruga Nënë Tereza, Lagja 11 Shkurti”;
- 8.Tenderi me objekt: “Studim Projektim të Sistemit të ujësjellësit për fshatin Gegë dhe sistemit të kanalizimeve për fshatrat Gegë, Kuçova e Vjetër dhe Salc-Kozare”;
- 9.Tenderi me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqëz, Vodëz, Krekëz dhe Koritëz Njësia Administrative Perondi”;
- 10.Tenderi me objekt: “Blerje karburanti, për vitin 2022”;
- 11.Tenderi me objekt: Rikonstruksion i Rrugës “Donald Hoxha”;

Prokurimet me vlerë të vogël

12. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Gazoil dhe Vaj”;
13. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i kanalit ujitës, (Dega e majtë e rezervuarit Goraj), Njësia Administrative Perondi”;
14. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për funksionimin e paisjeve të zyrave (Tонера)”;
15. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje paisje zyre administrate”;
16. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi goma dhe bateri”;
17. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tонера)”;
18. Procedura e prokurimit me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”.

1.Tenderi me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1.Urdhër Prokurimi Nr.169, Datë 30.07.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 170 datë 30.07.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 170 datë 30.07.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit	1. E.A (Jurist)	1. S.M, Kryetar (Ekonomist)

⁸ Observacionet janë pasqyruar në Kapitullin Aneksë – Aneksi nr.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Procedur e Hapur- Punë Publike	2. A.E (Jurist) 3. F.P (Inxhnier ndërtimi)	2. O.Z, Anëtar (Inxhnier ndërtimi) 3. H.B, Anëtar (Jurist)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 17,363,045 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 12,499,031 lekë, N Sh.P.K	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 4,864,014 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 08.09.2021	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë (20% të vlerës) dhe nga Buxheti i Shtetit (80%)	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b) S'kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 7 OE
11. Ankimime AK-; APP-KPP- s'ka	12. Përgjigje nga AK-s'ka	13. Përgjigje nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3387, datë 08.10.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 14,998,837 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 14,248,895 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 4 (katër) muaj	19. Zgjatja e kontratës

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë s'ka, i ndryshuar, nga NJP, nëpërmjet shtojcës nr.2647 prot., datë 30.08.2021.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

-Pika 2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë: 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/ose certifikatë trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës – Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjës të mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

-Pika 2.3.5. Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit si staf teknik punonjësit si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Sasia
1	Teknik Ndërtimi	(2 persona)
2	bojaxhinj	(2 persona)
3	Karpenier	(2 persona)
4	Hidraulik	(3 person)
5	Elektracist	(2 person)
6	Manovratorë/shofer	(2 persona)
7	Punonjës të certifikuar për “Punime në lartësi”	(2 persona)
8	Murator	(2 persona)
9	Pllakashtrues	(2 persona)
10	Hekurthyes	(1 person)
11	Suvatues	(2 persona)
	Total	22

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur si dhe numri i punonjësve, por është bërë vetëm argumentimi i domosdoshmërisë

(pra nevojitet hidrauliku pasi kemi punime hidraulike dhe kështu me rradhë për të gjithë punonjësit) së profesioneve të mësipërme në përputhje me zërat e preventivit. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektracist (Hidraulik, Manovrator, Teknik ndërtimi, Shofer mjetesh të rënda etj) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike. Për më tepër që për manovratorin, janë të mjaftueshme dëshmitë të cilat jepen sipas kuadrit rregullator të fushës, si dëshmia e aftësisë profesionale për mjete punimi, certifikata e aftësimin profesional, të cilat vërtetojnë kualifikimet e punonjësve në fushën, në të cilën ata kryejnë detyrat e tyre.

-Pika 2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 30 (tridhjetë) persona për një periudhën 3 (tre) mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës – Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 26 punonjës (4 inxhinier dhe 22 staf teknik), pra ngelen edhe 4 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet *“Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin”*.

-Pika 2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetë shkarkues, kapaciteti mbajtës jo më pak 15 (pesëmbëdhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetë shkarkues, kapaciteti mbajtës jo më pak se 20 (njëzetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetë shkarkues, kapaciteti mbajtës 3 – 5 ton	1 copë	Pronësiose me qera
Kamionçinë, kapaciteti mbajtës maksimumi deri në 3 ton për secilin kamionçinë	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji minimum 1000 l	5 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve që kërkohet dhe lloji i tyre, në përputhje me natyrën, sasinë dhe grafikun e punimeve.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: E.A, A.E dhe F.P.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr.170 dt. 30.07.2021 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M, Kryetar, O.Z dhe H.B, Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 08.09.2021 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 20.09.2021 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Me shkresën nr.3316 prot., datë 04.10.2021, NJP i është drejtuar OE N për dorëzimin e dokumentacionit. Me shkresën nr.3316/1 prot., datë 08.10.2021 nga OE N është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Kuçovë. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 08.10.2021 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij. Në këtë tender kanë marrë pjesë 12 OE (renditur OE diferenca më e lartë nga fondi limit – diferenca më e ulët), përkatësisht:

1. OE “FC” Sh.P.K me ofertë ekonomike 12,141,254 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **5,221,791 lekë/30% më pak**;
2. OE “N” Sh.P.K me ofertë ekonomike 12,499,031 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **4,864,014 lekë/28% më pak**;
3. BOE “N 1934” Sh.P.K dhe “B II” Sh.P.K, me ofertë ekonomike 13,390,520 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,972,525 lekë/23% më pak;
4. OE “2” Sh.P.K me ofertë ekonomike 13,455,943 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,907,102 lekë/22.5% më pak;

5. BOE "J" Sh.P.K dhe "C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 13,883,465 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,479,580 lekë/20% më pak;
6. OE "C" Sh.P.K me ofertë ekonomike 13,914,156 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,448,889 lekë/20% më pak;
7. OE "Z" Sh.P.K me ofertë ekonomike 14,630,278 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,732,767 lekë/15.7% më pak;
8. BOE "M" Sh.P.K dhe "E" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 14,905,672 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,457,373 lekë/14% më pak;
9. BOE "K" Sh.P.K dhe "F" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 15,373,042 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,990,003 lekë/11.4% më pak;
10. OE "E-A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 15,532,199 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,830,846 lekë/10.5% më pak;
11. OE "B" Sh.P.K me ofertë ekonomike 15,952,233 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,410,812 lekë/8% më pak;
12. OE "E VL" Sh.P.K pa ofertë ekonomike.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
"E-VL"	Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, si dhe nuk ka paraqitur ofertë
"FC" shpk	Nga dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "FC" shpk, rezulton se ne Licencen nr NZ.5771/6 kjo shoqëri nuk disponon drejtues teknik Inxh. ndërtimi. Inxh i ndërtimit Znj.P.L nuk rezulton të jetë drejtues teknik i pasqyruar në licencën e sipërcituar. Per tre drejtuesit teknik të tjerë të kërkuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 7 të DST nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri. Konkretisht, për drejtuesit teknik Inxhinier Elektrik dhe Inxh.Gjeodet nuk është paraqitur librezja e punës dhe për Inxhinier Hidroteknik nuk është paraqitur CV. Në pikën 2.3.6 të Shtojcës 7 të DST është parashikuar se "Operatorët ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej <u>minimalisht 30 (tridhjetë) persona</u> për një periudhë 3 (tre) mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës". Shoqëria "FC" shpk nuk disponon fuqinë punëtore minimale të kërkuar për muajin Maj 2021. Në këtë muaj rezulton se ka të punësuar vetëm 27 punëtor.
"N 1934" shpk dhe "B II"	Nga dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim operatorësh, rezulton se shoqëria "N 1934" në Licencën nr NZ.2812/12 kjo shoqëri nuk disponon drejtues teknik Inxh. Hidroteknik dhe Inxh Topograf. Ndërkohë ka marrë përsipër punime në këto fusha sipas marrëveshjes me OE B 93II Shoqëria "N 1934" nuk disponon kategorinë e licencës NS-18A, ndërkohë në marrëveshjen e bashkëpunimit me OE "B II" ka marrë përsipër punime të kësaj natyre. Për dy drejtues teknik të kërkuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 7 të DST nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri. Konkretisht, për drejtuesin teknik Inxh. B M nuk është paraqitur CV dhe Inxh.V.SH nuk është paraqitur librezja e punës.
"K" shpk dhe F shpk	OE K sh.p.k nuk disponon drejtues teknik Inxh. Hidroteknik. Ndërkohë ka marrë përsipër punime në këtë fushë sipas marrëveshjes me shoqërinë F shpk . OE K sh.p.k nuk disponon numrin minimal të punojësve për realizimin e punimeve sipas % të punimeve që ka marrë përsipër sipas marrëveshjes me shoqërinë F sh.p.k . "B" shpk Në pikën 2.4 të Shtojcës 7 të DST është parashikuar se : "Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar i standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht : PAS 99-2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit e vlefshme), ose ekuivalent. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur Çertifikaten ISO PAS 99-2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit e vlefshme), ose ekuivalent.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE N Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 12,499,031 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 4,864,014 lekë/28% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.
-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht⁹, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk është plotësuar pika **2.2 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Korçë përgjatë periudhës 2020-2021¹⁰.

⁹ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

¹⁰ Sipas dokumentacionit të administruar në sistem dhe në dosjen fizike, dorëzuar me shkresën n.3316/1 prot., datë 08.10.2021, janë dorëzuar 7 dokumente për vërtetimin e përmbushjes së pikës së mësipërme (Deklaratë, Vërtetim Bashkia Shkodër, Vlorë, Lezhë, Gjirokastrë, Lezhë, Pukë dhe Tiranë).

- Manovratorit Benet Ndoci i ka mbaruar afati i lejes së drejtimit për kategorinë C (kamiona).
- Nuk plotësohet pika 2.3.7 e DST për mjetin “Autobetoniere”, pasi OE N ka dorëzuar dokumentacion për betoniere dhe jo autobetoniere, e cila është makinë ndërtimi me goma që përdoret në kantieret ose sheshet e ndërtimit¹¹.
- Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, S.M, Kryetar, O.Z dhe H.B, Anëtar.

2.Tenderi me objekt: “Shërbim për mirëmbajtjen e varrezave publike”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit.		
1. Urdhër Prokurimi Nr.128, Datë 16.06.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 127 datë 16.06.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 127 datë 16.06.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Proçedur e Hapur- Shërbime	1. L.K (Jurist) 2. E.A (Jurist) 3. A.E (Jurist)	1. S.M, Kryetar (Ekonomist) 2. F.P, Anëtar (Inxhinier ndërtimi) 3. J.L, Anëtar (Inspektor IMTV)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 14,527,520 lekë për 4 vite/3,631,880 lekë në vit	6. Oferta fituese (pa TVSH) 13,983,628 lekë, P Sh.P.K	7. Diferenca me fondin limit (paTVSH) 543,892 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 06.07.2021	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP-KPP OE P. Sh.P.K	12. Përgjigje nga AK Vendimi nr.2504/1 prot., datë 29.07.2021 Vendimi nr.2, datë 13.08.2021	13.Përgjigje nga APP apo KKP vendimi i KPP nr.446, datë 04.08.2021 vendimi i KPP nr.667, datë 23.09.2021
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3665, datë 01.11.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 16,780,353 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 4,195,089 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 48 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 18.06.2021.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

-Pika 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

-1 Drejtues Teknik inxhinier Mjedisi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriterit operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Diplomën

Kontratën e punës individuale ose noteriale

Inxhinieri i mësipërm, duhet të jenë të siguar dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 1 vjeçare Qershor 2020 - Maj 2021 – Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (1 vjeçare) e vendosur për punonjësin e mësipërm. Gjithashtu sqarohet se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 3 vite/5 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3 ose 5 vite)¹². Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 3 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pastrimit etj, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me

¹¹ Pika 2 në nenin 8 Kreu III në Urdhrin Nr. 200, datë 16.5.2019 Për miratimin e rregullores “për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

¹² Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

ligj, dëshmohej edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 1 viti që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë.

-Pika 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

3 (tre) punonjës krahu mirëmbajtje të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*.

2 (dy) punonjës të jenë punues mermeri të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*.

1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë/ose çertifikatë trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)* - Është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kjo dëshmi lëshohet për rastet kur punonjësit punojnë me pajisje elektrike.

-Gjithashtu kërkesa për disponimin e çertifikatës/ose çertifikatës së trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

-Pika 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit - Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 7 punonjës (1 inxhinier dhe 6 staf teknik), pra ngelen edhe 3 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”. Për AK është e rëndësishme që të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi. Në kushtet e mësipërme një OE që po merrë pjesë në procedurën e prokurimit, mund të ketë rekrutuar staf të ri (që nuk figuron i punësuar pranë këtij OE për një periudhë 1 vjeçare), i cili zotëron eksperiencë të mëparshme, por duke vendosur kriterin e mësipërm, ky OE e ka të pamundur të marrë pjesë në garë, pasi ai disponon numrin minimal, me formimin e duhur, eksperiencën, por nuk i ka të punësuar për 1 vit pranë shoqërisë së tij.

-Pika 2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavatorë	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadromë	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozita uji mbi 500 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
Motokorrese bari	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektrogur	2 copë	Pronësi ose me qera

-Sa më sipër është kërkuar minieskavator dhe minifadromë, ndërkohë mund të kërkohet vetëm minifadromë e cila bën gërmimin e dheut, si dhe zbankimin e zhavorrit. Gjithashtu në kërkesën për dy mjetet e mësipërme nuk përcaktohet se mjetet e mësipërme duhet të jenë me goma apo me zinxhir, kërkesë e cila kushtëzon disponimin e rimorkiatorit nga OE. Konkretisht nëse do të përcaktohej që minifadroma me zinxhir, atëher OE duhet të ketë

rimorkiator për transportimin e tij dhe në këto kushte veç disponimit të rimorkiatorit, rimorkiatori duhet të jetë i pajisur me certifikatë pronësie, targa, siguracion etj.

-Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i manovratorit. E njëjta situatë konstatohet edhe për kamionin me vinç.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: L.K, E.A dhe A.E.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr. 127 datë 16.06.2021 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M, Kryetar, F.P dhe J.L, Anëtar.

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 06.07.2021 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 19.07.2021 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Me shkresën nr.3510 prot., datë 19.10.2021 nga OE P Sh.P.K është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Kuçovë. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 19.10.2021 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, përkatësisht:

1.OE "P" Sh.P.K me ofertë ekonomike 13,983,628 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **543,892 lekë/4% më pak;**

2.OE "S" Sh.P.K me ofertë ekonomike 12,410,237 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **2,117,283 lekë/14.5% më pak;**

3.OE "E VL" Sh.P.K pa ofertë ekonomike.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
"E-VL"	Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, si dhe nuk ka paraqitur ofertë
"S" shpk	Nga dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "S" shpk, rezulton se nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE P Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 13,983,628 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 543,892 lekë më pak.

Ankesa e cila lidhet me përcaktimin e fituesit.

Në procedurën e mësipërme, pas vlerësimit të kryer nga KVO, dokumentuar në SPE dhe me procesverbalin datë 19.07.2021, janë renditur dy oferta të suksesshme, përkatësisht:

1. OE "S" Sh.P.K me ofertë ekonomike 12,410,237 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **2,117,283 lekë/14.5% më pak;**

2. OE "P" Sh.P.K me ofertë ekonomike 13,983,628 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **543,892 lekë/4% më pak.**

▪ OE P Sh.P.K ka paraqitur ankesë, administruar në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr.2675 prot., datë 10.08.2021, po kështu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në ankesë, OE Piennis kundërshton vlerësimin e bërë nga KVO, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:

-OE nuk ka të regjistruar në aktivitetin e tij, kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi;

-OE nuk ka kryer furnizime të ngjashme;

-OE duke qenë se nuk ka kryer furnizime të ngjashme, krijohet bindja se nuk ka punonjësit, specialist të fushës.

-OE P Sh.P.K ka kërkuar pezullimin e procedurës, verifikimin e dokumentacionit të OE S Sh.P.K, si dhe anulimin e vendimit të KVO.

▪ Në vijim, me urdhrin nr.178, datë 13.08.2021, Kryetari i Bashkisë Kuçovë, ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesës (KSHA), me përbërje si vijon: A.B, L.D dhe A.ZH.

▪ Me vendimin nr.2, datë 13.08.2021, KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës, me arsyetimin si më poshtë vijon:

-Ankesa është dorëzuar jashtë afatit.

▪ Me shkresën nr.2711 prot., datë 13.08.2021, Bashkia Kuçovë i është drejtuar KPP, për përcjelljen e vendimit të KSHA.

- Me shkresën nr.2710 prot., datë 13.08.2021, Bashkia Kuçovë i është drejtuar OE S, për përcjelljen e vendimit të KSHA.
 - Me shkresën nr.2707/1 prot., datë 13.08.2021, Bashkia Kuçovë i është drejtuar OE P, për përcjelljen e vendimit të KSHA.
 - Me shkresën nr.3190 prot., datë 27.09.2021 është administruar pranë Bashkisë Kuçovë, vendimi i KPP nr.667, datë 23.09.2021, për shqyrtimin e ankesës së OE P. KPP ka arsyetuar se ankesa është brenda afatit ligjor, si dhe pretendimi i OE P se OE S nuk ka punë të ngjashme, qëndron. KPP në përfundim ka vendosur:
 - Të pranojë ankesë e OE P Sh.P.K;
 - AK lejohet të anulohet vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e OE S, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke s'kualifikuar këtë OE;
 - AK brenda 10-ditëve të vëre në dijeni KPP, për zbatimin e vendimit;
 - Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës së paguar nga OE S Sh.P.K;
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit;
 - Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim APP.
 - Me shkresën nr.3304 prot., datë 04.10.2021 është administruar pranë Bashkisë Kuçovë, vendimi i KPP nr.690, datë 29.09.2021, për korrigjimin e pikës 4 të dispozitivit 667/2021, konkretisht:
 - Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës së paguar nga OE S Sh.P.K;
- Bëhet*
- Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës së paguar nga OE P Sh.P.K;
 - Në zbatim të sa më sipër, ka dalë vendimi nr.23, datë 29.09.2021 i Kryetarit të Bashkisë, për anulimin e vendimit të KVO dhe korrigjimin e shkeljeve sipas vendimit të KPP.
 - Gjithashtu me vendimin nr.24, datë 30.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë është hequr pezullimi i procedurës. Vendimet e mësipërme i janë përcjellë KPP me shkresën nr.3190/1 prot., datë 30.09.2021.
 - Me shkresën nr.3390 prot., datë 11.10.2021 është administruar pranë Bashkisë Kuçovë, vendimi i KPP nr.725, datë 06.10.2021, për zbatimin e vendimit të mëparshëm nga AK. Në përfundim KPP ka vendosur të lejojë AK për vazhdimin e hapave të mëtejshëm të procedurës.
 - Me shkresën nr.3487 prot., datë 18.10.2021, është njoftuar OE P për shpalljen fitues, dokumentuar edhe në SPE, dorëzimin e sigurimit të kontratës për të vazhduar më tej.
- OE shpallur fitues përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit.*

3.Tenderi me objekt: “Blerje automjet zjarrëfikës” për MZSH (Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi) në Bashkinë Kuçovë, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 131, Datë 19.05.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr.133, Datë 24.05.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.133, Datë 24.05.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Mallra.	1.E.A (Jurist) 2.A.V (Jurist) 3.A.P (Inxhinier)	1.S.M 2.S.V 3.J.L
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4,480,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE A.G me ofertë 4,340,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 140,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.06.2022	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP-KPP-S'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.1998, datë 22. 06.2022 . “AG”	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 5,208,000 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 5,208,000 lekë
17.Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 1 (një) muaj	19. Zgjatja e kontratës

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 19.05.2022, nga NJP.

Nga auditimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifitimeve teknike të vendosura për automjetin zjarrfikës (i përdorur), u konstatua se:

Në pikën 2.1 përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale - Nuk është kërkuar që OE, i cili do të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të jetë i pajisur me licencën të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, nënkategoria VII.3.B.1 dhe/ose VII.3.B.2, kjo për të garantuar që OE ushtron aktivitet në përputhje me kuadrin rregullator, si dhe për të përmbushur deklaratën e garancisë, pra riparimin e defekteve brenda afatit 1 vjeçar¹³.

Në pikën 2.6 është kërkuar që OE duhet ta kenë mjetin në pronësi, vërtetuar kjo në një prej mënyrave të mëposhtme.

-me certifikatën e pronësisë;

-ose me faturën tatimore të blerjes së automjetit objekt prokurimi – Referuar pikës 2.4 të kriterëve të kualifikimit, nënkuptohet se automjeti do të importohet nga jashtë dhe është i paregjistruar në regjistrin publik të automjeteve, pasi nëse do të ishim në rastin kur mjeti është importuar dhe regjistruar, atëherë në çmimin e kontratës nuk do të përfshiheshin shpenzimet e regjistrimit të mjetit, kontrollit fizik të tij etj, por shpenzimet e regjistrimit të kontratës së shitblerjes, ndryshimit të pronësisë, përditësimit të certifikatës së pronësisë dhe lejes së qarkullimit, si dhe kontrollit teknik nëse do të ishte e nevojshme. Në kushtet e mësipërme, për të vërtetuar pronësinë e mjetit me dokumentacion të plotë në formë dhe përmbajtje duhet të ishte kërkuar:

- Dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;
 - Dokumenti i zhdoganimit (DAV) të lëshuar nga Dogana Shqiptare;
 - Dokumentin e origjinës së mjetit me treguesit teknikë, ku shënohet edhe kategoria mjedisore e mjetit, dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti si leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose ç’regjistrim për eksport, në origjinal;
 - Kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;
 - Konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS, për mjetet e përdorura të blera në vend.
- Certifikatat e konformitetit dhe dokumentet teknik të mjetit, të lëshuar nga prodhuesi dhe që janë homologe me ato të BE;
- Certifikatat e regjistrimit të plotësuara me kodet e harmonizuara të BE, si dhe certifikatat e regjistrimit të lëshuar nga vendet e BE;

Sa i përket specifitimeve teknike, konstatohet se:

- Gomat e mjetit janë kërkuar në gjëndje shumë të mirë, pra specifikim jo konkret dhe i vështirë për t’u vlerësuar nga komisioni i marrjes në dorëzim të automjetit, ndërkohë që për gomat duhet të ishte përcaktuar thellësia e konsumit të tyre, element i cili tregon gjendjen fizike të gomave dhe për më tepër është specifikim i matshëm. Gjithashtu sa i përket gomave të automjetit, nuk është kërkuar etiketa shoqëruese e tyre, e cila tregon plotësimin e

¹³ Këtu OE për të përmbushur deklaratën e garancisë, mund të paguaj një servis të licencuar për të kryer riparimet e nevojshme në rast se krijohet nevoja, por në këtë rast duhet të që servisi të deklarojë se merrë përsipër dhe për llogari të OE, kryerjen e riparimeve brenda afatit 1 vjeçar.

standardeve europiane/amerikane të cilësisë, si dhe bënë klasifikimin e tyre në bazë të konsumit të karburantit, fërkimit në lagështirë dhe zhurmës që gjenerojnë gjatë ecjes.

- Nuk është përcaktuar lloji i lëndës djegëse të motorit.

- Nuk është përcaktuar kapaciteti i rezervuarit të shkumës dhe materiali përbërës i rezervuarit. Për më tepër është lënë opsionale varianti i disponimit të depozitës së shkumës, pjesë e rëndësishme e funksionimit dhe realizimit të qëllimit të mjetit zjarrfikës, atë të shuarjes së zjarreve nga materiale të lëngshme ose lëngje të ngurtësuar, të tilla si nafta, dylli, llaku, vajrat dhe yndyrnat minerale, etj.

- Nuk është përcaktuar sasia e ujit/minutë që jep pompa kundër zjarrit.

- Nuk është përcaktuar norma e sharkimit (norma euro) në ajër të ndotësve të gaztë, si të monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit të shprehura si ekuivalent i dyoksidit të azotit (NO₂) dhe hidrokarbureve në total (THC), përfshirë lëndë të ngurta pezull (PM).

- Nuk është vendosur përcaktimi se sa orë pune duhet të ketë automjeti zjarrfikës, por është vendosur kilometrazhi i tij. Sqarojmë se kilometrazhi nuk është specifikim i rëndësishëm që tregon gjëndjen teknike të një mjeti teknologjik, por janë orët e punës, pasi një automjet zjarrfikës mund të kryejë lëvizje në distanca të vogla, por mund të ketë punuar për një kohë të gjatë.

- Nuk është përcaktuar prania e aksesorëve të ndryshëm që duhet të ketë çdo automjet zjarrfikës, kryesisht zorrë thithëse, filtër uji, shpërndarës uji, kolektor uji etj.

- Nuk janë kërkuar shkallët portative për ngjitje në lartësi të ndryshme, rastet e shpëtimit.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: E.A, A.V dhe A.P.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr.133, datë 24.05.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M Kryetar, S.V dhe J.L Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 13.06.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 17.06.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Me shkresën nr.1988 prot., datë 22.06.2022 nga OE AG është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Kuçovë. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë --.06.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, përkatësisht:

1.OE "AG" Sh.P.K me ofertë ekonomike 4,340,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **140,000 lekë/3% më pak**. Në përfundim të fazës së vlerësimit të ofertave është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "SG".

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁴, nga OE shpallur fitues, konstatohet se OE shpallur fitues përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit.

Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara.

-Me urdhrin nr.141, datë 03.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të automjetit, me përbërje si vijon: F.P, përgjegjës i sektorit të MZSH, E.K, drejtues i shuarjes së zjarrit, G.I, A.C dhe S.O, shofer.

-Për marrjen në dorëzim të mjetit dhe verifikimin e tij, nga komisioni i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbali nr.2217 prot., datë 13.07.2022.

-Kontrata e lidhur ndërmjet palëve nr.1998 prot., datë 22.06.2022, me afat lëvrimit të mallit 1 muaj nga lidhja e kontratës, pra deri më datë 22.07.2022.

-Fatura tatimore e lëshuar nga OE A, është me nr., 127/2022, datë 12.07.2022 me vlerën 5,208,000 lekë me TVSH;

-Urdhër shpenzimi nr.756, datë 09.09.2022.

-Në procesverbal është pasqyruar se mjeti zjarrfikës është sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

¹⁴ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Për verifikimin e vërtetësisë së informacionit të pasqyruar në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, grupi i auditimit, i përbërë nga z. K.K dhe z. A.G, verifikoi pranë ambjenteve të sektorit të MZSH, automjetin zjarrfikës, mbi gjëndjen viuzale të tij, numrin e vëndeve të mjetit, depozitën e ujit, gomat, matjen e dimensioneve të mjetit sipas specifikimeve;

Kërkuar	Rezultuar
Gjatësia – (Min 6 m – 6.6 m Max)	6.5 m
Gjerësia – (Min 2 m – 2.5 m Max)	2.4 m
Lartësia – (Min 2.5 m – 3 m Max)	2.9 m

Gjithashtu u kryen 5 teste, për gjëndjen funksionale të mjetit, të gjykuara nga grupi i auditimit si më të rëndësishmet dhe që lidhen me qëllimin e mjetit, pra shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, konkretisht u testua hedhja dhe thithja e ujit, hedhja e shkumës, hapja e zinxhirave automatik, funksionimi i panelit komandues të motorit, pompës së ujit, ku rezultoi se nga automjeti zjarrfikës kryhen funksionet e mësipërme.

4.Tenderi me objekt: “Blerje eskavatori për ujitjen dhe kullimin në Bashkinë Kuçovë, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 95, Datë 12.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr.93, Datë 11.04.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.93, Datë 11.04.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Mallra.	1.L.K (Jurist) 2.E.A (Jurist) 3.A.V (Jurist)	1.S.M 2.S.V 3.J.L
5. Fondi Limit (pa TVSH) 8,300,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE S CO me ofertë 8,249,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 51,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.04.2022	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP–KPP-S’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1796, datë 06.06.2022 .	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 9,898,800 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 9,898,800 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 3 (tre) muaj	19. Zgjatja e kontratës

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 15.04.2022, nga NJP.

Nga auditimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të vendosura për mjetin eskavator me goma (i përdorur), u konstatua se:

Në pikën 2.1 përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale - Nuk është kërkuar që OE, i cili do të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të jetë i pajisur me licencën të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, nënkategoria VII.3.B.1, kjo për të garantuar që OE ushtron aktivitet në përputhje me kuadrin rregullator, si dhe për të përmbushur deklaratën e garancisë, pra riparimin e defekteve brenda afatit 1 vjeçar¹⁵.

Sa i përket specifikimeve teknike, konstatohet se:

- Gomat e mjetit janë kërkuar në gjëndje shumë të mirë, pra specifikim jo konkret dhe i vështirë për t’u vlerësuar nga komisioni i marrjes në dorëzim të automjetit, ndërkohë që për gomat duhet të ishte përcaktuar thellësia e konsumit të tyre, element i cili tregon gjëndjen

¹⁵ Këtu OE për të përmbushur deklaratën e garancisë, mund të paguaj një servis të licencuar për të kryer riparimet e nevojshme në rast se krijohet nevoja, por në këtë rast duhet të që servisi të deklarojë se merrë përsipër dhe për llogari të OE, kryerjen e riparimeve brenda afatit 1 vjeçar.

fizike të gomave dhe për më tepër është specifikim i matshëm. Gjithashtu sa i përket gomave të automjetit, nuk është kërkuar etiketa shoqëruese e tyre, e cila tregon plotësimin e standardeve europiane/amerikane të cilësisë, si dhe bënë klasifikimin e tyre në bazë të konsumit të karburantit, fërkimit në lagështirë dhe zhurmës që gjenerojnë gjatë ecjes.

- Nuk është përcaktuar norma e shkakimit (norma euro) në ajër të ndotësve të gaztë, si të monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit të shprehura si ekuivalent i dyoksidit të azotit (NO₂) dhe hidrokarbureve në total (THC), përfshirë lëndë të ngurta pezull (PM).

-Nuk është përcaktuar kapaciteti minimal i kovës.

-Është përcaktuar specifikimi me emërtimin “pesha” jo më pak se 15000 kg, por nuk kuptohet nëse është për peshën e eskavatorit apo kapaciteti ngritës, duke e bërë një specifikim jo konkret.

-Nuk është përcaktuar kutia e ndërrimit të marsheve, manual, automatik apo i kombinuar, si dhe niveli i ndërrimit të marsheve.

-Nuk është përcaktuar lartësia e shkarkimit.

-Nuk është përcaktuar forca gërmuese e kovës.

-Nuk janë kërkuar foto të eskavatorit me qëllim verifikimin e tij nga KVO për gërvishtje, plasaritje etj.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: L.K, E.A dhe A.V.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr.93, datë 11.04.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M Kryetar, S.V dhe J.L Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 29.04.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 17.06.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Me shkresën nr.1988 prot., datë 22.06.2022 nga OE S është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Kuçovë. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë --.05.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender ka marrë pjesë 2 OE, përkatësisht:

1.OE “S CO” Sh.P.K me ofertë ekonomike 8,249,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **51,000 lekë/0.6% më pak**.

2.OE “T I” Sh.P.K me ofertë ekonomike 8,300,000 lekë pa TVSH, pa diferencë nga fondi limit.

Në përfundim është shpallur fitues OE “S CO” Sh.P.K dhe është s’kualifikuar OE “T I” Sh.P.K, për arsyet:

-Nuk ka paraqitur liçensë të vlefshme të kategorisë VII.3.B.2 “Liçensë për blerje, shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkio”.

-Nuk ka paraqitur vetdeklarim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratat që disponon.

S’kualifikimi i ofertës së paraqitur nga OE “T.I” Sh.P.K qëndron.

-OE “S CO”, plotëson kriteret e vendosur në DST.

Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara.

-Me urdhrin nr.94, datë 11.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të automjetit, me përbërje si vijon: A.D (Manovrator), D.B (Inxhinier ndërtimi), N.S (Përgjegjës i sektorit të bujqësisë).

-Për marrjen në dorëzim të mjetit dhe verifikimin e tij, nga komisioni i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbali nr.2450 prot., datë 04.08.2022;

-Kontrata e lidhur ndërmjet palëve nr.1796 prot., datë 06.06.2022, me afat lëvrimiti të mallit 3 muaj nga lidhja e kontratës, pra deri më datë 06.09.2022;

-Fatura tatimore e lëshuar nga OE S CO, është me nr., 96/2022, datë 25.07.2022 me vlerën 9,898,800 lekë me TVSH;

-Urdhër shpenzimi nr.756, datë 09.09.2022;

-Në procesverbal është pasqyruar se mjeti eskavator me goma është sipas specifikimeve teknike të kërkuara;

-Për verifikimin e vërtetësisë së informacionit të pasqyruar në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, grupi i auditimit, i përbërë nga z. K.K dhe z.A.G, verifikoi në prani të manovratorit, z.A.D (anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të eskavatorit), mjetin eskavator me goma, mbi gjëndjen vizuale të tij, numrin e kovave, rrotullimin e tij 360°, punimin e krahut të eskavatorit, punimin e thikës përpara, vëllimin e kovave, ku rezultoi se mjeti eskavator me goma është sipas specifikimeve teknike.

5.Tenderi me objekt: “Ndërtim shtesë kati në objekt ekzistues për strehim social”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1. Urdhër Prokurimi Nr.222, Datë 23.08.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 221 datë 23.08.2022 1. E.A (Jurist) 2. L.K (Jurist) 3. F.P (Inxhinier ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 221 datë 23.08.2022 1. S.M, Kryetar (Ekonomist) 2. S.V, Anëtar (Inxhinier ndërtimi) 3. J.L, Anëtar (Inspektor IMTV)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedur e Hapur- Punë Publike		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 19,617,165 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 18,640,630 lekë, Z Sh.P.K	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 976,535 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 14.09.2022	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë (20% të vlerës) dhe nga Buxheti i Shtetit (80%)	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP-KPP- s’ka	12. Përgjigje nga AK-s’ka	13. Përgjigje nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3104, datë 10.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 22,368,755 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 15,922,303 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës 4 (katër) muaj	19. Zgjatja e kontratës

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 23.08.2022, i ndryshuar, nga NJP, nëpërmjet shtojcës nr.2716 prot., datë 06.09.2022.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

-Pika 2.3.2 AK kërkon disa lloje licencash që duhet të disponojë OE që do të kryejë punimet e ndërtimit, ku një ndër këto është licenca e llojit NP-3 A, e cila nuk është e nevojshme në këtë natyrë punimesh, pasi referuar edhe argumentimit të dhënë nga NJP, punimet që përfshin kjo licencë, ezaurohen nëpërmjet 2 llojeve të tjera të licencave, përkatësisht NP-2 A dhe NS-4 A. Për më tepër që në këtë rast kemi të bëjmë me ndërtim shtesë kati mbi katin ekzistues dhe të gjitha punimet lidhen me ndërtimin nga e para e këtij kati, pra jo edhe punime mirëmbajtje, risuvatim, rikonstruksion i katit të parë të objektit.

-Pika 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

Inxhinier Ndërtimi-1 (një)

Inxhinier Hidroteknik-1 (një)

Inxhinier Elektrik-1 (një)

Inxhinier Topograf-1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për një periudhë 3 mujore, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës - Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësin e mësipërm. Pra pse duhet të jetë 3 muaj në listëpagesë dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjykojmë se kërkesat për kapacitetet teknike dhe

profesionale, lidhur me disponimin e inxhinierëve, ezarohen duke kërkuar disponimin e tyre gjatë pjesëmarrjes në procedurë, përfshirjen e tyre si drejtues teknik. Gjithashtu sqarohet se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)¹⁶. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përbushjen e kapaciteteve teknike.

-Pika 2.3.5. Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit si staf teknik punonjësit si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Punonjës
1	Punonjës/specialist duralumini	1 (një)
2	Mekanik	1 (një)
3	Hidroizolues	1 (një)
4	Hidraulik	2 (dy)
5	Elektricitist	2 (dy)
6	Karpiere	2 (dy)
7	Specialist të certifikuar për punimet në lartësi	2 (dy)
8	Teknik ndërtimi	2 (dy)
9	Punëtor/Specialist ndërtimi 3 (tre)	3 (tre)
10	Hekurkthyes	3 (tre)
11	Pllakashtrues	4 (katër)
12	Bojaxhi	4 (katër)
13	Manovrator	4 (katër)
14	Murator	5 (pesë)
Totali 36 punonjës		

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

-Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme), kontrate pune e vlefshme, certifikatat përkatëse si edhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës - Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE.

-Për karpentierët dhe specialistët të certifikuar për punime në lartësi nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektricitist (Hidraulik, Hidroizolues, Teknik ndërtimi, Specialist ndërtimi, hekurkthyes, pllakashtrues, bojaxhi etj) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike.

-Është kërkuar specialist ndërtimi dhe teknik ndërtimi, por nuk arsyetohet se cili është ndryshimi ndërmjet këtyre dy profesioneve, si dhe për më tepër referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, i ndryshuar, nuk ekziston një pozicion pune me emërtimin “Specialist ndërtimi”. Pra kërkesa për një specialist ndërtimi, është e pabazuar, si dhe krijon paqartësi. Në rastin e mësipërm duhet të ishte kërkuar vetëm teknik ndërtimi.

¹⁶ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

-Pika 2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 55 persona në listë-pagesë për periudhën 3 (tre) mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës – Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 43 punonjës (4 inxhinier dhe 36 staf teknik, 1 punonjës i pajisur me certifikatën “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, 1 ekspert për ndihmën e parë dhe 1 ekspert zjarrëfikës), pra ngelen edhe 12 punonjës për të cilët nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”. Veç sa më sipër në argumentimin që ka dhënë NJP për numrin prej 55 punonjësish, është shprehur se numri 55 punëtorë, është numri minimal, ndërkohë që në çdo analizë të kryer më sipër, pra ku është përcaktuar numri dhe lloji i profesionit, është shprehur se ka përcaktuar numrin minimal, pra janë kërkuar 4 pllakashtrues dhe sipas analizës së kryer, ky është numri minimal për të realizuar kontratën, për punimet shtrim pllakash. Kjo mënyrë është përdorur për 14 llojet e profesioneve. Në këto kushte kur është përcaktuar numri minimal i punonjësve për realizimin e kontratës, është e panevojshme kryerja e një analize tjetër për të përcaktuar numër tjetër minimal të punonjësve.

-Pika 2.3.4, nga AK është kërkuar që OE të ketë 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/ose certifikatë trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

-Pika 2.3.7, nga AK është kërkuar që OE duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës ose kontratë shërbimi/apo nënkontraktimi për ushtrimin e profesionit "Ekspert zjarrëfikës" (mbrojtja kundra zjarrit). Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj, ose çfarë do lloj dokumenti që vërteton certifikimin e mësipërm. Në rastin e mosdiponimit të ekspertit zjarrëfikës në stafin e tyre nga ana e ofertuesve, të paraqitet kontrata e shërbimit me kompani të licencuara, ose nënkontraktimit të punonjësit përkatës. Njësia e prokurimit sqaron se për punonjësën e kërkuar si më sipër, përkon me punimet për implementimin e tyre sipas preventivit të hartuar nga AK, dhe konkretisht zërave nga nr 64 deri tek 77.

-Pika 2.3.8 nga AK është kërkuar që OE duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj, ose çfarë do lloj dokumenti që vërteton certifikimin e mësipërm.

Njësia e prokurimit gjykon se për punonjësën e kërkuar më sipër, garantohet autoritetin kontraktor që subjektet ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Duke marrë në konsideratë faktin që ky investim do të kryhet në një kat egzistues me 12 familje brenda, ngritja e kantierit sipas kushteve teknike të përcaktuar në VKM e mësipërme dhe disponimi nga ana e ofertuesve të një *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*, garanton AK për zbatimin e kontratës në kohë dhe me sukses duke shmangur çdo të papritur ose ndonjë aksident të mundshëm.

-Sa më sipër sqarojmë për **pikën 2.3.4** në procesverbalin e argumentimit të kritereve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listë-pagesë) e vendosur për punonjësën e mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontraktojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

-Për pikën 2.3.7 sqarojmë se referuar zërave të preventivit të punimeve, konkretisht zërave me nr.64-77, kemi të bëjmë me furnizim dhe vendosje të pajisjeve kundër zjarrit, si dhe përcaktimeve të kryera në VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, i ndryshuar, për kodin e profesionit me nr.3112 “**Teknikë të inxhinierisë civile**” **parashikohet se:** Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një tërësi detyrash teknike që kontribuojnë në fushën kërkimore të inxhinierisë së ndërtimit dhe në projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e objekteve të dhe strukturave të tjera të tilla si, sisteme të ujësjellësit, ura, aeroporte rrugë dhe diga. Ata mund të punësohen në kompani private dhe shtetërore që sigurojnë ndërtimin, mirëmbajtjen dhe parandalime të rreziqeve nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë të rrezikshëm.

Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

-Marrin masa për sigurimin e përmbushjes së të gjitha specifikimeve të projektit, të rregullave dhe ligjeve përkatëse, si dhe për ruajtjen e standardeve të kërkuara për materialet dhe punën e kryer;

-Inspektojnë ndërtime industriale, hotele, kinema dhe objekte të tjera për të identifikuar rreziqe të mundshme nga zjarri dhe japin udhëzime për eliminimin e tyre;

-Këshillojnë për instalimin e pajisjeve zbuluese të zjarrit dhe pajisjeve për fikjen e tij, për përdorimin e materialeve në ndërtimin e objektit dhe për mjetet e transportit që reduktojnë rrezikun nga zjarri dhe dëmet nëse ai ndodh;

Pra sa më sipër në kushtet kur është kërkuar inxhinier ndërtimi, është e panevojshme që të kërkohej disponimi i një punonjësi me certifikatë “ekspert zjarrëfikës”, qoftë edhe për praninë e tij gjatë vendosjes së pajisjeve kundër zjarrit.

-Sa i përket **pikës 2.3.8** nuk ka ndryshim ndërmjet punonjësit të pajisur me certifikatë/ose certifikatë trajnimit si “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” dhe punonjësit me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes, pra jo me patjetër duhet ta ketë punonjësin e tij.

-Pika 2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
	Kamioncine 3 deri ne 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine deri ne 3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me Vinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Pomp penobetoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
7	Autobeniere mjet	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Cope 1
12	Armatura druri (betoforma) 500 m2	në pronësi ose me qira	500 m ²
13	Vinç kullë me krah jo me pak se 10 meter	në pronësi ose me qira	Cope 1
14	Aparat topogjeodezik me GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Depozite uji 1000l	në pronësi ose me qira	Cope 1
16	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Pajisje niveluese për nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Fabrikë prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin	në pronësi me qira/ose kontratë furnizimi	Copë 1

Sa më sipër është kërkuar kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, kjo për të ngarkuar Hekur Ø 6-10 në sasinë 2 ton dhe Hekur Ø > 10 në sasinë 6 ton, pra gjithësej 8 ton. Duke qënë se hekuri prodhohet standart 12 m, disponueshmëria e 1 kamionit të sipërcitur në përmasa të mëdha është i domosdoshëm për transportimin e këtyre materialeve pranë kantierit të ndërtimit – Sqarojmë se për sasinë e hekurit nevojitet kamion me kapacitet

mbajtës 10 ton, ndërkohë NJP veç kapacitetit mbajtës, për të justifikuar kërkesën, duhet të kishte kërkuar edhe përmasat e kazanit të kamionit, me qëllim depozitimin e shufrave të hekurit me gjatësi 12 m. Pra argumentimi i NJP nuk është i mjaftueshëm dhe nuk justifikon kërkesën për një kamion me kapacitet mbajtës 20 ton.

-Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve për kamion vetëshkarkues 3-5 ton (2 cop), si dhe kërkohet kamionçinë kapaciteti maksimal 3 ton (2 cop). Gjithashtu theksojmë se transportimi i materialeve hidraulike, elektrike, dyer dhe dritare, nuk do të kryhet brenda të njëjtës ditë, pasi janë punime të cilat shtrihen në kohë të ndryshme dhe në këto kushte një kamion/kamionçinë mund të kryej disa rrugë dhe të realizohet qëllimi.

-Gjithashtu nuk është argumentuar teknikisht numri i kamionave me vinç, në përputhje me volumin e punimeve. Citohet vetëm se ky numër është i nevojshëm për të realizuar punime brenda afatit 2 mujor për ngritjen e tullave në katin e dytë, por nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë, pra materialet që do të ngrihen me vinç, pesha totale e tyre, sa peshë mund të ngrejë kamioni në një ngritje dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa pesha mund të ngrejë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 352 orë pune gjithësej (2 muaj), për të arritur në numrin 2 kamiona me vinç. Për ta ilustruar në mënyrë të thjeshtuar: Një kamion me vinç mund të ketë kapacitet ngritës 2 ton dhe në ditë mund bëjë 10 ngritje, pra gjithësej 20 ton për 8 orë pune. Gjithësej kemi 100 ton materiale për t'u ngritur me vinç, dhe për 5 ditë pune duhet 1 kamion me vinç, ose 2 kamiona me vinç për 3 ditë pune. Kjo analizë mungon në procesverbalin e mësipërm.

-Veç kamionave me vinç për ngritjen e tullave është kërkuar edhe vinç kull për ngritjen e tjegullave të çatisë, kërkesë e paargumentuar teknikisht, pasi tjegullat mund të transportohen në katin e dytë edhe me kamionat me vinç. Kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e OE që nuk kanë një vinç kullë, por kanë kamion me vinç dhe transportimi i materialeve kryhet përsëri.

-Gjithashtu kërkohet që OE ofertues duhet të disponojë në pronësi/me qira/kontratë furnizimi me fabrikë prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin. Vendosja e këtij kriteri nënkupton që kur nuk disponon vetë një fabrikë të tillë, duhet me patjetër kontratë e lidhur me prodhuesin e dyer dritareve PVC dhe duralumin, ndërkohë që OE mund të kenë kontratë furnizimi edhe me distributorin e autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me këto materiale¹⁷ dhe qëllimi i realizimit të kontratës, pra furnizimit me materialet e mësipërme realizohet.

-Veç sa më sipër në rastin kur ka kontratë qiraje/furnizimi ndërmjet OE që do të marrë pjesë në garë dhe subjektit prodhues të dyer-dritareve me material PVC dhe duralumin, është kërkuar që OE të dorëzojë certifikata standartizimi ISO 14001:2015 dhe ISO 9001:2015 të fabrikës së prodhimit, pra është vendosur kërkesë për palë të treta. Këtu sjellim në vëmendje të NJP edhe shkresën e APP nr.4916/2 prot., datë 14.07.2022 me lëndë "Sjellje vëmendje" drejtuar autoriteteve kontraktore, ku në pikën 3 të kësaj shkresë është kërkuar që AK nuk duhet të kërkojnë: "Certifikata të prodhuesit, të cilët mund të mos jenë konkurrentë në procedurën e prokurimit, apo për dokumente që i'u përkasin operatorëve ekonomikë që nuk janë palë në procedurën e prokurimit".

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: E.A, L.K dhe F.P.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr. 221 datë 23.08.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M, Kryetar, S.V, J.L, Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 14.09.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 22.09.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë --.10.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, përkatësisht:

¹⁷ Pikat 5-9 në nenin 3 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

1.OE "F" Sh.P.K me ofertë ekonomike 16,120,885 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **3,496,280 lekë/18% më pak**;

2.OE "Z" Sh.P.K me ofertë ekonomike 18,640,630 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **976,535 lekë/5% më pak**.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
"F"	-Nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST-së, gërma e). Mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik ofertues "F" SHPK në shtojcën 8 të formularit përmbledhës të vetdeklarimit janë aktive në kontratën e lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Kuçovë dhe "F" SHPK në objektin "Rikualifikimi urban i lagjes Llukan Prifti". Për rrjedhojë çënohet zbatimi i kontratës së re për sa kohë që mjetet janë të deklaruar në një tjetër kontratë. -Nuk ka paraqitur dokumenta dhe nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit për mjetin "Pompë penobetoni". -Nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST-së dhe konkretisht për fabrikën e prodhimit të dyerve, dritareve dhe PVC duralumini. Ka paraqitur vetëm kontratën e furnizimit. Mungon çertifikata e pronësisë ose kontrata blerje e makinerisë që të vërtetojë lidhjen e shoqërisë prodhuese me distributorin. Gjithashtu mungojnë dhe çertifikatat e konformitetit ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 ose ekuivalente të saj.

-Në kushtet e mësipërme është për zgjedhur fitues OE Z Sh.P.K, me ofertë ekonomike 18,640,630 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 976,535 lekë/5% më pak.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁸, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk është plotësuar pika **2.1 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Tiranë përgjatë periudhës 2021. Konkretisht, sipas QKB, rezulton se më datë 16.12.2015 është hapur adresë sekondare Tiranë-Qyteti i Nxënësve Rruga Hamdi Pepa, magazina nr.61, adresë e cila është mbyllur më datë 23.04.2021.

-Sa i përket mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se OE nuk plotëson pikën 2.3.10 për:

1.Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës minimumi 20 ton, siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin Tetor 2022, ka përfunduar afatin e vlefshmërinë më datë 28.09.2022.

2.Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3-5 ton, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:314 Nr.Kol:134 me subjektin "M.C", por ky subjekt nuk disponon çertifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

3.Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3 ton, siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin Tetor 2022, ka përfunduar afatin e vlefshmërinë më datë 21.09.2022.

Lidhur me sa më sipër, për çertifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 "Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;

¹⁸ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

- e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.
 7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.
 8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.
 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, S.M, Kryetar, S.V, J.L, Anëtar.

6-Tenderi me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 104, Datë 20.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 103 datë 20.04.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 103 datë 20.04.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedur e Hapur- Mallra (Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara)	1. L.K (Jurist) 2. E.A (Jurist) 3. A.V (Jurist)	1. S.M, Kryetar (Ekonomist) 2. S.V, Anëtar (Inxhinier ndërtimi) 3. J.L, Anëtar (Inxhinier ndërtimi)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 31,177,600 lekë/4 vite 7,794,400 lekë në vit	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE “S.T” Sh.P.K me ofertë 29,800,000 lekë për 4 vite	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 1,377,600 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 09.05.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP-KPP- s’ka	12. Përgjigje nga AK-s’ka	13. Përgjigje nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1795, datë 6/6/2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 35,760,000 lekë	16. Likuiduar deri 31.12.2022. 8,940,000 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës 4 vite	19. Zgjatja e kontratës

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 21.04.2022, nga NJP.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

-Pika 2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion ATP kapacitet mbajtës min. 1.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1

Sa më sipër janë kërkuar 2 kamiona me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, pasi në muaj AK do të furnizohet me rreth 170 ton materiale ndërtimi, si zall lavatrice, rërë lavatrice, çakull makinerie, çimento. Bazuar në argumentimin e dhënë në procesverbalin përkatës konstatohet se, kërkesa për kapacitetin mbajtës mbi 20 ton nuk është argumentuar plotësisht, pasi nuk është bërë një analizë se sa rrugë do të bëjë kamioni në ditë për të furnizuar me mallrat e mësipërme Bashkinë Kuçovë brenda një muaji. Nëse i referohemi afatit prej 1 muaj për lëvrimin e mallrave, atëherë mjafton edhe një kamion me kapacitet mbajtës deri në 10 ton, pasi në ditë do të transportohen rreth 8 ton materiale ndërtimi, për 22 ditë në një muaj. Për më tepër që nuk argumentohet numri i kamionave, pse 2 kamiona dhe jo 1, shoqëruar me analizë teknike, sipas volumit dhe grafikut të punimeve.

-Nuk argumentohet kërkesa për 1 kamion të llojit ATP. Sqarojmë se këto janë mjete transporti me karroceri izotermike me ose pa grup frigorifer/kalorifer dhe shërbejnë kryesisht për transportin e ushqimeve delikate.

-Gjithashtu kërkohet që OE ofertues duhet të disponojë në pronësi/me qira/kontratë furnizimi me subjekt shfrytëzim gurore, për furnizimin me materiale inerte. Vendosja e këtij kriteri nënkupton që kur OE nuk ushtron vetë një aktivitet të tillë, duhet me patjetër kontratë e lidhur me prodhuesin e materialeve inerte, ndërkohë që OE mund të kenë kontratë furnizimi edhe me distributorin e autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me këto materiale¹⁹ dhe qëllimi i realizimit të kontratës, pra furnizimit me materialet e mësipërme realizohet.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: L.K, E.A, dhe A.V.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr. 103 datë 20.04.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M, Kryetar, S.V, J.L, Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 09.05.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 16.05.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Bashkia Kuçovë me shkresën nr.1624 prot., datë 20.05.2022 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 26.05.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, përkatësisht:

1. BOE "A" Sh.P.K dhe "A" Sh.P.K me ofertë ekonomike 26,826,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **4,351,600 lekë/14% më pak;**
2. OE "M" Sh.P.K me ofertë ekonomike 27,998,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **3,179,600 lekë/10% më pak;**
- 3.OE "ST" Sh.P.K me ofertë ekonomike 29,800,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **1,377,600 lekë/4% më pak.**

¹⁹ Pikat 5-9 në nenin 3 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
"BOE "A" Sh.P.K dhe "A" Sh.P.K"	-Nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST-së, për furnizime të ngjashme. -Nuk plotëson pikën 2.5 të DST-së për kontratën e qirasë për objektin gurore.
OE "M" Sh.P.K	-Nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST-së, për furnizime të ngjashme. -Nuk plotëson pikën 2.3.2 të DST-së për punonjësën shofer

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE ST Sh.P.K, me ofertë ekonomike 29,800,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,377,600 lekë/4% më pak.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht²⁰, nga OE shpallur fitues, rezulton se OE ST Sh.P.K plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit.

7-Tenderi me objekt: "Rikualifikimi urban i sheshit të kombinatit, rrugët Simon Ziu, Hazbi Seranaj, rruga e Poliklinikës, rruga Nënë Tereza, Lagja 11 Shkurti", me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1.Urdhër Prokurimi Nr.292, Datë 01.11.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 291 datë 01.11.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 291 datë 01.11.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Proçedur e Hapur- Punë Publike	1. E.A (Jurist) 2. A.E (Jurist) 3. F.P (Inxhinier ndërtimi)	1. S.M, Kryetar (Ekonomist) 2. S.V, Anëtar (Inxhinier ndërtimi) 3. J.L, Anëtar (Inspektor IMTV)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 25,065,155 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) BOE BC dhe GC me ofertë ekonomike në vlerën 24,690,031 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 375,124 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.12.2022	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë dhe nga Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP-KPP- s'ka	12. Përgjigje nga AK-s'ka	13. Përgjigje nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 545, datë 10.02.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 29,628,031 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 -
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës 4 (katër) muaj	19. Zgjatja e kontratës

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 24.11.2022.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

-Pika 2.3.2 AK kërkon disa lloje licencash që duhet të disponojë OE që do të kryejë punimet e ndërtimit, ku një ndër këto është licenca e llojit NP-12 A "Punime të inxhinierisë së mjedisit", e cila në mënyrë të thjeshtuar përfshin procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte - Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence. Për më tepër që çdo projekt i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është e zaturuar përpara zbatimit të tij. Zbatimi i masave të përcaktuara në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, është objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale

²⁰ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

e Mjedisit, Berat, në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Sjellim në vëmendje këtu rekomandimet e APP me shkresat nr.7998 prot., datë 24.12.2021 dhe nr.6732 prot., datë 21.10.2020.

-Arsyetimi i mësipërm vlenë edhe për kërkesën e AK në pikën **2.3.3**, sa i përket disponimit të inxhinierit të mjedisit.

-Pika 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

Inxhinier Ndërtimi Profili Transport-1 (një)

Inxhinier Hidroteknik-1 (një)

Inxhinier Elektrik-1 (një)

Inxhinier Topograf/Gjeodet-1 (një)

Inxhinier Mjedisit-1 (një)

Inxhinier Mekanik-1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për një periudhë 3 mujore, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës - Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjës in dhe mësipërm. Pra pse duhet të jetë 3 muaj në listëpagesë dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjykojmë se kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale, lidhur me disponimin e inxhinierëve, ezarohen duke kërkuar disponimin e tyre gjatë pjesëmarrjes në procedurë, përfshirjen e tyre si drejtues teknik. Gjithashtu sqarohet se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)²¹. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

-Pika 2.3.4, nga AK është kërkuar që OE të ketë 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/ose certifikatë trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

-Gjithashtu nga AK është kërkuar që OE duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Njësia e prokurimit gjykon se për punonjës in dhe kërkuar më sipër, garantohet autoritetin kontraktor që subjektet ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Duke marrë në konsideratë faktin që ky investim do të kryhet në një kat egzistues me 12 familje brenda, ngritja e kantierit sipas kushteve teknike të përcaktuar në VKM e mësipërme dhe disponimi nga ana e ofertuesve të një *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*, garanton AK për zbatimin e kontratës në kohë dhe me sukses duke shmangur çdo të papritur ose ndonjë aksident të mundshëm.

²¹ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

-Sa më sipër sqarojmë për **pikën 2.3.4** në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjës të mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

-Sa i përket **kërkesës në vijim** nuk ka ndryshim ndërmjet punonjës të pajisur me çertifikatë/ose çertifikatë trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe punonjës të çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes, pra jo me patjetër duhet ta ketë punonjës të tij.

-**Pika 2.3.5.** Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit si staf teknik punonjës si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Punonjës
1	Hidraulikë	1 (një)
2	Teknikë Ndërtimi	1 (një)
3	Elektracistë	2 (dy)
4	Karpetier	2 (dy)
5	Specialist për montim tubash	2 (dy)
6	Manovratorë	5 (pesë)
Totali 13 (trembëdhjetë) punonjës		

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

-Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme), kontrate pune e vlefshme, çertifikatat përkatëse si edhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjës duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektracist (Hidraulik, Teknik ndërtimi, Karpentier etj) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjës të tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike.

-Janë kërkuar 2 specialist për montim tubash, ndërkohë është kërkuar edhe një hidraulik – Kërkesa për specialist tubash është e panevojshme. Sqarojmë se hidrauliku është personi i specializuar për kryerjen e detyrave të tilla. Referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, i ndryshuar, hidrauliku/ja në banesa dhe ujësjellës merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai/Ajo monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesorët për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme ndërtimi, në shoqëri që kanë reparte të shërbimit hidraulik dhe të vetëpunësohet. Pra në rastin konkret mund të ishin kërkuar 2 hidraulik.

-Pika 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Mjetet me goma	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtës 5-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
3	Fadromë me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
4	Eskavator me goma 0.25 m ³	1 copë	Pronësi ose me qera
5	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës min 10 (dhjetë) ton deri në 20 (njëzetë) ton për secilin kamion)	2 copë	Pronësi ose me qera
6	Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
11	Depozita uji 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
12	Karroca	4 copë	Pronësi ose me qera
13	Betoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
14	Rula vibrues	2 copë	Pronësi ose me qera
15	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
16	Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
17	Zyre Kantieri	1 copë	Pronësi ose me qera
18	Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
19	Fabrike Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera/ ose kontratë furnizimi

-Referuar procesverbalit të argumentimit të kërkesës për mjetet e mësipërme, konstatohet se kjo kërkesë nuk është shoqëruar me analizë teknike, duke bërë përlllogaritjet referuar peshës së materialeve, rrugë në ditë, afatin konkret për transportin e secilit material, pra kur duhet të jenë në kantier materialet, për të arritur në përfundimin se duhet një mjet i një llojit të caktuar, me kapacitet mbajtës specifik.

-Kërkohet kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, si dhe kamion vetëshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtës 5-10 ton, ndërkohë që një OE mund të ketë një kamion vetëshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtës 5 ton dhe e përmbush qëllimin e kërkesës së dy mjeteve.

-Kërkohen dy kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton, por numri i tyre dhe kapaciteti mbajtës nuk është argumentuar teknikisht. Pra sipas NJP këto dy mjete nevojiten për realizimin e zërave të punimeve 3.87/b gërmim dheu kanal me makineri KUSH në sasinë 100 m³, 3.87/b gërmim dheu kanal me makineri KUZ në sasinë 150 m³, 3.182/a shtresë rëre natyrore t=10 cm nën tub në sasinë 100 m², 3.211 shtresë cakëlli t=20 cm përhapur e ngjeshur me makineri në sasinë 5306 m², 3.212/b shtresë stabilizanti 10 cm në sasinë 5306 m², 2.37/3a transport material ndërtimi dheu me auto deri në 3 km etj – Pra në asnjë rast nuk është përlllogaritur pesha në ton e materialeve të mësipërme, për të nxjerrë vlerësimin se duhet kamion me kapacitet mbajtës 10-20 ton. Gjithashtu në asnjë rast nuk është bërë vlerësimi analitik për numrin e kamionave, psh., kemi 100 ton materiale ndërtimi (raporti m³ në ton), materialet e mësipërme duhen brenda 5 ditëve në kantier, 1 kamion me kapacitetin e mësipërm mund të bëjë 2 rrugë në ditë, ose transporton rreth 40 ton materiale në ditë. Nëse këto materiale duhen për 3 ditë, atëherë një kamion mjafton, por nëse këto duhen për dy ditë, atëherë është e nevojshme që të rritet numri i kamionëve.

-Gjithashtu vendosja e intervaleve minimum dhe maksimum për kapacitetin mbajtës në kamionat e mësipërm (3.5-5 dhe 5-10) dhe në 2 të tjerë me kapacitet 10-20 ton, kufizon konkurrencën, pasi mund të ketë OE që disponojnë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton dhe nuk mund të marrë pjesë në procedurë.

-Nuk argumentohet numri i rulave vibrues, në raport me volumin dhe afatin e punimeve që do të kryhen nga ky mjet.

-Gjithashtu kërkohet që OE ofertues duhet të disponojë në pronësi/me qira/kontratë furnizimi me fabrikë prodhimi asfalti. Vendosja e këtij kriteri nënkupton që kur nuk disponon vetë një fabrikë të tillë, duhet me patjetër kontratë e lidhur me prodhuesin e asfaltit, ndërkohë që OE mund të kenë kontratë furnizimi edhe me distributorin e autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me këto materiale²² dhe qëllimi i realizimit të kontratës, pra furnizimit me asfaltin

²² Pikat 5-9 në nenin 3 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar.

realizohet.

-Veç sa më sipër në rastin kur ka kontratë qiraje/furnizimi ndërmjet OE që do të marrë pjesë në garë dhe subjektit prodhues, është kërkuar që OE të dorëzojë certifikata standartizimi ISO 14001:2015 dhe ISO 9001:2015 të fabrikës së prodhimit, pra është vendosur kërkesë për palë të treta. Këtu sjellim në vëmendje të NJP edhe shkresën e APP nr.4916/2 prot., datë 14.07.2022 me lëndë “Sjellje vëmendje” drejtuar autoriteteve kontraktore, ku në pikën 3 të kësaj shkresë është kërkuar që AK nuk duhet të kërkojnë: “Certifikata të prodhuesit, të cilët mund të mos jenë konkurrentë në procedurën e prokurimit, apo për dokumente që i’u përkasin operatorëve ekonomikë që nuk janë palë në procedurën e prokurimit”.

Në pikën 2.3.9 kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave, Kodi III.2.B – Sipas paketës fiskale të vitit 2022 Bashkia Kuçovë në zonën që do të zhvillohet projekti, aplikon tarifën e pastrimit, ndotjes, pra në kushtet kur bashkia e siguron shërbimin e pastrimit si dhe e tarifon subjektin për kohëzgjatjen e kantierit, është e panevojshme vendosja e kërkesës për disponimin e licencës së mësipërme. Sa i përket transportit të dheut nuk është e nevojshme pajisja me licencën e mësipërme, pasi në këtë rast dheu është material ndërtimi dhe do t’i nënshtrohet transformimit fizik. Për transportin e dheut si mall, shërben certifikata e transportit të mallrave që lëshohet për mjetin përkatës.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: E.A, L.K dhe F.P.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr. 221 datë 23.08.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M, Kryetar, S.V, J.L, Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 12.12.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 23.12.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 10.01.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 OE, përkatësisht:

1.OE “2” Sh.P.K me ofertë ekonomike 23,598,173 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **1,466,982 lekë/6% më pak;**

2.BOE “BC” dhe “GC” Sh.P.K me ofertë ekonomike 24,690,031 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **375,124 lekë/1.5% më pak;**

3.OE “B” Sh.P.K me ofertë ekonomike 25,124,361 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **59,206 lekë më tepër;**

4.BOE “M” dhe “M” Sh.P.K me ofertë ekonomike 19,958,869 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **5,106,286 lekë/21% më pak;**

5.OE “Z” Sh.P.K me ofertë ekonomike 25,028,632 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **36,523 lekë/0.1% më pak;**

Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s’kualifikimit
“2”	<p>OE “2” shpk nuk plotëson pikën 2.3.8 pika d) të DST dhe konkretisht në formularin e vetdeklarimit, shtojca 8, ka deklaruar një mjet Eskavator 0.25 m3 me goma. KVO pasi bëri verifikimin, rezultoi se OE ka lidhur kontratë me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë dhe mjetet e sipërcituar janë deklaruar dhe shpallur fitues në procedurën me objekt : “Rehabilitimi i emergjencës Civile, Muri mbajtës të Godinës DSIK”. OE “2” shpk, ka lidhur kontratën e zbatimit nr. Nr.21648/5 Prot. datë 27.10.2022 me Bashkinë Tiranë, me afat 8 (tetë) javë kalendarike. (buletini Nr 173 datë 19.12.2022).</p> <p>Nga verifikimi i bërë sipas pikës 7, të nenit 26, të VKM - së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, rezultoi se Ing. HA, në cilësinë e Drejtuesit Teknik si inxhinier topograf/gjeodet, i përcaktuar në Formularin e Vetëdeklarimit, rezultoi i dypunësuar.</p> <p>Kontrata e qirasë me Nr rep 4139 dhe Nr kol 1547 e lidhur në date 08.06.2021 për marrjen me qera të mjetit tip eskavator me afat 2 vjeçar midis palëve shoqëria “2” shpk dhe qiradhënësit Z.AM nuk është paraqitur e saktë dhe e plotë, për sa kohë në kontratën e nënshkruar midis palëve, tek gërma C/ Zgjidhja dhe prishja e kontratës është parashikuar se : Kontrata konsiderohet e zgjidhur automatikisht në rast se qeramarrësi nuk paguan një muaj qeranë. KVO gjykon se shoqëria “2” shpk duhet të paraqiste të paktën faturën e qerasë të paguar për muajin e fundit, që kontrata të cilësohet aktive dhe në fuqi, në përputhje me pikën C) të kontratës së nënshkruar midis palëve.</p> <p>Kontrata e qirasë me Nr rep 3637 dhe Nr kol 1331 e lidhur në date 20.05.2021 për marrjen me qera të mjetit tip ATV marka Volvo me afat 5 vjeçar midis palëve shoqëria “2” shpk dhe qiradhënësit Z.E.O nuk është paraqitur e saktë dhe e plotë, për sa kohë në kontratën e nënshkruar midis palëve, tek gërma C/ Zgjidhja dhe prishja e kontratës është parashikuar se : Kontrata konsiderohet e zgjidhur automatikisht në rast se qeramarrësi nuk paguan një muaj qeranë. KVO gjykon se shoqëria “2” shpk duhet të paraqiste të paktën faturën e qerasë të paguar për muajin e fundit, që kontrata të cilësohet aktive dhe në fuqi, në</p>

	<p>përputhje me pikën C) të kontratës së nënshkruar midis palëve.</p> <p>Kontrata e qirasë me Nr rep 8779 dhe Nr kol 4190 e lidhur në date 25.11.2022 për marrjen me qera të mjetit tip Asfaltoshtruese, Grejder, Rrul AMMANN, rrul i tipit DYNAPAC, dhe rrul i tip matr.32r024a me afat 5 vjeçar midis palëve shoqëria “2” shpk dhe qiradhënësit shoqëria “E” shpk nuk është paraqitur e saktë dhe e plotë, për sa kohë në kontratën e nënshkruar midis palëve, tek gërma C/ Zgjidhja dhe prishja e kontratës është parashikuar se : Kontrata konsiderohet e zgjidhur automatikisht në rast se qeramarrësi nuk paguan një muaj qeranë. KVO gjykon se shoqëria “2” shpk duhet të paraqiste të paktën faturën e qerasë të paguar për muajin e fundit, që kontrata të cilësohet aktive, në përputhje me pikën C) të kontratës së nënshkruar midis palëve, për sa kohë në pikën II të gërmas b) të kontratës është parashikuar se pagesa do të kryhet çdo datë 1 të muajit pasardhës.</p> <p>Kontrata e qirasë me Nr rep 8401 dhe Nr kol 3999 e lidhur në datë 11.11.2022 për marrjen me qera të mjetit Rrul tip Bomag BÈ120AD-4 me afat 5 vjeçar midis palëve shoqëria “2” shpk dhe qiradhënësit shoqëria “AC” shpk nuk është paraqitur e saktë dhe e plotë, për sa kohë në kontratën e nënshkruar midis palëve, tek gërma C/ Zgjidhja dhe prishja e kontratës është parashikuar se : Kontrata konsiderohet e zgjidhur automatikisht në rast se qeramarrësi nuk paguan një muaj qeranë. KVO gjykon se shoqëria “2” shpk duhet të paraqiste të paktën faturën e qerasë të paguar për muajin e fundit, që kontrata të cilësohet aktive dhe në fuqi, në përputhje me pikën C) të kontratës së nënshkruar midis palëve, për sa kohë në pikën II të gërmas b) të kontratës është parashikuar se pagesa do të kryhet çdo datë 1 të muajit pasardhës.</p>
“B”	<p>Nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST dhe konkretisht, nuk ka paraqitur dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme.</p> <p>Nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, dhe konkretisht nuk ka paraqitur “Licensë Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave”,</p> <p>Nuk plotëson pikën 2.2.1 dhe 2.2.2 të DST, nuk ka paraqitur dokumentacion për xhiron minimale vjetore si dhe për bilancet vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.</p>
BOE “MIG” dhe “M/S”	<p>Anëtari i BOE “MFIG” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST dhe konkretisht, nuk ka paraqitur dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme në përputhje me % e marrë përsipër sipas marrëveshjes së nënshkruar midis palëve.</p> <p>Anëtari i BOE “MFIG” shpk nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, dhe konkretisht nuk ka paraqitur “Licensë Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave”, për sa kohë në marrëveshjen e bashkëpunimit së nënshkruar midis palëve ka marrë përsipër të kryej zërin 2.37/3a transport material ndërtimi dheu me auto deri në 3 km.</p> <p>Anëtari i BOE “M” nuk plotëson pikën 2.3.3 për inxhinierin elektrik dhe pikën 2.3.5 të DST për elektrikist 2 (dy) pesona. Nuk ka paraqitur asnjë dokument për punonjësit e mësipërm. Në kontratën e bashkëpunimit së nënshkruar midis palëve, anëtari i BOE “M” shpk ka marrë përsipër të kryej të gjitha punimet elektrike ku ndërkohë nuk disponon as inxhinier elektrik, as punonjës të specializuar/të kualifikuar.</p>
“Z”	Nuk ka licensë me Kodin III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave

-Në kushtet e mësipërme është për zgjedhur fitues BOE “BC” dhe “G.C” Sh.P.K me ofertë ekonomike 24,690,031 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 375,124 lekë/1.5% më pak.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht²³, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nga BOE BC dhe G.C nuk është plotësuar pika **2.1 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, konkretisht nga OE BC, për dorëzimin e vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Dimal, si dhe për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet të regjistruara në QKB “Transport” në Bashkinë Tiranë.

-Nga BOE BC dhe G.C nuk është plotësuar pika **2.3.5 e DST**, konkretisht për disponimin e 5 manovratorëve. Referuar formularit të vetëdeklarimit janë pasqyruar të dhëna për 5 manovrator, konkretisht:

AS, AP, GH, ES, DR dhe DB, gjithësej 6 manovrator.

Sa më sipër rezulton se:

-Për punonjës të AP është plotësuar deklarata “shtojca 8” njëkohësisht edhe si hidraulik, për të cilin është dorëzuar kontratë pune, me pozicionin hidraulik. Pra ngelen 5 manovrator. Sa i përket dokumentacionit të dorëzuar për punonjës të AH, nuk konsiderohet, pasi është punonjës i padeklaruar në shtojcën 8.

-Leja e manovrimit për punonjës të GH, është lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, ndërkohë për këto leje manovrimi, me hyrjen në fuqi të VKM nr.736, datë 01.07.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit” dhe nenin 15 në Urdhrin nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, këto leje manovrimi duhet t’i nënshtrohen rinovimit

²³ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

të tyre, pasi ka ndryshuar organi që lëshon dëshminë e aftësisimit profesional për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, është parashikuar rinovimi për efekt vlefshmërie të dokumentit. Pra ngelen 4 manovrator, në kushtet kur OE BC nuk ka dorëzuar asnjë dokument për manovrator.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, S.M, Kryetar, S.V, J.L, Anëtar.

8.Tenderi me objekt: “Studim Projektim të Sistemit të ujësjellësit për fshatin Gegë dhe Sistemit të Kanalizimeve për Fshatrat Gegë, Kuçova Vjetër dhe Salc Kozare të Bashkisë Kuçovë”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i procedurës së prokurimit.		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 407. Datë 18.12.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 406 Datë 18.12.2020	3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 406 Datë 18.12.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit Shërbim Konsulence	1. L.K 2. E.A 3. A.E	1. S.M 2. F.P 3. J.L
5. Fondi Limit (pa TVSH) 21,666,666 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) BOE D dhe A me ofertë ekonomike në vlerën 21,520,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 146,666 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 05.01.2021	9. Burimi Financimit Nga buxheti i shtetit, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, me shkresën Nr.4241 Prot, datë 04.12.2020	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar në fazën e dytë 4 OE d) Shpallur fitues 1 BOE
11. Ankimime AK-; APP-KPP-S’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.972, datë 17.03.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 25,824,000 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 25,824,000 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës 30 (tridhjetë) ditë, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 18.12.2020.

AK për kapacitetin ekonomik dhe financiar ka kërkuar:

Pika 3.1.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit (2017, 2018, 2019), vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit – Ndërkohë sipas shkronjës “b” në pikën 4 të nenit 28 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e kërkuar nuk duhet ta tejkalojë 40%.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

Pika 4.1 OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej minimalisht 40 % të vlerës së fondit limit – Ndërkohë sipas pikës 3 të nenit 28 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e kërkuar nuk duhet ta tejkalojë 40%.

Pika 5 OE duhet të jetë i pajisur me liçencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për studim e projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI) me kategoritë e mëposhtme:

3/a Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

3/c Objekte me shkalle të larta veshitësie Beton Arme-metalike 2.Troje dhe shpate me qendruëshmeri të ulët.

3/d Vlersëim i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4/a Instalime hidrosanitare;

4/c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;

- 4/f Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- 5/b Furnizim me uje – kolektore shkarkimi;
- 5/c Ujësjellës kanalizime urbane - rurale.
- 5/d Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga deri 10m – damba.
- 6/a Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- 6 b Rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.
- 6/c Shtresa rrugore e sistemim - asfaltime.
- 8/a Rivelime inxhinierike.
- 8/b Rilevime inxhinierike kadastrale.
- 8/d Bazamente gjeodezike
- 9/a Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate;
- 9/e Studime e projekte hidrogjeologjike
- 10e Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

- Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kategoritë e mësipërme të licencave nuk janë argumentuar teknikisht në përputhje me veprën që do të projektohet.

Pika 6.1 OE duhet të paraqesë një listë të stafit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë secilin prej tyre, diplomat, kontratat individuale të punës dhe licencën sipas legjislacionit në fuqi si vijon:

1 inxhinier hidroteknik (Drejtues teknik licencën e shoqërisë) me eksperience pune jo më pak se 10 vjet.

1 inxhinier ndërtimi me eksperience pune jo më pak se 10 vjet

1 inxhinier gjeodet me eksperience pune jo më pak se 10 vjet

1 inxhinier mekanik me eksperience pune jo më pak se 10 vjet

1 inxhinier elektrik me eksperience pune jo më pak se 10 vjet

1 inxhinier gjeolog me eksperience pune jo më pak se 10 vjet

1 inxhinier mjedisi me eksperience pune jo më pak se 10 vjet

Për stafin e mësipërm, duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë (ku të figurojnë të punësuar me kohe të plotë) për periudhën e kërkuar Mars – Nëntor 2020, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune (me kohe të plotë) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të kontratës për këtë objekt. Për të provuar pikën e mësipërme duhet të paraqitet, kontrata e vlefshme për periudhën e realizimit të shërbimit, diploma dhe licenca.

Staf ndihmës të paraqitet

1 Inxhinier ndërtimi/hidroteknik

1 Inxhinier Gjeodet

Për stafin e mësipërm duhet të paraqitet kontratë noteriale pune me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të kontratës për këtë objekt, CV dhe diploma e inxhinierit – Sa më sipër konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur për eksperiencën e stafit inxhinierik. Sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 3 vite/5 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3 ose 5 vite) . Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 3 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e projektimit etj, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 9 muajsh i punësuar me kohë të plotë pranë OE, si dhe 10 vite eksperienvë, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Veç sa më sipër është e paargumentuar përse stafi inxhinierik duhet të jetë i punësuar pranë OE për periudhën prej 9 muajsh, ndërkohë që një pjesë e inxhinierëve mund të kontraktohen

vetëm për dhënien e kontributit të tyre deri në përfundimin e projektimit të ndërtimit të ujësjellësit.

Pika 7 OE duhet të vërtetojë me dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: Numri mesatar i të paktën 10 (dhjetë) punonjësve për periudhën Mars –Nëntor 2020 – Për këtë kriter nuk argumentohet periudha e vendosur, nuk përcaktohet qartë se ky numër është veç numri të inxhinierëve të kërkuar dhe nëse është kështu çfarë formimi profesional duhet të kenë, si dhe cili do të jetë roli i tyre.

Pika 9 OE duhet të ketë pjesë të stafit ekspert për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor – Kërkesë e panevojshme, e paargumentuar dhe jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe konsulencës që do të jepet.

Pika 10 OE duhet të ketë pjesë të stafit ekspert privat zjarrfikës të certifikuar për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri - Sqarojmë se sipas përcaktimeve të kryera në VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, i ndryshuar, për kodin e profesionit me nr.3112 **“Teknikë të inxhinierisë civile” parashikohet se:** Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një tërësi detyrash teknike që kontribuojnë në fushën kërkimore të inxhinierisë së ndërtimit dhe në projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e objekteve të dhe strukturave të tjera të tilla si, sisteme të ujësjellësit, ura, aeroporte rrugë dhe diga. Ata mund të punësohen në kompani private dhe shtetërore që sigurojnë ndërtimin, mirëmbajtjen dhe parandalime të rreziqeve nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë të rrezikshëm.

Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

-Marrin masa për sigurimin e përbushjes së të gjitha specifikimeve të projektit, të rregullave dhe ligjeve përkatëse, si dhe për ruajtjen e standardeve të kërkuara për materialet dhe punën e kryer;

-Inspektojnë ndërtime industriale, hotele, kinema dhe objekte të tjera për të identifikuar rreziqe të mundshme nga zjarri dhe japin udhëzime për eliminimin e tyre;

-Këshillojnë për instalimin e pajisjeve zbuluese të zjarrit dhe pajisjeve për fikjen e tij, për përdorimin e materialeve në ndërtimin e objektit dhe për mjetet e transportit që reduktojnë rrezikun nga zjarri dhe dëmet nëse ai ndodh;

Pra sa më sipër në kushtet kur është kërkuar inxhinier ndërtimi, është e panevojshme që të kërkohet disponimi i një punonjësi me certifikatë “ekspert zjarrfikës”.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: E.A, L.K dhe F.P.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr. 406 datë 18.12.2020 është ngritur KVO i cili përbëhet nga S.M, Kryetar, F.P dhe J.L, Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 05.01.2021 për hapjen e tenderit, ku kanë dorëzuar dokumentacion për pjesëmarrje 7 OE/BOE, përkatësisht:

BOE D dhe A Sh.P.K

OE A Sh.P.K

OE E/M Sh.P.K

OE F Sh.P.K

OE GJ&Co Sh.P.K

OE H.P Sh.P.K

OE I.D Sh.P.K

Procesverbali nr.s’ka, datë 14.01.2021 për vlerësimin e ofertave, ku janë s’kualifikuar:

OE/BOE	Arsye e s’kualifikimit
“A”	Nuk ka dorëzuar dokumentacion për stafin ndihmës, inxhinier ndërtimi/hidroteknik.
“E M”	Nuk disponon kategorinë e licencës 9e. Nuk ka paraqitur dokumente për aparatën GPS.
“F”	Nuk disponon kategorinë e licencës 3c, 3d dhe 6c. Nuk ka paraqitur dokumente për punë të ngjashme. Nuk ka dorëzuar dokumentacion për stafin ndihmës, inxhinier ndërtimi/hidroteknik dhe gjeodet.

-OE e tjerë kanë kaluar në fazën e dytë të procedurës.

-Me shkresat nr.257-257/3 prot., datë 22.01.2021 janë njoftuar OE/BOE, për dorëzimin e propozimit teknik dhe ekonomik më datë 08.02.2021, konkretisht:

BOE D dhe A Sh.P.K

OE GJ&Co Sh.P.K

OE H.P Sh.P.K

OE I.D Sh.P.K

-Më datë 08.02.2021 është mbajtur procesverbali nr., s'ka, nga KVO, ku rezulton se ftesës për propozim i është përgjigjur vetëm BOE D dhe A Sh.P.K me ofertën ekonomike 21,520,000 lekë pa TVSH.

-Më datë 12.02.2021 është mbajtur procesverbali nr., s'ka, nga KVO, ku është bërë vlerësimi i propozimit teknik dhe atij ekonomik të BOE D dhe A Sh.P.K.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk plotësohet kërkesa në pikën 6.1 të DST, shprehimisht: “Për stafin e mësipërm (inxhinierët), duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë (ku të figurojnë të punësuar me kohe të plotë) për periudhën e kërkuar Mars – Nëntor 2020”, pasi nga verifikimi i listë-pagesave rezultoi se përjashtuar inxhinierin V.T, përgjatë periudhës Mars-Tetor 2020, inxhinierët e tjerë të deklaruar që do të angazhohen në kontratën përkatëse si, M.A, H.L, E.C, A.GJ, B.C dhe K.J, nuk janë të punësuar me kohë të plotë pranë OE D, kjo vërtetuar nëpërmjet numrit të ditëve kalendarike të deklaruara në listë-pagesë, për inxhinierët e mësipërm.

-Nga OE D nuk është plotësuar saktë, pika në shtojcën 4/1 të DST. Ky OE në këtë procedurë ka marrë pjesë si BOE, nëpërmjet bashkëpunimit me OE A dhe në këtë rast OE D ka pasur detyrimin e plotësimit të saj, pasqyruar si më poshtë vijon:

6.Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, S.M, Kryetar, F.P, J.L, Anëtar.

9.Tenderi me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqëz, Vodëz, Kreckëz dhe Koritëz Njësia Administrative Perondi”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i procedurës		
1.Urdhër Prokurimi nr. 370 datë 27.11.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 371. Datë 27.11.2020	3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 371. Datë 27.11.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur – Punë Publike	1. L.K 2. E.A 3. D.B	1. S.M 2. F.P 3. J.L
5. Fondi Limit (pa TVSH) 361,206,231 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE S Sh.P.K me ofertën ekonomike në vlerën 354,143,215 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 7,063,016 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 05.01.2021	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP – KPP- Ka pasur ankes nga OE 4 shpk (ankimimi vetëm në AK)	12. Përgjigje Ankesës nga AK Kthim përgjigje Nr. prot 4237/2 09.12.2020	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.972, datë 17.03.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 422,451,858 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 296,319,725 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës 18 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar me procesverbalin nr. s'ka, datë 27.11.2020, i ndryshuar.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

Në pikën 4.2.3 (Specifikimet teknike) kërkohet që për tubat HDPE, OE duhet të paraqesë:

- Certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i tubave dhe pjesëve speciale;
- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (Borealis, Solvay, BP, Elenac GmbH ose ekuivalent) e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike të përshkruara më sipër;
- Certifikata e cilësisë ISO 9001/14001 ose ekuivalente;
- Certifikata e testimit të tubave dhe pjesëve speciale nga prodhuesi i tyre;
- Leja zyrtare për prodhimin e tubave dhe pjesëve speciale për prodhuesin;
- Manual teknik të tubave dhe të pjesëve speciale të prodhuesit të shoqëruar me manualin e operimit, instalimit të mirëmbajtjes si dhe të dhënat teknike të tyre. Manualin teknik të pajisjeve bashkuese të tyre të shoqëruar me të dhënat e mënyrës së bashkimit, procesit të ngjitjes, kontrollit dhe testimit gjatë procesit të instalimit.

Në pikën 4.4.2 (Specifikimet teknike) kërkohet që të gjitha valvolat që do të instalohen në objekt duhet të jenë të shoqëruar me dokumentacionin teknik përkatës të kërkuar nga standartet e mësipërme si:

Certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i tyre;

Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike të përshkruara më sipër;

Certifikata e cilësisë ISO 9001/14001 ose ekuivalente;

Certifikata e testimit nga prodhuesi i tyre;

Leja zyrtare për prodhimin e valvolave për prodhuesin e tyre;

Manual teknik të prodhuesit të shoqëruar me manualin e operimit, instalimit, të mirëmbajtjes si dhe të dhënat teknike të tyre.

-Sa më sipër konstatohet se janë vendosur kriterë për palë të treta, konkretisht për prodhuesin e tubove HDPE, valvolave, si dhe jo për OE që do të marrin pjesë në garë, në rastin kur OE që do të konkurrojë nuk është vetë prodhuesi. Gjithashtu vendosja e specifikimeve të mësipërme nënkupton që duhet me patjetër kontratë e lidhur me prodhuesin e tubove HDPE dhe valvolave, ndërkohë që OE mund të kenë kontratë edhe me distributorin e autorizuar për Ballkanin/Shqipërinë për furnizimin me këto materiale, por mund të jetë edhe shpërndarës i këtij produkti, hallka e fundit e zinxhirit të furnizimit të produktit në treg (Prodhues – Distributor i Autorizuar – Importues për Shqipërinë – Shpërndarës) . Për më tepër referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, këto janë dokumente që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuuesi teknik i kantierit, si dhe mbikëqyrësi. Detyrimin për vlerësimin e konformitetit të materialeve të ndërtimit e ka prodhuesi i tyre, i cili në përfundim të prodhimit të produktit, fikson markimin CE në trupin e produktit kur e lejon natyra e tij/harton deklaratën e konformitetit për produktin. Këtu sjellim në vëmendje edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.6732 prot., datë 21.10.2020, sa i përket përcaktimit të kërkesave për palët e treta.

Në pikën 2.3.5 kërkohet që OE duhet të dëshmojnë një punësim mesatar i të paktën 400 (katërqind) personave, për periudhën Janar 2020 – Tetor 2020 të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2020 – Tetor 2020.

b) Listë pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2020 – Tetor 2020.

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune – Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur Janar – Tetor 2020 (10 muaj) për disponimin e numrit mesatar të punonjësve, pra si ndikon kjo periudhë në përmbushjen e kapacitetit teknik dhe profesional të OE. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike. Për përcaktimin e numrit të punonjësve, nuk është bërë analiza teknike për çdo zë punimi, ku të përcaktohen ditët/javët/muajt e nevojshëm për realizimin e tij, volumin që realizohet në një ditë pune nga një puntor, për të përcaktuar më pas se duhet një numër i caktuar punonjësish për të realizuar këtë zë pune për një kohë të caktuar/ose të shtohet numri i punonjësve për ta realizuar më shpejt këtë zë pune. Veç sa më sipër nuk argumentohet kërkesa e NJP, se punonjësit duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune. Një OE mund të ketë një staf të përhershëm të tij, si dhe një pjesë të tyre mund ta kontraktoj, pëshëmbull manovratorët, ku OE mund të marrë me qira mjetet, njëkohësisht në kontratë përcakton edhe vendosjen në dispozicion të manovratorit. Pra OE disponon punonjësit për të realizuar kontratën, por nuk i ka të siguruar dhe në këto kushte nuk mund të marrë pjesë në procedurë. Gjithashtu nga NJP është përcaktuar lloji i profesionit për 56 punonjës (staf kryesor dhe mbështetës), ndërkohë që kërkohen 400 punonjës, ose 344 punonjës më tepër, për të cilët nuk përcaktohet formimi profesional i tyre, ç'ka e bën një kërkesë jo konkrete.

Në pikën 2.3.6 dhe 2.3.7 është kërkuar që OE duhet të kenë të punësuar si staf teknik (drejtues teknik) të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit, stafin inxhinierik (kryesor dhe mbështetës) si më poshtë:

2 Inxhinier Ndërtimi drejtues teknik (12 muaj në listë pagesë) + 1 inxhinier ndërtimi ndihmës (10 muaj në listë pagesë);

1 Inxhinier Gjeodet (12 muaj në listë pagesë);

1 Inxhinier Hidroteknik drejtues teknik (12 muaj në listë pagesë) + 1 inxhinier hidroteknik ndihmës (10 muaj në listë pagesë);

1 inxhinier Elektrik drejtues teknik (12 muaj në listë pagesë) + 1 inxhinier elektrik ndihmës (10 muaj në listë pagesë);

1 inxhinier Mekanik drejtues teknik (12 muaj në listë pagesë) + 1 inxhinier mekanik ndihmës (10 muaj në listë pagesë);

1 inxhinier Mjedisi drejtues teknik (12 muaj në listë pagesë), i pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”;

1 inxhinier Gjeolog (12 muaj në listë pagesë);

1 inxhinier Gjefizik (10 muaj në listë pagesë);

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, konstatohet se:

-Nuk argumentohet periudha (12 mujore) e vendosur për inxhinierët (drejtues teknik) dhe periudha 10 mujore për stafin mbështetës. Sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 3 vite/5 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3 ose 5 vite)²⁴. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 3 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 1 viti që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE

²⁴ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrjnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë. Vendosja e periudhës së mësipërme prej 1 viti tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, besueshmëri të OE, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike. Në këtë rast bazuar edhe në shkronjën “b” të pikës 8 në nenin 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar: “*Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*”, mjafton vetëm vendosja e numrit dhe llojit të inxhinierëve që duhen për zbatimin e punimeve.

-Nuk argumentohet kërkesa se përse duhen dy inxhinier ndërtimi drejtues teknik dhe jo vetëm 1 prej tyre të jetë drejtues teknik. Gjithashtu nuk argumentohet me analizë teknike kërkesa për 1 inxhinier ndërtimi staf mbështetës.

-Është kërkuar inxhinier mjedisi, ndërkohë nuk është kërkuar disponimi i licencës me kategorinë NP12, që të kërkohej edhe specialisti i fushës. Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë inxhinier mjedisi. Gjithashtu çdo projekt i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Zbatimi i masave të përcaktuara në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, është objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Berat, strukturë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Inxhinieri i mjedisit shërben gjatë fazës së projektimit, ku edhe përcakton masat që do të zbatohen për mbrojtjen e mjedisit, zbatimi i të cilave respektohet dhe monitorohet nga inxhinierët civil. Veç sa më sipër sjellim në vëmendje këtu rekomandimin e APP me shkresën nr.6732 prot., datë 21.10.2020. Për të ardhur tek argumenti i bërë nga NJP se OE pas përfundimit të punimeve ka detyrimin për rregullimin e ambjentit përreth kantierit, në këtë rast mund të ishte kërkuar specialist për mbrojtjen/rehabilitimin e mjedisit dhe jo domosdoshmërisht inxhinier mjedisi, për më tepër drejtues teknik²⁵.

-Është kërkuar inxhinier gjeofizik, ndërkohë është kërkuar edhe inxhinier gjeolog, të cilët praktikisht kryejnë të njëjtat detyra²⁶. Për më tepër që në preventiv nuk ka punime të natyrës që kërkojnë praninë e inxhinierit gjeofizik. Gjithashtu puna e inxhinierit gjeofizik është gjatë fazës së projektimit, pra studimit të terrenit dhe jo gjatë fazës së zbatimit të punimeve.

Në pikën 2.3.7 është kërkuar 1 ekspert mjedisi të pajisur me çertifikatë “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor” – Ndërkohë në preventiv nuk ka punime të cilat kërkojnë praninë e ekspertit të mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor. E ritheksojmë se çdo projekt i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij.

Në pikën 2.3.8 kërkohej që OE duhet të ketë të punësuar 1 punonjës që të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/çertifikatën përkatëse, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit - Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Në pikën 2.3.10 kërkohej që OE të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të paktën 24 (njëzetë e katër) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:

²⁵ VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, kodi i profesionit 2134/2143.04.

²⁶ VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, kodi i profesionit 2114.

Grupi I - 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë hekurkthyes dhe 2 murator;

Grupi II - 12 punonjës nga të cilët 4 saldatorë, 4 hidraulikë, 2 teknikë ndërtimi si dhe 2 mekanikë;

Grupi III - 3 punonjës elektrikistë;

Grupi IV - 3 punonjës elektrikist;

Grupi V - 1 punonjës elektrikist. Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik, kontratat e punës të vlefshme. Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguar me ditë të plota pune.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE, për më tepër me kohë të plotë.

-Për numrin e punonjësve nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, volumi për ditë pune për punonjës, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektracist (Hidraulik, Teknik ndërtimi, Hekurkthyes, Murator etj) të kërkohej dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike. Nëse do t'i referoheshim kriterëve që duhet të plotësojë një punonjës për të marrë dëshmi të sigurimit teknik sipas grupeve të mësipërme, do të kuptohet qartë se punonjësit si hidraulik, hidraulikë, teknikë ndërtimi, mekanikë etj., nuk e kanë të nevojshme disponimin e një dëshmie të tillë, konkretisht për grupin II, duhet:

-Të kenë jo më pak se një vit pune në profilin përkatës të përcaktuar në Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike – Pra përse hidrauliku duhet të ketë një vit pune në fushën elektrike, ndërkohë që puna e tij në kantier nuk lidhet me punime të fushës elektrike.

-Të kenë kryer edukim profesional teknik (elektrik). Në mungesë të këtij edukimi, kërkohej të ketë mbaruar shkollën 8/9 vjeçar dhe një trajnim të paktën 8 orë në lidhje me ndihmën e parë dhe njohuritë mbi rrezikun që vjen nga rryma elektrike – Pra përse hidrauliku duhet të ketë kryer edukim profesional elektrik, ndërkohë ushtron profesionin si hidraulik.

-**Në pikën 2.3.15** kërkohej që OE duhet të jenë të pajisur:

1. Licensë kodi III.2.B “Grumbullim dhe transporti i mbetjeve urbane”.

2. Licensë kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte dhe dherave”.

3. Licensë kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura”.

Sipas paketës fiskale të vitit 2020 (periudhë kur janë vendosur kriteret) Bashkia Kuçovë për subjektet me aktivitet ndërtimi, aplikon tarifën e shërbimit të pastrimit, ndotjes, pra në kushtet kur bashkia e siguron shërbimin e pastrimit si dhe e tarifon subjektin për kohëzgjatjen e kantierit, është e panevojshme vendosja e kërkesës për disponimin e licencës së mësipërme. Sa i përket transportit të dheut nuk është e nevojshme pajisja me licencën e mësipërme, pasi në këtë rast dheu është material ndërtimi dhe do t'i nënshtrohet transformimit fizik. Për transportin e dheut si mall, shërben certifikata e transportit të mallrave që lëshohet për mjetin përkatës. Gjithashtu nga NJP nuk është specifikuar konkretisht se çfarë mbetjesh urbane do të gjenerohen nga aktiviteti i OE, për të përlegjur kërkesën për disponimin e licencës me titull “Grumbullim dhe Transporti i Mbetjeve Urbane”. I njëjti argument vlenë edhe për licencën me titull “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura”. Për më tepër që grumbullimi dhe transporti i mbetjeve nga ujërat e ndotura ofrohet nga Sh.A.UK Berat-Kuçovë²⁷.

Në pikën 2.3.15 kërkohej që OE duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

²⁷ <https://www.shuk.al/berat/shoqeria-uk>

Mjetet me goma	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12 (dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17 (shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	6 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç 35-45 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçin (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (një pik pesë) ton dhe maksimumi 2 (dy) ton për secilin kamionçinë	4 copë	Pronësi ose me qera
Autobot për pastrim kanali dhe Puseta (vëllimi i botit mbi 20,000 lit.,)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me vinc me peshë ngritje deri në 1,5 ton.	1 copë	Pronësi ose me qera
Minidamper me goma (kapaciteti mbajtës minimum 3 (tre) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	4 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	3 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë stacionare betoni me kapacitet mbi 50 m3 në orë dhe presion mbi 55 bar	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per ngjitje tubash me elektrofuzion	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per ngjitje tubash me saldime	2 copë	Pronësi ose me qera
Rula vibrues	2 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Impiant per trajtimin e ujrave te ndotura	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Asfaltbetoni e paisur me leje mjedisore kodi III.1.B	1 copë	Pronësi, me qera ose me kontratë furnizimi.
Fabrike Prodhimi Betoni e paisur me leje mjedisore kodi III.1.B	1 copë	Pronësi, me qera ose me kontratë furnizimi

Impianti i prodhimit (fabrikës) të betonit dhe asfaltbetonit nuk duhet të jetë më shumë se 50 km në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti (në rast se është platformë e palëvizshme) me qëllim verifikimi i saktë nga ana e KVO-së.

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk argumentohet numri i mjeteve dhe makinerive, por është bërë vetëm argumentimi i domosdoshmërisë (*pra nevojitet kamioni vetëshkarkues pasi kemi materiale ndërtimi për t'u transportuar, apo eskavator pasi kemi punime gërmimi*) së llojit të mjeteve në përputhje me zërat e preventivit. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të mjeteve të nevojshëm për zbatimin e projektit. Pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë teknike, cilat do të jenë materialet që do të transportohen me kamionin vetëshkarkues, sa është pesha totale e materialeve, sa peshë mund të transportojë kamioni në një rrugë, sa rrugë në ditë mund të bëjë, dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa peshë mund të transportojë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 3168 orë pune gjithësej (18 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të kamionave.

-Nuk argumentohet teknikisht kërkesa për sondë shpimi në përputhje me llojin e punimeve, si dhe numri i kërkuar për sondë shpimi, në përputhje me volumin dhe grafikun e punimeve.

-Nuk argumentohet teknikisht kërkesa për pompë stacionare betoni dhe parametrat teknik të saj të kërkuar, në përputhje me natyrën, volumin dhe grafikun e punimeve, si dhe zonat në të cilat mjetet/autopompa e betonit nuk arrin të kryejë funksionin për shkak të terrenit/largësisë.

-Në vijim janë kërkuar eskavator me zinxhir, minieskavator, rul vibrues, grejder, ndërkohë nuk kërkohet rimorkiatori për transportin e tyre, pasi përfshihen në kategorinë e mjeteve të cilat nuk mund të qarkullojnë në rrugë.

-Është kërkuar që OE të ketë në pronësi, me qera/kontratë furnizimi fabrik prodhim betoni dhe fabrikë asfalto-betoni e pajisur me leje mjedisore, jo më larg se 50 km nga objekti – Vendosja e kriterit për distancën, është e paargumentuar teknikisht. Konkretisht koha e transportit të betonit, lidhet me temperaturën e transportit të tij, ku në temperaturë 5-10°

transporti i betonit mund të zgjasë edhe 2 orë, kohë në të cilën mjete i transportit mund të bëjë deri në 100 km, ç'ka do të thotë se rritet mundësia për subjekte të cilat kanë impiant/me qira/kontratë furnizimi, që ndodhen në distancë edhe më tepër se 50 km. Sa i përket distancës së fabrikës së prodhimit të asfaltit, nuk ka arsye të vendoset, pasi mjetet që transportojnë asfaltin kanë kushtet termike të nevojshme për ruajtjen vlerave të asfaltit, duke e mbajtur atë në temperaturën e nevojshme rreth 150°, zakonisht deri 3 orë udhëtim, kohë e cila është e mjaftueshme edhe për distanca deri në 100 km²⁸.

Gjithashtu përcaktohet si detyrim që edhe kur impianti i prodhimit të betonit dhe asfaltobetonit, merret me qera/lidhet kontratë furnizimi duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore, *praktikisht përcaktohet kriter për palë të treta dhe jo për ofertuesit, pra kërkohen dokumente që përmbushin detyrime ligjore të subjekteve të tjera dhe jo të ofertuesit, i cili mund të ketë thjeshtë kontratë furnizimi me prodhuesin e betonit.*

-Janë kërkuar 2 impiante për trajtimin e ujërave të ndotura, ndërkohë që procesverbalin e argumentimit të kriterëve, është arsyetuar se duhen për të garantuar AK për synimin e tij për ujë të shëndetshëm dhe të pijshëm – Kjo kërkesë nuk ka aspak lidhje me objektin e kontratës, natyrën e punimeve që do të kryhen. OE do të përfundojë ndërtimin e veprës, testojë funksionimin e saj, kryejë analizat e cilësisë së ujit dhe përfundon detyrimin e tij ndaj AK. Pra nuk ka detyrim që të kujdeset që uji të jetë i pijshëm dhe i shëndetshëm. E ritheksojmë se ofrimi i ujit të shëndetshëm dhe të pijshëm është detyrë e institucionit të Sh.A.UK Berat-Kuçovë²⁹, në varësi të organit të pushtetit vendor, pasqyruar edhe në objektin e veprimtarisë në ekstraktin e regjistrimit në QKB, si më poshtë vijon:

“Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve; Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimin të ujërave të ndotura; Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre”.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: E.A, L.K dhe D.B.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër nr. 371 datë 27.11.2020, dhe përbëhet nga z. S.M (kryetar), F.P dhe J.L (anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 08.09.2021 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 20.09.2021 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE përkatësisht:

OE “B” Sh.P.K me ofertë ekonomike 358,658,979 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **2,547,252 lekë më pak;**

OE “E K” Sh.P.K me ofertë ekonomike 359,403,182 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **1,803,048 lekë më pak;**

OE “S” shpk me ofertë ekonomike 354,143,215 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **7,063,016 lekë më pak.**

Nga OE të mësipërm, janë s'kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
“B”	Nuk ka punësim mesatar i të paktën 400 (katërqind) punonjësish, ka paraqitur dokumentacion për 150 (njëqind e pesëdhjetë) punonjës . Nuk ka paraqitur dokumenta për stafin ndihmës për inxhinierët e kërkuar (hidroteknik, elektrik dhe gjeofizik) Nuk ka paraqitur dokumenta për punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për (Grupi I, 1 hekurthyes dhe 1 murator), (Grupi II, 1 saldator), (Grupi III dhe IV nga dy elektricista). Nuk ka paraqitur licensë kodi III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane, mbetjeve inerte dhe dherave, mbetjeve nga ujrart e ndotura. Nuk ka paraqitur dokumenta për një pjesë të mjeteve me goma dhe pajisjeve të tjera. Dokumentat e paraqitura për fabrikën e asfalto betonit janë në distancë mbi 50 km në kundërshtim me kriterin e vendosur në DST .
“EC”	Nuk ka punësim mesatar i të paktën 400 (katërqind) punonjësish, ka paraqitur dokumentacion për 114 (njëqind e katërmëdhjetë) punonjës. Nuk ka paraqitur dokumenta për stafin ndihmës për inxhinierët e kërkuar (hidroteknik, mekanik, elektrik dhe gjeofizik).

²⁸ <https://iopscience.iop.org/article/10.1088/1757-899X/523/1/012083/pdf>

²⁹ <https://www.shuk.al/berat/shoqeria-uk>

Nuk ka paraqitur dokumenta për punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për të gjitha grupet . Nuk ka paraqitur liçensë kodë III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane, mbetjeve inerte dhe dherave, mbetjeve nga ujrat e ndotura. Nuk ka paraqitur dokumenta për një pjesë të mjeteve me goma dhe pajisjeve të tjera.

Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE S Sh.P.K, me ofertë ekonomike 354,143,215 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 7,063,016 lekë më pak.
-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

-Nuk është përmbushur pika 2.3.6, sa i përket dorëzimit të listë-pagesave për 12 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, pasi OE shpallur fitues i ka dorëzuar për 10 muajt e fundit.

-Nuk është përmbushur pika 2.3.7, sa i përket kërkesës për 1 inxhinier hidroteknik i cili duhet të jetë i siguruar me ditë të plota pune. OE shpallur fitues ka dorëzuar dokumentacion për F.G dhe I.H, ndërkohë I.H për muajin Qershor nuk figuron e siguruar me ditë të plota pune.

-Nuk është përmbushur pika 2.3.7, sa i përket dorëzimit të dokumentacionit për 1 ekspert mjedisi me certifikatë “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”, pasi për punonjës D.A nuk është dorëzuar librezë pune, si dhe nuk figuron i siguruar me ditë të plota pune për periudhën Maj-Shtator 2020.

10.Tenderi me objekt: “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Kuçovë, për vitin 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Kuçovë për vitin 2022”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 50, nr. 712 prot., Datë 01.03.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 49 dt. 01.03.2022 1.L.K (Juriste) 2.E.A (Jurist) 3.A.V (Jurist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 49 dt. 01.03.2022 -S.M, Kryetar. -S.V, Anëtar. -J.L, Anëtar.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur - Mallra	5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,303,332 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “R” sh.p.k, 12,303,332 lekë me marzh fitimi 4.96 %.
8. Data e hapjes së tenderit 07.04.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Granti i qeverisjes qendrore	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 lekë.
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1412/1 prot., datë 29.04.2022 Nr. 1412/2 prot., datë 29.04.2022 Nr. 1412/3 prot., datë 29.04.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 14,763,998 lekë	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 24 muaj, Zbatuar 9 muaj	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
		19. Zgjatja e kontratës me - ditë S’ka

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve nga NJP.

Pika 2.3.1 - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet – ndërkohë që sipas pikës 4 në nenin 40 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për mallra vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet;

-Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. - Ky kriter bazohet në nenin 36 dhe nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

-Në kriteret për aftësitë teknike nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i cili duhet të jetë i pajisur me raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. - Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/c, të nenit 40, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në kriteret për kapacitetet teknik nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokoll-matjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës³⁰ me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.

-Sa më sipër kriteret e kualifikimit janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2, 3, 4, shkronja “c” në pikën 6 në nenin 40, nenin 44, dhe pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, L.K, E.A dhe A.V.

Vlerësimi i ofertave

-KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Urdhër Nr. 49 datë 01.03.2022 dhe përbëhet nga z. S.M, Kryetar, z. S.V dhe z. J.L, Anëtar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është dhe shpallur fituese OE “R” SHPK me marzh fitimi 4.96 %.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 80 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Është shpallur fitues OE “R” shpk me marzh fitimi 4.96 %. Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, kualifikimi dhe shpallja fitues i OE “R” Sh.P.K qëndron.

11.Tenderi me objekt: Rikonstruksion i Rrugës “Donald Hoxha”, Kuçovë me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 269, datë 05.10.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 268, datë 05.10.2022. 1. L.K (Juriste) 2. E.A (Jurist) 3. F.P (Inxhinier ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr.268 , datë 05.10.2022 1. S.M, Kryetar (Ekonomist) 2. S.V, Anëtar (Inxhinier ndërtim) 3. J.L, Anëtar (Inspektor IMTV)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Hapur e Thjeshtuar - Punë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 5,561,154 lekë	6. Oferta fituese: A shpk Vlera 4,581,980 lekë pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 979,174 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 14.11.2022	9.Burimi Financimit: “Të ardhurat e Bashkisë”	10. Operoret Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime për kriteret e DST JO	12. Përgjigje ankesës nga AK JO	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 3778 prot., datë 09.12.2022	15. Vlera kontratës (me TVSH) 5,498,376 lekë	16. Afati i kontratës në ditë 60 ditë

³⁰ Neni 19 dhe 20 në Ligjin nr. 126/2020 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë hartuar dhe miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit.

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë s'ka.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

Në pikën 2.3.3 është kërkuar që OE duhet të kenë të punësuar si staf teknik (drejtues teknik) të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e njoftimit të kontratës, stafin inxhinierik, si më poshtë:

1. Inxhinier Ndërtimi

Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, konstatohet se:

-Nuk argumentohet periudha (3 mujore) e vendosur për inxhinierin (drejtues teknik). Sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 3 vite/5 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3 ose 5 vite)³¹. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, etj, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muaj që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, besueshmëri të OE, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

-Pika 2.3.4. Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e njoftimit të kontratës si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Punonjës
1	Teknik Mekanik	1 (një)
2	Hekurkthyes	1 (një)
3	Hidraulik	1 (një)
4	Elektriçist	1 (një)
	Totali 4 (katër) punonjës	

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur, që punonjësit duhet të figurojnë 3 muaj në listë-pagesë.

-Pika 2.3.5. është kërkuar 1 manovrator, ndërkohë janë kërkuar 5 mjete punimi, si fadromë me goma, kamion me vinç, rul, asfaltoshtruese, autobitumatriçe. Pra nëse dy mjete ndërtimi punojnë në të njëjtën kohë nuk sigurohet manovrimi i tyre.

-Pika 2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 15 persona për një periudhën 3 (tre) mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës – Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 8 punonjës (1 inxhinier dhe 7 staf teknik), pra ngelen edhe 7 punonjës për të cilët nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Pika 2.3.7. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë: 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/ose certifikatë trajnimi si “*Kursi bazë për ndihmën e parë, ose Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*” të lëshuara nga shoqëri të akredituara ose nga organizmat

³¹ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, – Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: L.K, E.A dhe F.P.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër Nr. 268 datë 05.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. S.M, (Kryetar), z. J.L dhe z. S.V (Anëtar).

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE përkatësisht:

OE “A” Shpk, me ofertën ekonomike në shumën 4,581,980 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 979,174 lekë.

OE “L” Shpk, me ofertën ekonomike në shumën 4,704,980 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 856,174 lekë.

OE “S” Shpk me ofertën ekonomike në shumën 4,883,074 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 678,080 lekë.

Janë kualifikuar të 3 OE “A” Sh.P.K, OE “L” Sh.P.K dhe OE “S” Sh.P.K.

-Është shpallur fitues OE “A” Sh.P.K me ofertën ekonomike më të ulët në krahasim me dy OE.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me paragrafin 3 të pikës 4 në nenin 80, nenin 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

Nuk përmbushet pika 2.3.1 – Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

-Nuk është plotësuar pika **2.3.6 e DST**, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 15** persona për periudhën 3 (tre) mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre mujorin duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit – OE në formularin “shtojca 8” ka deklaruar **8** punonjës.

Nr	Emërtimi	Punonjës	Sipas vetëdeklaratës
1	Inxhinier Ndërtimi	1	Z.Inid Murati
2	Teknik Mekanik	1	Z.Niko Alliu
3	Hekurkthyes	1	Z.Nazif Kapaj
4	Hidraulik	1	Z.Gegë Pjetra
5	Elektriçist	1	Z.Vleran Maksutaj
6	Manovrator	1	Z.Eridjan Osmenaj
7	Shofer	1	Z.Illir Kanella
8	Shofer	1	Z.Luan Memetaj
	Total	8	8

-Nuk është plotësuar pika **2.3.9 e DST**, OE pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe paisjet teknike si më poshtë;

-Autobitumatricja e marrë me qira nuk ka certifikatën e miratimit ADR për konformitetin e tij e lëshuar nga një organ inspektues i autorizuar ministri që mbulon sektorin e transportit,

ndërkohë që është detyrim ligjor për mbushësin e mallrave të rrezikshme (bitum) për kontrollin e afatit të inspektimit me qëllim që ai mos të ketë kaluar³²;

-Nuk administrohet certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatrices³³;

-Për drejtimin e autobitumatrices nga OE nuk është dorëzuar dokumentacioni përkatës. Në kontratën e qirasë së këtij mjeti rezulton se qiradhënësi do të vendosi në dispozicion të qiramarrësit drejtues të mjetit përkatës. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit për 3 drejtues mjetesh konstatohet se asnjë prej tyre nuk ka dëshmi të aftësisimit profesional me titullin auto makinist, dëshmi e cila lëshohet për drejtimin e autobitumatrices. Veç sa më sipër për asnjërin nga 3 drejtuesit nuk është lëshuar certifikata e kualifikimit për drejtimin e autobitumatrices.

-Për kamionçinën deri në 3.5 ton e marrë me qira nga OE shpallur fitues, nuk administrohet certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z.S.M, Kryetar, z.S.V dhe z.J.L, Anëtar.

Kriteri: Pikën 3 të nenit 3, shkronjën “a” të pikës 3 në nenin 36, pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 79, nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;

Pikat 1, 2 dhe 5 në nenin 23, shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 24, pikën 3 të nenit 46 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

Pikën 2 dhe pikën 4, shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 6 të nenit 39, pikën 2 të nenit 40, pikën 2 të nenit 41, pikat 1 dhe 2 të nenit 44, pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Pikat 3 dhe 5 në nenin 26, paragrafin e dytë në pikën 2 të nenit 61 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Uljen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Titulli i Gjetjes: Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).

Situata: Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 3 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;

- Në 7 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit;

- Në 1 rast nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit;

- Në 1 rast nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim i punimeve të objektit të prokuruar;

- Në 1 rast autoriteti kontraktor ka kërkuar vlerat e treguesve të analizuar, por nuk ka kërkuar që operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë raport analizë nga Inspektoriati Shtetëror

³² Pika 1 në nenin 48 në Ligjin nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

³³ Neni 35 dhe 38 në Ligjin nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor;

- Në 7 raste nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore, ky kriter garanton AK që OE ofertues në një procedurë prokurimi publik nuk është i dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1 të nenit 76 të LPP-së;

- Në 7 raste nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar deklaratë mbi konfliktin e interesit, ky kriter garanton autoritetin kontraktor që OE ofertues nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit mbështetur në nenin 27 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021;

- Në 3 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, nuk administrohet asnjë dokument që të vërtetojë specifikimet e kërkuara nga AK;

- Në 5 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;

- Në 5 raste rezulton se dokumentacioni i dorëzuar nga OE nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

- Në 3 raste rezulton se afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk janë përlllogaritur penalitet;

- Në 1 rast nuk dokumentohet procesverbali për tërheqjen e OE shpallur fitues dhe për kalimin tek OE i radhës;

Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, me përbërje si vijon: L.K, E.A dhe A.E;

Kriteri:

Pika 1 në nenin 16, nenin 19, pikën 1 në nenin 27, nenin 31, pika 3 paragrafi 1 në nenin 40, pika 3 në nenin 57, nenin 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; Pikën 5 dhe 16 në Udhëzimin nr. 3 datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, si dhe nenin 32 në ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar.

Shkronjat "dh", "e" dhe "ë" të pikës 2 në nenin 26, pikën 1 të nenit 27, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74, nenin 76, nenin 77 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;

Pikën 7, 8 dhe 17 në udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"; Pika 5 dhe pika 6 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 "Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës".

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Më hollësisht rastet trajtuar si më posht vijon:

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje Gazoil dhe Vaj".

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.6, me nr.166 prot., datë 18.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, E.A dhe A.E;

-Urdhri nr. 82, me nr. 170 prot., datë 26.04.2021, i prokurimit për Blerje Gazoil dhe Vaj për nevojat e M.Z.SH në Bashkinë Kuçovë.

-Fondi limit nuk është përcaktuar;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1470/1 prot., datë 26.04.2021, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i rënditur në vendin e parë të dorëzohet dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas urdhër blerje me nr. 1, datë 18.05.2021, në vlerën e 528,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, E.A dhe A.E;

-Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 06.05.2021 ka s'kualifikuar OE "P" i cili ka ofertuar me vlerën mbi fondin limit;

-OE "D" i rënditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 399,000 lekë pa tvsh, është njoftuar në datë 06.05.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 07.05.2021 OE "D" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "D" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

-Procesverbal i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 07.05.2021 konstatoi se dy ofertues kanë ofertuar me të njëjtën vlerë dhe konkretisht OE "M" me vlerë 440,000 dhe OE "Q" me vlerë 440,000. Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël vendosi që të hidhet shorti më datë 10.05.2021, dhe pasi u hodh shorti nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se, operatori ekonomik shpallur fitues është "Q. O." me vlerën 440,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 10.05.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kuçovë përfaqësuar nga Kryetari K.H dhe Operatorit Ekonomik "Q" Shpk është lidhur kontratë për mallra me nr. 1648 prot., datë 14.05.2021 për "Blerje Gazoil dhe Vaj për M.Z.SH, Bashkia Kuçovë" sipas ftesës për ofertë të paraqitur nga Bashkia Kuçovë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Afati i realizimit të lëvrimit të mallrave është nga dita e lidhjes së kësaj kontrate deri më 31.12.2021.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-AK ka kërkuar vlerat e treguesve të analizuar, por nuk ka kërkuar që operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë raport analizë nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor;

-Nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokoll-matjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës³⁴ me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet asnjë dokument që të vërtetojë të gjitha specifikimet e vendosura nga AK si më poshtë;

-Nuk administrohet akt teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi e lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

-Nuk administrohet deklaratë ku OE të marrë përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

-Nuk administrohet deklaratë nga OE shpallur fitues ku të disponojë minimumi një pikë karburanti brenda territorit të Bashkisë Kuçovë në një distancë jo më larg se 5 km nga Bashkia Kuçovë, në përmbushje të nevojave të vazhdueshme dhe në mënyrë të leverdisshme për Autoritetin Kontraktor.

³⁴ Neni 19 dhe 20 në Ligjin nr. 126/2020 "Për Metrologjinë", i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë hartuar dhe miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit.

-Nuk administrohet deklaratë për shërbimin e furnizimit me karburant për mjetet e transportit e cila do të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

-OE shpallur fitues nuk ka dorëzuar dokumentacionin brenda 1 dite pune pranë AK si dhe brenda 2 ditë për të lidhur kontratën me AK e cila është mbajtur jashtë afatit të vendosur në ftesën për ofertë;

-Nuk administrohet formulari i ofertës;

-Nuk administrohet ekstrakti bankar i cili të përmbajë të dhënat në lidhje me nr. e llogarisë dhe IBAN-in.

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhet të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, E.A dhe A.E;

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksioni i kanalit ujitës, (Dega e majtë e rezervuarit Goraj), Njësia Administrative Perondi Kuçovë”.

Përshkrimi i veprimeve:

-Urdhri nr. 281, me nr. 3911 prot., datë 23.11.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, A.V dhe E.A;

-Urdhri nr. 303, datë 13.12.2021, i prokurimit për rikonstruksionin e kanalit ujitës (dega e majtë e rezervuarit Goraj), njësia Administrative Perondi Kuçovë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 245,494 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 31, me nr. 352 prot., datë 03.02.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve, me përbërje si vijon: G.B, A.K dhe E.L;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 1/2022, datë 18.01.2022, në vlerën e 238,800 lekë me TVSH;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 4123/1 prot., datë 13.12.2021, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i rënditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, A.V dhe E.A, ku është s'kualifikuar OE “B” për arsye se vlera e ofruar prej tij është më e lartë se vlera e fondit limit konkretisht në vlerën 500,000 lekë pa TVSh si dhe kanë shpallur fitues OE “R” me ofertën e vetme, në vlerën 199,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 46,494 lekë pa TVSh.

-OE Fitues është njoftuar në datë 20.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kuçovë përfaqësuar nga Kryetari K.H dhe Operatorit Ekonomik “R” Shpk është lidhur Kontratë Punimesh me nr. 4254 prot., datë 22.12.2021 për “rikonstruksionin e kanalit ujitës (dega e majtë e rezervuarit Goraj), njësia Administrative Perondi Kuçovë” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kuçovë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Afati i kontratës do të jetë 14 ditë, duke filluar nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e punimeve të hartuar nga inxhinieri DB, është bazuar në VKM nr. 629 datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim i punimeve të objektit të prokuruar;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "R" i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
 -Nuk administrohet vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSHEE.
 -Nuk administrohet vetëdeklarimi për disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.
 -Afati i nënshkrimit të kontratës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi nënshkrimi i kontratës dhe dorëzimi i dokumentacionit është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 20.12.2021, pra nënshkrimi i kontratës duhej të realizohej brenda datës 21.12.2021, ndërkohë është nënshkruar më datë 22.12.2021, pra 1 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për realizimin e nënshkrimit të kontratës dhe dorëzimit të dokumentacionit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.
Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, A.V dhe E.A, si dhe inxhinieri DB;

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale për funksionimin e paisjeve të zyrave (Tонера)".

Përshkrimi i veprimeve:

-Urdhri nr. 06, me nr. 166 prot., datë 18.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, E.A dhe A.E;
 -Urdhri nr. 85, me nr. 1480 prot., datë 27.04.2021, i prokurimit për blerjen e materialeve për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tonera).
 -Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 501,500 lekë pa TVSH, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (A,M, E.I dhe E.I);
 -Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1480/1 prot., datë 07.04.2021, me specifikimet bashkëlidhur si dhe OE i renditur në vendin e parë përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoj dokumentacionin pranë AK;
 -Urdhri nr. 7, nr. prot., s'ka datë 18.01.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje si vijon: A.B, G.D dhe P.K;
 -Procesverbali nr. s'ka, datë 06.05.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;
 -Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 21/2021, datë 06.05.2021, në vlerën e 389,999 lekë me TVSH;
 -Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, E.A dhe A.E;
 -Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 28.04.2021 ka s'kualifikuar 5 OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit, konkretisht; OE "A. P." në vlerën 544,000 lekë pa TVSH, "EO" me vlerën 745,000 lekë pa TVSH, "G-I. 21" me vlerën 555,000 pa TVSH, "M" me vlerën 720,000 lekë pa TVSH dhe "S.Rr." me vlerën 535,800 lekë pa TVSH.
 -OE "J. B." i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 258,666 lekë pa TVSH, është njoftuar në datë 29.04.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 -Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 29.04.2021 OE "J.B" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "J.B" ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;
 -AK ka vazhduar me OE "B.I" i renditur i dyti me ofertën 341,000 lekë pa TVSH.
 -OE Fitues është njoftuar në datë 29.04.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 -Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 29.04.2021 OE "B.I" nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje në SPE.
 -AK ka vazhduar me OE "B.T" i renditur i treti me ofertën 347,500 lekë pa TVSH.
 -OE Fitues është njoftuar në datë 30.04.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE "BT" nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje në SPE;
- AK ka vazhduar me OE "R 2000" i renditur në vendin e katërt me ofertën 389,000 lekë pa TVSH.
- OE Fitues është njoftuar në datë 04.05.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.05.2021 OE "R 2000" ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;
- AK ka vazhduar me OE "MSH" i renditur në vendin e pestë me ofertën 390,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 111,500 lekë pa TVSh.
- OE Fitues është njoftuar në datë 06.05.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;
- Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;
- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Nuk është kërkuar deklaratë garancie për mallrat objekt prokurimi;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

- OE "MSH" i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
- Nuk administrohet asnjë dokument që të vërtetojë të gjitha specifikimet e vendosura nga AK si më poshtë;
- Nuk administrohet formulari i ofertës ekonomike;
- Nuk administrohet ekstrakti bankar i cili të përmbajë të dhënat në lidhje me nr. e llogarisë dhe IBAN-in.
- Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, E.A dhe A.E;

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje paisje zyre administrate".

Përshkrimi i veprimeve:

- Urdhri nr. 6, me nr. 166 prot., datë 18.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, A.E dhe E.A;
- Urdhri nr. 251, me nr. 3430 prot., datë 12.10.2021, i prokurimit për blerje paisje zyre administrate;
- Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 511,000 lekë pa TVSH, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (ED, MSH dhe AV);
- Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 3430/1 prot., datë 12.10.2021, me specifikimet bashkëlidhur si dhe OE i renditur në vendin e parë përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzojë dokumentacionin pranë AK;
- Procesverbali nr. s'ka, datë 25.10.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 27/2021, datë 25.10.2021, në vlerën e 500,000 lekë me TVSH;
- Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, E.A dhe A.E;
- Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 13.10.2021 ka s'kualifikuar 3 OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit, konkretisht; OE "MC" me ofertën me vlerë 220,000 lekë pa TVSH, "OH" me ofertën me vlerë 478,800 lekë pa TVSH dhe "D" me ofertën me vlerë 71,300 lekë pa TVSH.
- Konstatohet se arsyetimi i komisionit të vlerësimit të ofertave me vlerë të vogël nuk qëndron pasi 3 OE kanë ofertuar me vlerë jo më të lartë se fondi limit.
- Janë s'kualifikuar 2 operatorë ekonomik konkretisht OE "JG" me ofertë me vlerë 30,000 lekë pa TVSH, OE "OT" me ofertë me vlerë 25,000 lekë pa TVSH si dhe janë s'kualifikuar 2

- operatorë ekonomik të cilët kanë ofertuar me vlerën më të vogël se 50% e vlerës së fondit limit konkretisht OE “T” me ofertë me vlerë 16,447 lekë dhe OE “M & D” me ofertë me vlerë 15,732 lekë pa TVSH.
- OE “MM” i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 330,000 lekë pa TVSH, është njoftuar në datë 13.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 14.10.2021 OE “MM” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “MM” ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës fizike; por që nuk administrohet në dosjen fizike;
 - AK ka vazhduar me OE “S” i renditur i dyti me ofertën 430,000 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 14.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 15.10.2021 OE “S” ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye shëndetësore, por që nuk administrohet në dosjen fizike;
 - AK ka vazhduar me OE “OH” i renditur i treti me ofertën 450,000 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 15.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE “OH”, është s’kualifikuar me pa të drejtë nga komisioni i vlerësimit të ofertave me vlerë të vogël duke mos argumentuar shkaqet kryesore të s’kualifikimit;
 - AK ka vazhduar me OE “A” i renditur në vendin e katërt me ofertën 458,000 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 18.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE “A” ka deklaruar se tërhiqet nga gara; kërkesa e tërheqjes nuk administrohet në dosjen fizike;
 - AK ka vazhduar me OE “KF” i renditur në vendin e pestë me ofertën 480,000 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 19.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE “KF”, është s’kualifikuar me pa të drejtë nga komisioni i vlerësimit të ofertave me vlerë të vogël duke mos argumentuar shkaqet kryesore të s’kualifikimit si dhe nuk është dokumentuar kalimi tek operatori ekonomik i rradhës;
 - AK ka vazhduar me OE “R 2000” i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 488,000 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 20.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE “R 2000”, është s’kualifikuar me pa të drejtë nga komisioni i vlerësimit të ofertave me vlerë të vogël duke mos argumentuar shkaqet kryesore të s’kualifikimit si dhe nuk është dokumentuar kalimi tek operatori ekonomik i rradhës;
 - AK ka vazhduar me OE “D” i renditur në vendin e shtatë me ofertën 495,900 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 21.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.10.2021 OE “D” ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye të angazhimeve në procedura të tjera;
 - AK ka vazhduar me OE “EI” i renditur në vendin e shtatë me ofertën 499,900 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 22.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
 - Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.10.2021 OE “EI” nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje, për këtë arsye komisioni ka vendosur ta s’kualifikojë OE “EI”;
 - AK ka vazhduar me OE “MSH” i renditur në vendin e nëntë me ofertën 500,000 lekë pa TVSH. Diferenca nga fondi limit është në vlerën 11,000 lekë pa TVSH.
 - OE Fitues është njoftuar në datë 25.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:**
- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;
 - Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim;
 - Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-OE shpallur fitues ka dorëzuar vetëm ofertën ekonomike;

-Nuk administrohet dhe dokumentohet se OE shpallur fitues është paraqitur pranë AK për realizimin e procedurës dhe për dorëzimin e mallit bashkë me dokumentat brenda 1 dite punë ose 24 orë nga momenti i publikimit në sistemin e prokurimit elektronik të njoftimit të fituesit;

-Nuk administrohet ekstrakti bankar i cili duhet të përmbajë të dhënat në lidhje me nr. e llogarisë dhe IBAN-in;

-Nuk administrohet garancia me afat 3-vjeçar për të gjitha paisjet të cilat janë objekt prokurimi;

-Nuk dokumentohet që paisjet objekt prokurimi janë të reja, të pa përdorura dhe viti i prodhimit të tyre janë 2020-2021 sipas ftesës për ofertë;

-Nuk dokumentohet nëse OE ofertues ka në objektin e ushtrimit të aktivitetit, objektin e prokurimit;

-Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK sipas ftesës për ofertë komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe anulimin e procedurës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, A.E dhe E.A;

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje pjesë këmbimi goma dhe bateri”, (Furnizim-Vendosje).

Përshkrimi i veprimeve:

-Urdhri nr. 19, me nr. 232 prot., datë 24.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, E.A dhe A.V;

-Urdhri nr. 41, me nr. 528 prot., datë 16.02.2022, i prokurimit për blerje pjesë këmbimi, goma dhe bateri (Furnizim dhe Vendosje).

-Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 757,500 lekë pa TVSH, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (AK, AM dhe K sha);

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 528/1 prot., datë 16.02.2022, me specifikimet bashkëlidhur si dhe OE i renditur në vendin e parë përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoj dokumentacionin pranë AK;

-Urdhri nr. 21 me nr. 234 prot., datë 24.01.2022, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje si vijon: A.B, E.D dhe P.K;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 14.03.2022 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Procesverbali nr. s'ka datë 21.03.2022 për kryerjen e shërbimit për ndërrimin e pjesëve të këmbimit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 8/2022, datë 18.03.2022, në vlerën e 903,600 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, E.A dhe A.V;

-Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 17.02.2022 ka s'kualifikuar 4 OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit, konkretisht; OE “A 2018” në vlerën 769,500 lekë pa TVSH, “AMS” me vlerën 800,000 lekë pa TVSH, “B” me vlerën 766,600 pa TVSH, “D” me vlerën 919,000 lekë pa TVSH si dhe 3 OE s'kualifikohen për shkak se vlera e ofruar prej tyre është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përlogaritur konkretisht, OE “B” në vlerën 179,000 lekë pa TVSH, OE “ES” në vlerën 290,000 lekë pa TVSH dhe -OE “HB” me vlerën 179,000 lekë pa TVSH;

-OE “N” i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 430,000 lekë pa TVSH, është njoftuar në datë 17.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 18.02.2022 OE “N” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e

vlerësimin të ofertave, OE "N" ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye se nuk disponon inventarin e plotë të pjesëve;

-AK ka vazhduar me OE "LS" i renditur i dyti me ofertën 440,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 22.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.02.2022 OE "LS" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimin të ofertave, OE "LS" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

-AK ka vazhduar me OE "B.H" i renditur i treti me ofertën 471,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 24.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 24.02.2022 OE "B.H" nuk është paraqitur pranë AK;

-AK ka vazhduar me OE "S.C" i renditur në vendin e katërt me ofertën 495,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 28.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 28.02.2022 OE "S.I" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimin të ofertave, OE "S.I" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

-AK ka vazhduar me OE "R" i renditur në vendin e pestë me ofertën 657,500 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 02.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 02.03.2022 OE "R" nuk është paraqitur pranë AK;

-AK ka vazhduar me OE "B.A" i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 727,250 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 04.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.03.2022 OE "B.A" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimin të ofertave, OE "B.A" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

-AK ka vazhduar me OE "J.B" i renditur në vendin e shtatë me ofertën 753,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 4,500 lekë pa TVSh.

-OE Fitues është njoftuar në datë 04.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit.

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE pjesmarrës;

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Nuk administrohet ekstrakti bankar i cili të përmbajë të dhënat në lidhje me nr. e llogarisë dhe iban-in;

-Nuk administrohet garanci për mallrat objekt prokurimi si dhe OE nuk ka garantuar vendosjen e tyre në një nga serviset pranë territorit të Bashkisë Kuçovë;

-Nuk administrohet çertifikata e garancisë së mallit për të gjitha pjesët e mësipërme sipas ftesës për ofertë;

-Nuk administrohen dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3-viteve të fundit. Në dosje administrohet një vërtetim për realizimin e një kontrate me Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizime e cila rezulton se nuk janë punë të ngjashme me punën objekt prokurimi.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, E.A dhe A.V;

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tonera)”.

Përshkrimi i veprimeve:

-Urdhri nr. 19, me nr. 232 prot., datë 24.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, E.A dhe A.V;

-Urdhri nr. 68, me nr. 952 prot., datë 23.03.2022, i prokurimit për blerjen e materialeve për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tonera).

-Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 411,500 lekë pa TVSH, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (N, A.M dhe B.A);

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 953 prot., datë 23.03.2022, me specifikimet bashkëlidhur si dhe OE i renditur në vendin e parë përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoj dokumentacionin pranë AK;

-Urdhri nr. 21, nr. 234 prot., datë 24.01.2022, për ngritjen e komisionit për marrjen e mallrave në dorëzim, me përbërje si vijon: A.B, P.K dhe E.D;

-Procesverbali nr. s’ka, datë 12,04,2022 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 21/2022, datë 12.04.2022, në vlerën e 410,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, E.A dhe A.V;

-Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 28.03.2022 ka s’kualifikuar 7 OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit, konkretisht; OE “JG” me ofertë 550,000 lekë pa TVSH, OE “AK” me ofertë 514,480 lekë pa TVSH, OE “AB” me ofertë 520,100 pa TVSH, OE “SR” me ofertë 550,000 lekë pa TVSH, OE “OT” me ofertë 516,667 lekë pa TVSH, OE “DK me ofertë 539,000 lekë pa TVSH dhe OE “OT” me ofertë 577,000 lekë pa TVSH.

-Gjithashtu janë s’kualifikuar 3 operatorë ekonomik për shkak se vlera e ofertuar prej tyre është ulur më shumë se 50% e fondit limit konkretisht; OE “LD” me ofertën 127,777 lekë pa TVSH, OE “T” me ofertë 155,630 lekë pa TVSH dhe OE “A” me ofertë 127,777 lekë pa TVSH.

-Gjithashtu janë s’kualifikuar 4 operatorë ekonomikë për arsye se operatorët ekonomik ofertues nuk kanë si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit konkretisht; OE “JB” me ofertë 280,000 lekë pa TVSH, OE “R.N.M” me ofertë 322,000 lekë pa TVSH, OE “AB” me ofertë 400,000 lekë pa TVSH dhe OE “QD” me ofertën 322,000 lekë pa TVSH.

-Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit të KLSH-së rezulton se 4 operatorët ekonomikë të mësipërm janë s’kualifikuar me pa të drejtë nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi 4 operatorë ekonomikë ofertues kanë si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit;

-OE “PC” i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 218,600 lekë pa TVSH, është njoftuar në datë 28.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 29.03.2022 OE “PO” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “PO” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;

-AK ka vazhduar me OE “SM” i renditur i dyti me ofertën 275,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 29.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 30.03.2022 OE “SM” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;

-AK ka vazhduar me OE “R 2000” i renditur i treti me ofertën 276,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 30.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 31.03.2022 OE “R. 2000” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;

-AK ka vazhduar me OE “BT” i renditur në vendin e katërt me ofertën 289,500 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 31.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.04.2022 OE “BT” është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë por malli nuk ishte sipas ftesës për ofertë për këtë arsye operatori ekonomik është s’kualifikuar;
- AK ka vazhduar me OE “IO” i renditur në vendin e pestë me ofertën 289,500 lekë pa TVSH.
- OE Fitues është njoftuar në datë 01.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.04.2022 OE “IO” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;
- AK ka vazhduar me OE “M” i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 299,000 lekë pa TVSH.
- OE Fitues është njoftuar në datë 04.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 05.04.2022 OE “M” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;
- AK ka vazhduar me OE “A” i renditur në vendin e shtatë me ofertën 319,000 lekë pa TVSH.
- OE Fitues është njoftuar në datë 05.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 06.04.2022 OE “A” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;
- AK ka vazhduar me OE “C” i renditur në vendin e tetë me ofertën 383,000 lekë pa TVSH.
- OE Fitues është njoftuar në datë 06.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 07.04.2022 OE “C” është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë por malli nuk ishte sipas specifikimeve të vendosura në ftesën për ofertë për këtë arsye operatori ekonomik është s’kualifikuar;
- AK ka vazhduar me OE “BS” i renditur në vendin e nëntë me ofertën 388,900 lekë pa TVSH.
- OE Fitues është njoftuar në datë 07.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 08.04.2022 OE “B. S.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Kuçovë;
- AK ka vazhduar me OE “MSH” i renditur në vendin e dhjetë me ofertën 410,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 1,500 lekë pa TVSh.
- OE Fitues është njoftuar në datë 08.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Ankesa

Me shkresën nr.1255 prot., datë 14.04.2022 administrohet ankesa e subjektit “BT” shpk, për procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Blerje material për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tонера), me vlerë të ofertës ekonomike 411,500 lekë lekë, me numër REF-22929-03-24-2022.

Në mënyrë të përmbledhur ankesa është bërë në lidhje me s’kualifikimin e OE “BT” shpk me ofertë ekonomike 289,500 lekë pa TVSH. OE është paraqitur pranë AK me dokumentacionin e kërkuar dhe të gjithë sasinë e mallit sipas kërkesave të AK.

Tonerat e ofertuara janë tërësisht në përputhje me modelin e printerit sipas listës së produkteve të kërkuara nga AK.

Komisioni i marrjes në dorëzim i mallit është shprehur konkretisht; “Tonerat nuk janë sipas specifikimeve të vendosura në ftesën për ofertë” por nuk ka argumentuar se cilin specifikim nuk plotësojnë tonerat e ofertuara nga OE “BT”, pra cilat specifikime nuk plotësonin produktet tek e tek dhe jo të mjaftoheshin me një përgjithësim të tipit “malli nuk plotëson specifikimet”.

Në datën 31.03.2022 OE ka marrë njoftimin e fituesit në SPE. Në datën 01.04.2022 përfaqësuesi i “BT” është paraqitur pranë AK me dokumentacionin e kërkuar dhe sasinë e mallit sipas kërkesave të AK. Bashkangjitur dokumentacionit të ankesës kemi bashkangjitur edhe foto të secilit produkt të ofertuar.

Komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, në shkelje të LPP nuk ka pranuar të marrë në dorëzim mallin me argumentin se malli nuk është në përputhje me specifikimet e vendosura në ftesën për ofertë.

Në ftesën për ofertë specifikimet teknike të vendosura janë:

- 1-Emërtimet e printerave në të cilat tonerat do të përdoren;
- 2-Tonerat të jenë me pullë sigurie, origjinalë ose ekuivalent i origjinalit, në të kundërt malli nuk do të pranohet;
- 3-Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinal të prodhuesit të paisjeve ose ekuivalent dhe nuk duhet të jenë tonera të ricikluara apo të rimbushura;
- 4-Tonerat duhet të mbajnë pullën “G”.

Nga fotot e dorëzuara dhe dokumentacioni i tenderit verifikohet se:

a-Tonerat e ofertuar janë tërësisht në përputhje me modelin e printerit sipas listës së produkteve të kërkuara nga AK.

b-Tonerat janë ekuivalente, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara, vërtetuar me certifikatën e origjinës së mallit dhe autorizimin e prodhuesit me të cilin OE është i autorizuar t'i tregtojë këto produkte.

c-Tonerat përmbajnë pullën e sigurisë sipas kërkesave të AK.

Procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim i mbajtur më datë 01.04.2022, është i pa rregullt pasi nuk janë mbajtur pretendimet e përfaqësuesit të OE “B.T.” si dhe procesverbali nuk është firmosur nga antarët që bënë verifikimin në terren të produkteve.

Përveç sa më sipër OE ka vënë re dhe një sërë parregullësish tek kjo procedurë, dhe procedura të mëparshme të realizuara nga AK konkretisht;

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 24 operatorë ekonomik. Në mënyrë të pa shpjegueshme janë s’kualifikuar 4 OE ofertues, të cilët kanë si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit. OE fitues ka fituar kontratën me 100% të vlerës së fondit limit duke u s’kualifikuar nga AK operatorë me experiencë mbi 20 vjecare në treg si dhe në procedurën e vitit 2021 me të njëjtin objekt prokurimi është shpallur fitues i njëjti OE me 100% të fondit limit.

-Me urdhrin e titullarit me nr. 100, me nr. 1270 prot., datë 14.04.2022 për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje material për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tonerat), të bërë nga OE “BT”, për shqyrtimin e së cilës është caktuar z. EC, me detyrë specialist IT.

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se, nga procesverbalet e administruara nga njësisia e prokurimit dhe komisioni i marrjes në dorëzim vëren se mallrat objekt ankimi nuk janë mallra origjinal ose ekuivalent i origjinalit në cilësi dhe në paketim me arsyetimin se nga verifikimi i barkodeve të tonerave në prani të personit të autorizuar nga OE “BT”, rezultoi që këto barkode nuk ekzistonin sepse nuk hapej asnjë faqe në lidhje me to.

Gjithashtu në vendimin e hartuar nga z. C thuhet se: “... në certifikatën e paraqitur nga operatori ekonomik “BT”, rezulton që OE nuk është i autorizuar për tonerat objekt prokurimi (origjinal ose ekuivalent)”.

-Me vendimin nr. 129 prot., datë 15.04.2022 është trajtuar ankesa e bërë nga OE “B.T.” shpk, sipas së cilës pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron si dhe me vendim nr. 1291/1 prot., datë 15.04.2022 i ka kthyer përgjigje OE “BT” shpk.

-Ky interpretim i bërë nga z. EC është në tejkalim të kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë, sepse në këtë dokument nuk është kërkuar që operatorët ekonomik të paraqesin një certifikatë të tillë autorizimi nga prodhuesi. Përderisa komisioni i marrjes në dorëzim të mallit ka pasur pretendime mbi faktin se mallrat e paraqitura nga OE “BT” nuk janë origjinale dhe kjo gjë është kundërshtuar nga vetë operatori ekonomik, atëherë ka qenë e nevojshme që nga z. EC të verifikohet konkretisht ky mall dhe mbi këtë bazë të dilej në konkluzion nëse tonerat janë ose jo sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përllogaritur fondin limit;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE pjesmarrës;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
-Në dosje administrohet vetëm oferta ekonomike e OE shpallur fitues e cila është pa nr. prot., pa datë;

Nuk administrohet asnjë dokument që të vërtetojë specifikimet e vendosura nga AK si më poshtë:

-Tonerat të jenë me pullë sigurie duhet të jenë origjinal ose ekuivalent i origjinalit, në të kundërt malli nuk do të pranohet.

-Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinale të prodhuesit të paisjeve ose ekuivalent dhe nuk duhet të jenë tonera të ricikluara apo të rimbushura.

-Tonerat duhet të mbajnë pullën "G".

-Nuk administrohet deklaratë nga OE shpallur fitues se malli objekt prokurimi janë të reja, të pa përdorura, ku viti i prodhimit të tyre të jetë 2020-2021;

-Nuk administrohet ekstrakti bankar i cili të përmbajë të dhënat në lidhje me nr. e llogarisë dhe IBAN-in.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, E.A dhe A.V; komisioni i shqyrtimit të ankesave EC.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit".

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 19, me nr. 232 prot., datë 24.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, L.K, E.A dhe A.V;

-Urdhri nr. 242, me nr. 2870 prot., datë 19.09.2022, i prokurimit për shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit".

-Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 182,000 lekë pa TVSH, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (JB, AM dhe AK);

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 2870/1 prot., datë 20.09.2022, me specifikimet bashkëlidhur si dhe OE i renditur në vendin e parë përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoj dokumentacionin pranë AK;

-Urdhri nr. 21 me nr. 234 prot., datë 24.01.2022, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje si vijon: A.B, ED dhe P.K;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 29.09.2022 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 106/2022, datë 29.09.2022, në vlerën e 209,400 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje L.K, E.A dhe A.V;

-Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël pa nr. prot., datë 22.09.2022 ka s'kualifikuar 10 OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit.

-OE "LS" i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 150,000 lekë pa TVSH, është njoftuar në datë 22.09.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 26.09.2022 OE "LS" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "LS" ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye se janë disponibël në procedura të tjera;

-AK ka vazhduar me OE "N" i renditur i dyti me ofertën 162,000 lekë pa TVSH.

-OE Fitues është njoftuar në datë 26.09.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 27.09.2022 OE "N" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "N" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

-AK ka vazhduar me OE "BA" i renditur i treti me ofertën 174,500 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 7,500 lekë pa TVSh.

-OE Fitues është njoftuar në datë 27.09.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përlllogaritur fondin limit, pra komisioni që ka hartuar preventivin nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE pjesmarrës fitues;

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Nuk administrohet dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, si dhe nuk administrohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmushjen me sukses të kontratës.

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk ka respektuar kriteret e vendosura nga AK sipas ftesës për ofertë komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe anulimin e procedurës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, L.K, E.A dhe A.V;

4.4.Zbatimi i punimeve.

Në zbatim të pikës 4.4/4 me objekt: *“Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik”* u konstatua si më poshtë vijon:

1. Mbi zbatimin e kontratës “Rikonstruksion i shkollave 9 vjeçare “Shaban Plaku” dhe Kopshti Fshati Tapi, si dhe “Rustem Patriku” Fshati Vodëz”.

Kontrata me objekt “Rikonstruksion i shkollave 9 vjeçare “Shaban Plaku” dhe Kopshti Fshati Tapi, si dhe “Rustem Patriku” Fshati Vodëz, është nënshkruar me nr. 2879 prot., datë 31.08.2020 me OE “A” Sh.P.K., me vlerë 33,163,059 lekë pa TVSH, ose 39,795,671 lekë me TVSH. Afati i zbatimit të punimeve është përcaktuar 4 muaj, referuar datës së lirimimit të sheshit të ndërtimit. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur “D” Sh.P.K., me përfaqësues ligjor z. VT.

Nga verifikimi i dokumentacionit teknik rezulton se punimet kanë filluar më datë 01.09.2020. Deklarimi nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve për përfundimin e punimeve mban datën 30.12.2020. Edhe në përshkrimin e ditarit të punimeve përshkruhet fillimi dhe përfundimi i punimeve sipas datave të mësipërme. Situacioni përfundimtar hartuar me vlerë 39,795,671 lekë. Akti i kolauditimit është mbajtur më datë 24.03.2021, në të cilin është përcaktuar vlera e realizimit 39,795,671 lekë. Në këtë akt i cili është nënshkruar nga kontraktori, mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori znj. MK, nuk përshkruhet asnjë mangësi në zbatimin e punimeve. Po ashtu në relacionin teknik të mbikëqyrësit të punimeve nuk përcaktohet asnjë mangësi në zbatimin e punimeve sipas kontratës. Punimet nuk janë marrë në dorëzim akoma. Deri në momentin e auditimit, është likuiduar vlera 30,135,251 lekë me TVSH.

Titulli i gjetjes: Monitorim jo i mjaftueshem i kontratës.

Situata: Drejtoria e Planifikimit/Zhvillimit të Territorit Koordinimit – Zhvillimit Strategjik pranë Bashkisë Kuçovë me shkresë nr. 1491/1 prot., datë 10.05.2021, drejtuar Kontraktorit “A” SHPK dhe Mbikëqyrësit të punimeve “D” SHPK, ka paraqitur kërkesën e Zyrës Arsimore Kuçovë, Shkollës 9 – vjeçare “Veis Rustem Patriku”, Vodëz, mbi disa problematika të evidentuara pas përfundimit të punimeve. Po ashtu, kjo drejtori me shkresë nr. 424 prot., datë 08.02.2022, drejtuar kontraktorit “A”, ka përsëritur kërkesën për ndërhyrje për zgjidhjen e problematikave të trajtuara duke lënë një afat 30 ditor. Problematikat si më sipër, janë përcjellë edhe me shkresë nr. 505 prot., datë 08.02.2023, duke paraqitur edhe raste

konkrete të mos përmbushjes së kontratës dhe konkretisht: Mungojnë portat e volejbollit e basketbollit, tualetet janë pa përfunduar, janë dëmtuar pajisjet hidrosanitare nuk janë përfunduar pusetat në oborrin e shkollës, në sistemin elektrik mungojnë priza dhe çelësa si dhe sistemi i ngrohjes (kaldaja qendrore) ka problematika të ndryshme dhe nuk funksionon. Në këtë shkresë theksohet se në rast të mos plotësimit të këtyre problematikave të evidentuara, nuk do të hartohet certifikata e përkohshme dhe nuk do të likuidohet asnjë pagesë. Shkresat e mësipërme janë konceptuar dhe miratuar nga z. F.P dhe z. GB. Pavarësisht përgjegjësisë së mbikëqyrësit të punimeve për mos ndjekjen e kontratës sipas parashikimeve ligjore, nga ana e punonjësve të mësipërm duhet të bëheshin njoftimet përkatëse për penalitete sipas kontratës, duke njoftuar dhe Agjencinë e Prokurimit Publik.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 6.

Ndikimi: Investimi i realizuar nuk ka arritur objektivat e parashikuara.

Shkaku: Mos realizimi me korrektësi i kontratës së punimeve civile.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit riparimin e defekteve dhe mangësive të konstatuara.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. F.P, z. GB dhe z. NC.

Titulli i gjetjes: Mangësi në hartimin e dokumenteve.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se janë plotësuar procesverbalet e punimeve që bëhen të padukshme, janë mbajtur aktkontrolle, janë paraqitur certifikata të testimit të materialeve të ndërtimit, është plotësuar ditari i punimeve, librezat e masave etj. Nga verifikimi i librezës së masave për shkollën Fshati Tapi, u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit 1.3 “Prishje çati ekzistuese” dhe I.12 “Çati vendi e zakonshme HD deri 8 m, mbuluar me tjegulla vendi”, është certifikuar sasia 492 m². Nga përllogaritjet rezulton se sipërfaqja faktike është 478 m². Gabimi në llogaritje ka ardhur si pasojë e përfshirjes së strehës në mesin e çatisë, nga llogaritja e sipërfaqes me dy seksione. Vlera 67,550 lekë [14 m² (495 lekë/m² + 4,330 lekë/m²)] është certifikuar padrejtësisht.

- Sipas zërit 1.10 “Shtresë mermeri 2 cm Janina”, është përllogaritur sasia duke marrë në konsideratë gjatësinë e dritareve 1.6 m, ndërkohë që referuar zërit furnizim dhe vendosje dritare gjatësia është 1.45 m. Sasia 3.5 m² (10 ml x 0.35 ml), me vlerë 18,165 lekë (3.5 m² x 5,190 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

Kriteri: - Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.

- Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

Ndikimi: Përfitim i padrejtë nga ana e kontraktorit.

Shkaku: Mos llogaritja e saktë e volumeve.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për zbritjen në situacionin përfundimtar dhe pagesën përkatëse të vlerës 85,715 lekë, certifikuar më tepër kontraktorit “A” Sh.P.K.

Titulli i gjetjes: Punime të certifikuara, por të pa realizuara, rezultuar nga verifikimet në objekt.

Situata: Nga verifikimi i disa zërave të realizuar në objekt u konstatuan diferenca si më poshtë:

- Shkolla 9 vjeçare Fshati Tapi, nuk është realizuar zëri i punimeve 3.58 “F.V shtylla metalike për ndriçim H = 7 m, d = 160 mm” në sasinë 10 copë. Vlera 188,540 lekë (10 copë x 18,854 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit 3.59 “Ndriçues smart 250 w, 230 v”, nga 10 të parashikuar janë vendosur vetëm 4. Vlera 140,316 lekë (6 copë x 23,386 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.

Nuk janë punimet sipas zërit 3.65 “F.V puseta plastike 40 x 40 cm”. Vlera 33,990 lekë (10 copë x 3,399 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit 3.56 “Konstruksione metalike të thjeshta për portën hyrëse”, është certifikuar sasia 1 ton. Nga përlloraritjet mbi dimensionet e realizuara në objekt, rezulton se pesha faktike është 0.19 ton. Vlera 108,345 lekë (0.81 ton x 133,760 lekë/ton) , është certifikuar padrejtësisht.

Nga verifikimi sipas zërit 3.49 “Shtresë asfaltobetoni me ngjyrë, t = 4 cm...”, rezulton se nuk është realizuar shtresë asfaltobetoni, por shtresë betoni, me një shtresë boje në sipërfaqe të saj. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike dhe përcaktimet në projektin e zbatimit. Bazuar në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manueleve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, sipas zërit 2.262/4 “Shtresë betoni C 16/20” është përcaktuar çmimi 8,525 lekë/m³. Referuar trashësisë 4 cm, çmimi 8,525 lekë i korrespondon sasisë 25 m², duke përcaktuar një çmim të përafërt 341 lekë/m³. Duke marrë në konsideratë lyerjen e sipërfaqes së betonit sipas zërit 2.237/a “Lyerje beton me hyperdesimo”, çmimi përcaktohet 797 lekë/m². Në këto kushte, punimet e realizuara konsiderohen me çmim 1,138 lekë/m² (341 lekë/m² + 797 lekë/m²). Vlera 123,060 lekë [420 m² x 1,431 lekë/m² – 1,138 lekë/m²], është certifikuar padrejtësisht.

Nuk janë realizuar zërat 3.52 “F.V porta + rrjetë basketbolli” copë 2 dhe 3.53 “F.V tabelë + rrjetë volejboli”, copë 1. Vlera 157,060 lekë (125,380 lekë + 31,680 lekë), është certifikuar padrejtësisht.

- Nga verifikimi i punimeve në Kopshtin e Fshatit Tapi, rezulton se nuk janë realizuar punimet sipas zërit 5.87 “Shtresë me pllaka grez porcelanato”, në sasinë 46 m². Pllakat e shtruara nuk janë sipas specifikimeve dhe janë realizuar me punime të kryera më parë në këtë objekt. Vlera 100,096 lekë (46 m² x 2,176 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

Nga verifikimi i punimeve në Shkollën 9 vjeçare të Fshatit Vodëz, rezulton se fusha e basketbollit nuk është realizuar me asfalt me bojë, por shtresë betoni, me lyerje në sipërfaqe. Vlera 123,060 lekë [420 m² x (1,431 lekë/m² – 1,138 lekë/m²)], është certifikuar padrejtësisht.

- Sipas zërit 10.167 “F.V kanxhella rrethimi” ishte parashikuar që mbi muret prej betoni të rrethimit të vendoseshin kanxhella me çmim 2,394 lekë/ml. Nga verifikimi i punimeve rezulton se në vend të kanxhellave, është ndërtuar mur me blloqe betoni, në lartësi nga 70 deri 90 cm, me gjerësi 20 cm. Bazuar në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit pika 2.88 “Mur me blloqe betoni 20 cm, deri në 3 m...”, çmimi për këtë zë punimi është 7,395 lekë/m³, ose 1,479 lekë/m². Duke marrë në konsideratë lartësinë mesatare 80 cm, për çdo metër rrethim është ndërtuar 0.8 m² mur me blloqe betoni. Çmimi i referencës duhet të jetë 1,183 lekë/ml (1,479 x 0.8). Vlera 226,420 lekë [187 ml x (2,394 lekë/ml – 1,183 lekë/ml)], është certifikuar padrejtësisht.

Nga verifikimi sipas zërit 10.175 “F.V shtylla metalike për ndriçim”, rezulton se nuk është realizuar vendosja e 7 shtyllave të parashikuara. Vlera 131,978 lekë (7 x 18,854 lekë/copë).

Po ashtu nuk janë vendosur ndriçuesit smart. Vlera 163,702 lekë (Vlera 7 copë x 23,386 lekë), është certifikuar padrejtësisht.

Kriteri: - Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.

- Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

Ndikimi: Përfitim i padrejtë nga ana e kontraktorit.

Shkaku: Mos paraqitja e saktë në situacionin përfundimtar e volumeve të realizuara në fakt.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për zbritjen në situacionin përfundimtar dhe pagesën përkatëse të vlerës 1,426,397 lekë, certifikuar më tepër kontraktorit “A” Sh.P.K.

Titulli i gjetjes: Punime të certifikuara, por të pa realizuara, rezultuar nga verifikimet në objekt.

Situata: Nga verifikimi i punimeve në shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi, sipas zërit 2.25 “F.V Kaldaje çeliku e presuar Q = 180 kv” rezulton se kaldaja nuk është furnizuar sipas specifikimeve teknike, pasi është parashikuar me lëndë djegësi naftë, ndërkohë që ajo e furnizuar është me lëndë djegëse pellet. Pavarësisht mangësisë së mësipërme kaldaja nuk është funksionale. Vlera e certifikuar për kaldajën (pa përfshirë sistemin e ngrohjes radiatorë, tubacione aksesorë) është me vlerë 1,023,709 lekë. Pavarësisht shpenzimeve të realizuara, nuk arrihet ngrohja e ambienteve të shkollës, duke cënuar procesin mësimor në periudha me temperatura të ulëta.

Kriteri: Specifikimet teknike.

Ndikimi: Nuk arrihet ngrohja e ambienteve të shkollës.

Shkaku: Mos realizimi i kaldajës sipas parashikimit, si dhe mos arritja e vënies në funksion të saj.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të ngreje një komision me përbërje të specialistëve të fushës, për përcaktimin e devijimeve në furnizimin e vendosjen e kaldajës në Shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi. Të trajtohen mundësitë e funksionimit me lëndë djegëse pellet, megjithëse kaldaja ishte parashikuar të funksiononte me naftë dhe të bëhet rivlerësimi i çmimit si pasojë e ndryshimit të teknologjisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. F.P, z. GB dhe z. NC, në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit, mbikëqyrësi i punimeve “D” SHPK, përfaqësuar nga z. VT, si dhe Kolaudatori znj. MK, në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e punimeve në objekt.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar Shoqëria “D” SHPK, është paraqitur observacioni me shkresën nr.s’ka prot., datë 27.03.2023, protokolluar në KLSH me nr. 120/5, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Pretendohet se sipërfaqja e sasisë e konstatuar me diferencë nga grupi i auditimit është matur në plan. Nëse matet sipas pjerrësisë, diferenca nuk qëndron.

Në lidhje me rrethimin me kanxhella, pranohet devijimi, por theksohet se diferenca është e justifikuar me punime shtesë që janë kryer në shkollë si punime elektrike, punime në nyje sanitare, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara dhe nuk janë përfshirë në situacion.

Sa i takon shtyllave të ndriçimit, pretendohet se ato janë vendosur.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Sqarojmë se, nga 11 mangësi të konstatuara është bërë observacion vetëm për 6 mangësi.

Sa i takon çatisë, llogaritjet në preventiv bëhen në plan dhe po me këtë metodë, bëhet edhe llogaritja e sasisë së realizuar.

Sa i takon rrethimit me kanxhella, nga ana e grupit të auditimit nuk mund të evidentohen punime të cilat janë realizuar dhe nuk janë situacionuar siç pretendohet. Punime të pa autorizuara mbeten në koston e kontraktorit.

Sa i takon shtyllave të ndriçimit, në momentin e auditimit ato nuk ishin vendosur. Nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton realizimin e tyre.

2. Mbi zbatimin e Kontratës: “Devijimi i Përroit Gegë”.

Kontrata e punimeve civile është nënshkruar me nr. 4468 prot., datë 22.12.2020, me OE “F” Sh.P.K., me vlerë 14,899,900 lekë pa TVSH, ose 17,879,880 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 3 muaj, referuar fillimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “D” Sh.P.K., përfaqësuar nga z. VT. Leja e infrastrukturës është dhënë me nr. 4509/1 prot., datë 05.01.2021.

Sheshi i ndërtimit i është dorëzuar kontraktorit më datë 12.02.2021. Kontratës bazë i është bërë një amendament nr. 1507/3 prot., datë 04.05.2021, i cili ka të bëjë me shtyrjen e afatit për arsye të vonesës në dhënien e miratimit për ndërhyrje nga ana e ARRSH, në segmentin rrugor që ndërpret kanalën, për vendosjen e tombinove drejtkëndëshe. Në kontratën bazë ishte

parashikuar ndërtimi i kanalit duke kaluar poshtë rrugës nëpërmjet hapjes së një tuneli, i cili do të bënte të mundur ndërtimin e tombinos drejtkëndore me dimensione 3 x 3 m dhe gjatësi 18 m, afër ish fabrikës së tullave. Sipas amendamentit punimet janë ndërprerë deri në dhënien e lejes. Bashkia Kuçovë i është drejtuar ARRSH me shkresë nr. 642 prot., datë 12.02.2021, për miratimin e lejes infrastrukturore për ndërhyrjen në segmentin rrugor si më sipër. ARRSH me shkresë nr. 98 prot., datë 07.01.2022 ka dhënë miratimin përkatës. Punimet kanë rifilluar me datë 04.02.2022. Njoftimi i përfundimit të punimeve mban datën 01.04.2022.

Sa më sipër, në dosjen teknike nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit, nga vendosja e tombinove nëpërmjet hapjes së një tuneli, në gjurmimin e trupit të rrugës për vendosjen e tombinos, më pas realizimin e shtresave të rrugës, në kundërshtim me:

- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f, ku përcaktohet:

Pika 7 “Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- e: Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

- f: Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së”.

Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Pika 9. b, 9.2, ku përcaktohet:

9. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen:

b) Projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike;

9.2 Investitori dhe mbikëqyrësi i punimeve krijojnë dosjen teknike të përbashkët, e cila arkivohet pranë investitorit.”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F.P, z. GB dhe znj. A.B, si dhe mbikëqyrësi i punimeve “D” SHPK, përfaqësuar nga z. VT.

Ndryshimi nuk ka rezultuar me ndryshim të vlerës së kontratës, por eliminimi i punimeve të tunelit është shoqëruar me rritje shumë të madhe të volumit të gjurmimeve, i cili nga 9750 m³ të parashikuar, është raportuar i realizuar në sasinë 36177 m³.

Për një gjatësi të konsiderueshme të kanalit, është ndryshuar gjurma nga ku do të ndërtohej. Në gjurmën e ndërtuar, kanali përshkon toka bujqësore me formacion shumë të dobët dhe në pjesën më të madhe argjilor. Në pjesën e pjerrët janë ndërtuar kaskada për uljen e shpejtësisë së ujit, por në pjesën tjetër jo. Kalimi i ujit, sidomos në raste të prurjeve të mëdha përbën rrezik për dëmtimin e brigjeve të kanalit dhe të tokave bujqësore anash tij. Mos parashikimi i masave mbrojtëse, do të kërkojë investime të konsiderueshme për veshje të kanalit me material betoni.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se janë plotësuar procesverbalet e punimeve që bëhen të padukshme, janë mbajtur aktkontrolle, janë paraqitur certifikata të testimit të materialeve të ndërtimit, është plotësuar ditari i punimeve, librezat e masave etj.

Bazuar në ditarin e punimeve, duke marrë në konsideratë shtyrjen përkatëse, punimet kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, për këtë kontratë është likuiduar vlera 17,879,874 lekë.

Titulli i gjetjes: Nuk janë parashikuar masa të mjaftueshme për qëndrueshmërinë e skarpatave të kanalit pas devijimit.

Situata: Në dosjen teknike sipas kontratës “Devijimi i Përroit Gegë”, nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit, nga vendosja e tombinove nëpërmjet hapjes së një tuneli, në gjurmimin e trupit të rrugës për vendosjen e tombinos, më pas realizimin e shtresave të rrugës.

Ndryshimi nuk ka rezultuar me ndryshim të vlerës së kontratës, por eliminimi i punimeve të tunelit është shoqëruar me rritje shumë të madhe të volumit të gërmimeve, i cili nga 9750 m³ të parashikuar, është raportuar i realizuar në sasinë 36177 m³.

Për një gjatësi të konsiderueshme të kanalit, është ndryshuar gjurma nga ku do të ndërtohej. Në gjurmën e ndërtuar, kanali përshkon toka bujqësore me formacion shumë të dobët dhe në pjesën më të madhe argjilor. Në pjesën e pjerrët janë ndërtuar kaskada për uljen e shpejtësisë së ujit, por në pjesën tjetër jo. Kalimi i ujit, sidomos në raste të prurjeve të mëdha përbën rrezik për dëmtimin e brigjeve të kanalit dhe të tokave bujqësore anash tij. Mos parashikimi i masave mbrojtëse, do të kërkojë investime të konsiderueshme për veshje të kanalit me material betoni.

Kriteri: - VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f.

- Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Pika 9. b, 9.2.

Ndikimi: Rritje e kostos për mirëmbajtje dhe riparim të dëmeve në të ardhmen të skarpatave të kanalit.

Shkaku: Mos parashikimi i masave mbrojtëse, duke qenë se përroi është devijuar në formacion të dobët, kryesisht argjilor.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për parashikimin në planin e investimeve të masave mbrojtëse për skarpatat e kanalit të devijimit të përroit Gegë, me qëllim minimizimin e dëmeve dhe rritjen e kostos për ndërhyrje, si pasojë e dëmëve që mund të shkaktohen nga vërshimi i ujit, në raste të prurjeve të mëdha.

3. Mbi zbatimin e kontratës “Rikualifikim urban i Lagjes Llukan Prifti”.

Kontrata “Rikualifikim urban i Lagjes “Llukan Prifti” është nënshkruar me nr. 435 prot., datë 04.02.2021, ndërmjet Bashkisë Kuçovë përfaqësuar nga Kryetari z. K.H dhe BOE “F” Sh.P.K., dhe “SH 07” Sh.P.K., me vlerë 77,164,680 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 5 muaj, referuar datës së dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Kontrata përfshin punime punime kanalizimesh të ujërave të bardha dhe të zeza, punime elektrike, punime asfaltimi, punime ndërtim trotuaresh dhe mure mbajtës. Projekti i zbatimit është hartuar nga z. F.P, punonjës pranë Bashkisë Kuçovë. Leja e infrastrukturës është dhënë me nr. 464/1 prot., datë 12.02.2021. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur znj. MK me licencë MK.1200/4.

Kontratës i është bërë amendamenti nr. 2103/2 prot., datë 23.06.2021. Amendamenti ka të bëjë me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, për arsye të pengesave të hasura në piketën 0 dhe piketa të tjera, në shpronësimin e disa objekteve të planifikuara për shëmbje. Afati i zbatimit të kontratës është shtyrë nga data 04.07.2021 që ishte parashikuar deri me datë 04.09.2021. Po ashtu me amendamentin nr. 2906/1 prot., datë 03.09.2021, për arsye të mos prishjesh së objekteve të përcaktuara për shëmbje, si dhe të pamundësisë së spostimit të disa shtyllave për të cilat kërkohet asistencë e OSHEE, është shtyrë afati i përfundimit të punimeve nga data 03.09.2021 deri me datë 04.12.2021.

Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, procesverbali për fillimin e punimeve, janë mbajtur me datë 17.02.2021. Akti i piketimit të objektit është hartuar po në këtë datë.

Gjatë zbatimit të kontratës është bërë azhurnimi i punimeve nga ku kanë rezultuar shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar aktet përkatëse. Në dosjen teknike të objektit ndodhet procesverbali i datës 16.06.2021, i cili nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit z. F.P dhe Kryetari i Bashkisë z. K.H.

Ndër ndryshimet e bëra është mos vendosja e guardrails, si një element i domosdoshëm për sigurinë rrugore. Në dosjen teknike nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit, në kundërshtim me:

- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f, ku përcaktohet:

Pika 7 “Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion

të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- e: Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

- f: Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së”.

Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Pika 9. b, 9.2, ku përcaktohet:

9. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen:

b) Projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike;

9.2 Investitori dhe mbikëqyrësi i punimeve krijojnë dosjen teknike të përbashkët, e cila arkivohet pranë investitorit.”.

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me datë 13.12.2022, protokolluar me nr. 3831 prot., datë 14.12.2022. Duke marrë në konsideratë datën e fillimit të punimeve 17.02.2021, si dhe afatin e shtyrjes përkatësisht me 5 muaj (3 muaj + 2 muaj), konsiderohet se punimet kanë përfunduar brenda afatit kohor të miratuar.

Deri në momentin e auditimit, objekti nuk i është nënshtruar procesit të kolaudimit tekniko ekonomik. Punimet e certifikuara janë me vlerë 77,164,680 lekë me TVSH, nëpërmjet 8 situacioneve. Situacioni përfundimtar është hartuar me vlerë 77,164,680 lekë me TVSH, nënshkruar nga përfaqësuesit e kontraktorit, por jo Bashkia Kuçovë.

Nga krahasimi i librezës së masave me certifikatën përfundimtare ka volume të cilat janë situacionuar më pak, kryesisht në shtresat asfaltike, tuba të brinjëzuar HDPE d = 315 mm, bordura betoni, beton themel muri dhe beton për mure.

Likuidimi për këtë kontratë është me vlerë 40,099,000 lekë, ose në masën 52 %.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se janë plotësuar procesverbalet e punimeve që bëhen të padukshme, janë mbajtur aktkontrolle, janë paraqitur certifikata të testimit të materialeve të ndërtimit, është plotësuar ditari i punimeve, librezat e masave etj.

Bazuar në ditarin e punimeve, duke marrë në konsideratë shtyrjen përkatëse, punimet kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Titulli i gjetjes: Ndryshime të zërave të punimeve pa argumentimet e nevojshme.

Situata: Gjatë zbatimit të kontratës “Rikualifikim urban i Lagjes ‘Llukan Prifti’” është bërë azhurnimi i punimeve nga ku kanë rezultuar shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar aktet përkatëse. Në dosjen teknike të objektit ndodhet procesverbali i datës 16.06.2021, i cili nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit z. F.P dhe Kryetari i Bashkisë z. K.H. Ndër ndryshimet e bëra është mos vendosja e guardrails, si një element i domosdoshëm për sigurinë rrugore. Në dosjen teknike nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit.

Kriteri: - VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f.

- Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Pika 9. b, 9.2.

Ndikimi: Nuk plotësohen të gjitha masat e parashikuara, sidomos në lidhje me sigurinë rrugore.

Shkaku: Ndryshime të pa argumentuara.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t’i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me economicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Titulli i gjetjes: Ndryshime të zërave të punimeve pa argumentimet e nevojshme.

Situata: Gjatë zbatimit të kontratës “Rikualifikim urban i Lagjes “Llukan Prifti” është bërë azhurnimi i punimeve nga ku kanë rezultuar shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar aktet përkatëse. Në dosjen teknike të objektit ndodhet procesverbali i datës 16.06.2021, i cili nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit z. F.P dhe Kryetari i Bashkisë z. K.H. Ndër ndryshimet e bëra është mos vendosja e guardrails, si një element i domosdoshëm për sigurinë rrugore. Në dosjen teknike nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit.

Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt, u konstatua se, sipas zërit III.8 “F.V puseta plastike 40 cm x 40 cm”, janë të dëmtuara dhe pa kapakë, dëmtime të cilat dukshëm rezultojnë se janë bërë pas ndërtimit të tyre.

Kriteri: - VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f.

- Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Pika 9. b, 9.2.

Ndikimi: Nuk plotësohen të gjitha masat e parashikuara, sidomos në lidhje me sigurinë rrugore.

Shkaku: Ndryshime të pa argumentuara.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t’i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

- Bashkia Kuçovë t’i kërkojë kontraktorit riparimin dhe pajisjen me kapakë të pusetave plastike, duke qenë se punimet janë në periudhën e riparimit të defekteve. Të merren masa për njoftimin e organeve kompetente për identifikimin e dëmtuesve dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme të infrastrukturës.

4.Mbi zbatimin e kontratës: “Rikualifikim i rrugës Murat Daulle”.

A. Kontratata (Sipërmarrje, mbikëqyrje/kolaudim).

1. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.116 prot., datë 14.01.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë, përfaqësuar Kryetari Z. K.H dhe sipërmarrësit të punimeve OE “K” SHPK me administrator Z.JQ + "F" ShPK, me administrator FM + "SH 07", me administrator SHK. Vlera e kontratës 44,324,040 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është 3 muaj nga lidhja e kontratës. Burimi i financimit nga buxheti i Bashkisë Kuçovë.

2. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontratë shërbimime Nr.116/1 prot, datë 14.01.2021, ndërmjet Bashkisë Kuçovë përfaqësuar nga zyrtari i autorizuar K.H dhe OE“D” SHPK me administrator z. VT.

3.Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontratë kolaudimi punimesh ndërtimi me Nr.4293 prot, datë 28.12.2021 ndërmjet Bashkisë Kuçovë përfaqësuar nga Titullari K.H dhe kontraktuesit përfaqësuar nga Znj. MK.

B. Projekti i zbatimit; Leje ndërtimi;

- Për ndërtimin e investimit me objekt: “Rikualifikim i rrugës “Murat Daulle” nga Titullari i Bashkisë Kuçovë K.H është lëshuar Leje Infrastrukturore me Nr. 227/1, datë 29.01.2021. Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2020 nga drejtorja e urbanistikës Kuçovë.

C. Zbatimi i punimeve të ndërtimit dhe grafikut të punimeve.

Punimet kanë filluar me datë 29.01.2021 sipas njoftimit të fillimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe kanë përfunduar me datë 28.10.2021.

Akti i piketimit për objektin “Rikualifikim i rrugës “Murat Daulle” është, mbajtur me datë 29.01.2021.

-Me datë 29.07.2021 është mbajtur proces verbali Nr. s'ka, mbi miratimin e ndryshimit të volumeve për objektin: “Rikualifikim i rrugës “Murat Daulle”.

Për sa më sipër është mbajtur dokumentacioni, si vijon:

- Proces verbal mbin dryshimin e volumeve.
- Preventivi i ripunuar me vlerë 44,312,770 lekë me TVSH.

- Tabela përmbledhëse e punimeve që shtohen dhe hiqen.

Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit bazë dhe i ndryshuar, preventivit bazë dhe i ndryshuar, situacionet pjesore dhe përfundimtar, libreza e masave, ditari i punimeve, grafiku i punimeve bazë dhe i rishikuar me të dhëna të përgjithshme si vijon:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikim i rrugës “Murat Daulle” Kuçovë.		
Lidhja e kontratës Nr.116 prot., datë 14.01.2021 OE “K&F& SH 07 “ ShPK	Vlera e kontratës Vlera e preventivit ofertues 36,927,308.1 lekë me TVSH	Likuiduar: Në vlerën 21,855,029 lekë me TVSH deri 31.12.2021.
Situacioni Përfundimtar -Vlera 44,312,770 lekë me TVSH.	Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 29.01.2021 Përfundimi punimeve: 28.10.2021	Zgjatja e kontratës 5 muaj
Akt Kolaudimi Datë: 20.01.2022	Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 15.02.2022 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Kuçovë. Urdhër nr. 38., datë 09.02.2022 është ngritur grupi me përbërje: O.Z, G.B dhe F.P.	

Nga auditimi në terren mbi realizimin e punimeve të ndërtimit për shtresat e rrugës në objektin: “Rikualifikim i rrugë “Murat Daulle” Bashkia Kuçovë, u konstatuan diferenca në volume dhe punime të pa kryera, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Kuçovë, në vlerën **94,685 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	
Rruga Kosova. Punime në trotuar.									
Zëri 9 (An-22)	Ndërtim pusete shkarkimi 40x40 betoni + kapak	copë	19,000	46	46	44	2	39,000	
Zëri 23 (3.617/1)	FV. Bordurë 15x30cm.	ml	1000	1295	1295	Është realizuar me 12x25 dhe jo 15x30cm	-	55,685	
Totali në lekë pa TVSH									94,685

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në objektin “Rikualifikim i rrugës “Murat Daulle”.

Situata: Punime kanalizime KUB + KUZ

Zëri: 9(An-22) Ndërtim pusete shkarkimi 40x40 betoni + kapak.

Preventivi i rishikuar dhe situacioni përfundimtar pasqyron volumin prej 46 puseta shkarkimi me çmim 19,000 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 46 puseta shkarkimi, të detajuara analitikisht. Në fakt, nga auditimi në objekt mbi kryerjen e këtij zëri, rezultoi se janë vendosur 44 puseta dhe jo 46 puseta siç është pasqyruar në librezën e masave. Diferenca prej 2 puseta, është situacionuar dhe librezuar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve, duke përfituar në mënyrë të padrejtë për punime të pa kryera (2 puseta) në vlerën **38,000 lekë pa TVSH** (2 puseta x 19,000 lekë).

Punime në trotuar.

Zëri 23(3.617/1) FV. Bordurë 15x30cm.

Preventivi i rishikuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë volumin 1295 ml bordurë 15x30 cm, me çmim 1000 lekë. Libreza e masave, pasqyron 1295 ml bordurë 15x30cm, detajuar analitikisht. Nga auditimi i punimeve në objekt rezulton se, është vendosur bordurë 12x25cm dhe jo bordurë 15x30cm. Pra ky zë pune është realizuar sipas 3.616/a të VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me çmim 1,043 lekë dhe nuk është realizuar sipas projekt preventivit me çmim 1,000 lekë. Sa më sipër diferenca në çmim prej 43 lekë është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **55,685 lekë pa TVSH** [43 lekë x 1295 ml bordurë].

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me Nr.116 prot., datë 14.01.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4293 prot., datë 28.12.2021 .

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 93,685 lekë në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Punime ndërtimi te pa kryera nga sipërmarrësi.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të arkëtojë vlerën prej 93,685 lekë pa TVSH nga BOE “K & F & SH 07” ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me 116 prot., datë 14.01.2021 me objekt “Rikualifikim i rrugës Murat Daulle”.

III.2.5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me Nr. 120/1 prot., datë 31.01.2023, i ndryshuar, me objekt: “**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar**, prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Kuçovë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrikë.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit.
5. Deklarata paraprake e punimeve të ndërtimit.

Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022³⁵.

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Kuçovë, gjatë periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën në kapitullin “Anekse-Aneksi nr.7” të Projekt Raportit të Auditimit.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Kuçovë, janë miratuar 51 leje ndërtimi, ndër të cilat leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar 3 leje, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar 3 leje, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë miratuar 31 leje, ndërsa leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar 8 leje ndërtimi, 5 leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni dhe 1 leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni. Në tabelën në kapitullin “Anekse-Aneksi nr.7” të Projekt Raportit të Auditimit, pasqyrohet përmbledhja e listës së lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Kuçovë, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022.

Në bazë të informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Kuçovë për periudhën 01.07.2019 deri më 31.12.2022, janë dhënë **28 certifikata përdorimi**, të paraqitura në tabelën në kapitullin “Anekse-Aneksi nr.7” të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

³⁵ Observacionet e bëra për sa është trajtuar në këtë çështje, janë të pasqyruara në Kapitullin “Anekse – Aneksi nr.7”, në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m²:

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit
1.	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumeshti dhe ambiente ndihmëse	FA-2021	Nr. 733/1, datë 09/03/2022	37,185,811
2.	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Magazinë për përpunimin e xhamit	P.G	Nr. 1854/1, datë 10/06/2021	18,086,160
3.	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Ndërtim Magazinë Ikat	FK	Nr. 1439/1, datë 23/05/2022	11,711,671
4.	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtimin ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Ndërtim Magazinë 1 kat mbi objekt ekzistues	MF	Nr.789/1, datë 17/03/2022	3,772,883
5.	Certifikatë përdorimi	Objekt shërbimi dhoma zhveshje	R.Z dhe E.D	Nr. 2123/1, datë 07/07/2021	
6.	Certifikatë përdorimi	Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat	EB	Nr. 1420/1, datë 10/05/2021	
7.	Deklaratë paraprake punimesh Ndërtim me konstruksion metalik pa marrë deklaratë paraprake punimesh				

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë në të cilën pasqyrohej situata, në lidhje me mospërputhshmerinë e tipit të konstruksionit të lejuar në tokat bujqësore.

Titulli i gjetjes: Konstruksioni i objektit jo në përputhshmëri me tipin e konstruksionit të lejuar në tokat bujqësore.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se konstruksioni i objektit nuk është në përputhshmëri me tipin e konstruksionit të lejuar në tokat bujqësore, gjetje e cila u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt:

"Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumeshti dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë. Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016, zona bën pjesë në njësinë strukturore 4/82 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme:Kategoria e njësisë është bujqësi 98%; Ka kufizim ligjor konservim dhe mbrojtjen e tokës bujqësore.Duke u bazuar në dokumentin e Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Territorit, pika 3.1.5 përcaktohet se në zonat që i përkasin kategorisë bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndërtimin në tokën bujqësore.Gjithashtu në Vendimin për VNM-në paraprake, në pikën 3.26, përcaktohet se: "Subjekti duhet të ketë në vemendje të vecantë respektimin e Ligjin Nr. 131/2014 "Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar. Në bazë të Nenit 14 për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet, pika 4, përcaktohet se: "Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral." Në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit, në përshkrimin e strukturës së ndërtimit përcaktohet që struktura është e përhershme dhe jo e përkohshme. Në projektin e ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, lloji i strukturës nuk është në përputhje me pikën 4 të ligjit Nr.9244, pasi objekti nuk është një ndërtim me strukturë të përkohshme, por ka elementë kontruktiv themele dhe konstruksion me beton e mure tulle, që lidhen në mënyrë të qëndrueshme e të përhershme me tokën.Në planvendosje pasqyrohen edhe dy depo sillazhi, me konstruksion betoni, me përmasë 20 m me 14.5 m, me lartësi 2.5 metra, vëllim i cili nuk pasqyrohet në tabelën e treguesve të zhvillimit, në preventiv dhe në të dhënat e përgjithshme të volumeve.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, Nenit 14, për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet, pika 4, përcaktohet se: "Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të

qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral."

Në bazë të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016, në pikën 3.1.5 përcaktohet se: "Në zonat që i përkasin kategorisë "bujqësi", pavarësisht përzierjes së kategorive dhe sipas shtojcës 3 të kësaj rregulloreje, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës dhe ndërtimin në tokë bujqësore."

Në këto zona sipas pikës 3.1.5/ a përcaktohet se: Ndërtime për qëllime apo në funksion të aktivitetit bujqësor të cilat kryhen në tokë bujqësore, në të paktën një nga rastet e mëposhtme, do të përcaktohen si zhvillime me karakter tranzitor në tokën bujqësore dhe për këtë qëllim, kategoria e parcelës përkatëse të ndërtimit/zhvillimit, pa rënë ndesh me ligjin, nuk do të ndryshojë nga bujqësore në urbane.

Ndikimi/Efekti:Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi,

-konstrukcioni lidhet në mënyrë të qëndrueshme e të përhershme me tokën dhe nuk janë ndërtime të përkohshme e të lehta;

-dëmton tokën bujqësore nga me tipin e konstrukcionit;

-ndryshon tipologjinë e ndërtimit të lejuar;

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia:I Lartë

Rekomandimi:Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet që nuk janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z.F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim;3.Znj. A.B, me detyrë specialist për projektet, nga data 18.04.2016 e në vazhdim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë në të cilën pasqyrohej situata, në lidhje me ndërtimin e rrugëve të shërbimit mbi tokat bujqësore, në mospërputhje me rregulloren e planit të përgjithshëm të territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes:Ndërtimi i rrugëve të shërbimit në tokat bujqësore në mospërputhje me rregulloren e planit të përgjithshëm të territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Situata:Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në tokat bujqësore janë ndërtuar rrugët e shërbimit, gjetje e cila u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt:

"Stallë për mbarëshkrimin e lopëve për prodhim qumeshti dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë. Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016, zona bën pjesë në njësinë strukturore 4/82 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme: Kategoria e njësisë është bujqësi 98% dhe ka kufizim ligjor konservim dhe mbrojtjen e tokës bujqësore. Duke u bazuar në dokumentin e Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Territorit, pika 3.1.5/ b/c, përcakton që nuk lejohet ndërtimi i rrugëve të shërbimit mbi tokën bujqësore. Duke u bazuar në planvendosjen e miratuar objektivit, evidentohet qartë që është realizuar rrugë aksesit për në objekt, si edhe një hapësirë parkimi për automjetet, e realizuar me beton duke cënuar tokën bujqësore. Gjithashtu në planvendosje dhe në projekt evidentohet ndërtimi i murit perimetral rrethues.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, Nenit 14, për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet, pika 4, përcaktohet se:"Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të

qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral. "Në bazë të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016, në pikën 3.1.5/ b/c, përcaktohet se: "Nuk lejohet ndërtimi i rrugëve të shërbimit mbi tokën bujqësore."

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, çënon tokën bujqësore.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga infrastruktura.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z.F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim;3.Znj. A.B, me detyrë specialist për projektet, nga data 18.04.2016 e në vazhdim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek të cilat pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura sipas Vendimit.

Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i lartësisë maksimale të lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura sipas Vendimit.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk respektuar lartësia maksimale e lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumeshi dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë. Në bazë të kriterëve të përcaktuara në Vendim përcaktohet që struktura duhet të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 4,50 m. Duke u bazuar tek projekti arkitektonik evidentohet që lartësia e katit e tejkalon lartësinë 4,50 m të përcaktuar sipas rregullores, me lartësi maksimale të objektit 6,84 m.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të Vendimit Nr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", Kreu II.b, pika 4, përcaktohet se: Për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3. Ndërsa në Kreun II.b, Pika 3 përcakton:

a) Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:

- 20 metër nga kufijtë e pronës;

- 500 metër nga qendrat e banuara;

- 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

b) Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 4,50 m;

c) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 0.5 m³/m².

Ndikimi/Efekti: Tejkalimi i lartësisë në ndërtimit ndikon në mosrespektimin e lartësisë së lejuar të tipologjisë së ndërtimit, duke rritur vëllimin e objektit dhe rritjen e intensitetit të ndërtimit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë.

Rëndësia: I Mesëm

Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të verifikuar lartësisë e lejuara të strukturës së ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe kriteret e përcaktuara.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Znj.A.B, me detyrë specialist për projektet, nga data 18.04.2016 e në vazhdim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 2 praktika tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mospërcaktimi i saktë i numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në planvendosje dhe në të dhënat e treguesve të parametrave të zhvillimit, nuk pasqyrohej saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit.

Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1."Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr.1854/1, datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë. Duke u bazuar në projektin e ndërtimit, në planimetri evidentohen shkallët që aksesojnë katin e dytë. Gjithashtu edhe në fasadë objekti është në lartësinë e dy kateve. Objekti nuk është në lartësinë e 1 kati, por të dy kateve ndërtimi. Në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit, nuk pasqyrohen numri i kateve të objektit.

2. "Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Në bazë të përcaktimit të lartësisë së ndërtimit në metra, objekti zhvillohet në lartësinë e 9.5 metrave, në lartësinë e dy kateve. Në planvendosjen e miratuar dhe tek treguesit e zhvillimit, nuk pasqyrohet numri i kateve të objektit.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të VKM-së 408, Neni 15, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi, pika c, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 37, në pikën b përcaktohet: lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit, nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të objektit në terren të sheshtë, deri në kulmin e mbulesës nga jashtë, për mbulesa të pjerrëta;

VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 37, pika 1, përcaktohet se për llogaritjen apo vlerësimin sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, lartësia e ndërtimeve shprehet gjithmonë njëkohësisht në numër katesh dhe metra.

VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 37, pika 3/a, përcakton se lartësia dysHEME-dysHEME është 3.00 m, për objektet industriale është minimalisht, 3,5 (tre presje pesë) m.

Ndikimi/Efekti: Mosparaqitja e saktë e numrit të kateve në planvendosje, tek të dhënat e treguesve të parametrave të zhvillimit, ndikon në parametrat e zhvillimit dhe në respektimin e distancave nga kufiri i pronës dhe ruajtjen e distancave ndërmjet objekteve. Ndryshimi i të dhënave për numrat e kateve ndikon në elementët e mëposhtëm:

- lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re;
- normat e lejuara të distancave;
- vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë;

-diellëzimin dhe orientimin;

-respektimin e normave mjedisore

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia:I mesëm

Rekomandimi:Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës.

Situata:Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës nuk janë respektuar sipas kritereve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit.Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Lartësia e objektit zhvillohet në lartësinë e dy kateve.Me ndryshimin e përcaktimit të lartësisë së objektit, distanca që duhet të respektojë nga kufiri i pronës është 3 metra (2 k +1m). Në orjentimin veri dhe në orjentimin jug, distanca nga kufiri i pronës është 2.4 metra.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës,në të cilën përcaktohet se: " Distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve".

Ndikimi/Efekti:Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe çënon zhvillimin e ndërtimve të reja në parcelat kufitare, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi:Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z.F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e në vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kritereve të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor dhe në Rregulloren e Planit të miratur nga Bashkia Kuçovë.

Titulli i gjetjes:Mosrespektimi i kushteve të Planit të Detajuar Vendor të miratur nga Bashkia Kuçovë dhe nëndarja e parcelës sipas PDV-së.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuara të cilat janë pjesë e PDV-së, nuk është zhvilluar ndarja e parcelës në bazë të PDV-së dhe nuk janë plotësuar të gjitha kondicionet urbane, të tillë si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, sipërfaqe ndërtimi intensiteti i ndërtimit, në përputhje me PDV-në e miratuar. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme të miratur për leje ndërtimi, me objekt: 1. "Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Zona në të cilën do të zhvillohet objekti bën pjesë në njësisë strukturore 4/104 (Plan i Detajuar Vendor) dhe në njësisë strukturore 4/102 (Plan i Përgjithshëm Vendor). Sipërfaqja më e madhe e tokës bën pjesë në njësinë strukturore 4/102. Në dokumentat e pronësisë të ngarkuara në sistem, zona kadastrale Nr. 2918, me llojin e pasurisë "arë" dhe sipërfaqe totale 2851m² është vendosur e plotë si sipërfaqe, pa zhvilluar ndarjen e parcelës. Rreth 1/3 e sipërfaqës totale të parcelës i përket njësisë me Plan të Detajuar Vendor 4/104, ndërsa 2/3 e parcelës i përket njësisë 4/102, në kategorinë e zhvillimit të bujqësisë. Duke u përfshirë e gjithë sipërfaqja e parcelës në sipërfaqen e tokës që zhvillohet, pa u ndarë në bazë të zonave të zhvillimit, ndryshojnë edhe parametrat e treguesve të zhvillimit. Koeficienti i zhvillimit të territorit i lejuar sipas PDV-së është 40 %. Duke e përlogaritur me 1/3 e sipërfaqes e tejkalon atë, Ksht arrin vlerën 50%.

2. "Ndërtim Magazinë 1 kat mbi objekt ekzistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 789/1, datë 17/03/2022, me zhvillues dhe aplikues MF, në fshatin Perondi, Kuçovë. Pasuria në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në dy njësi të ndryshme zhvillimi, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor 4/102 dhe Planit të Detajuar Vendor 4/104. Në aplikim nuk është bërë ndarja e parcelës në bazë të kategorisë së zhvillimit, duke e pasqyruar të plotë të gjithë parcelën. Sipas të dhënave të PDV-së, nën njësia 4/104_22, në të cilën bën pjesë 1/3 e parcelës dhe e ndërtimit ekzistues, në sipërfaqen e ndërtimit për m² të lejuar për shërbime është 1115,25 m². Në bazë të treguesve të zhvillimit, kjo sipërfaqe është tejkaluar që me ndërtimin ekzistues dhe nuk lejon shtimin e sipërfaqeve të tjera mbi ato ekzistuese. Në të dhënat e paraqitura për treguesit e zhvillimit është marrë e gjithë sipërfaqja e parcelës "arë" në llogaritjen e intensitetit dhe koeficientit të shfrytëzimit të territorit, jo vetëm parcela që është pjesë e PDV-së 4/104. Shtesa e katit mbi objektin ekzistues është pajisur me certifikatë përdorimi me Nr. 3703/1, datë 20.12.22, duke mos qenë në përputhje me parametrat e përcaktuara në planin e detajuar vendor.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Në bazë të Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 22, Plani i detajuar vendor.

- Plani i Detajuar Vendor i njësisë strukturore 4/104, me Vendimin Nr. 7, datë 31.03.2021, të hartuar nga Bashkia Kuçovë.

- Rregullorja e Planit të Detajuar Vendor të Njësisë strukturore 4/104, të miratuar nga Bashkia Kuçovë.

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 29, Nënndarja e parcelës për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse."

- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 39, koeficienti i shfrytëzimit të territorit

Ndikimi/Efekt: Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, ndikon në:

- a) lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re;
- b) normat e lejuara të distancave;
- c) vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë;
- ç) vlerat e trashëgimisë kulturore në zonë;
- d) diellëzimin dhe orientimin;
- dh) respektimin e normave mjedisore
- e) infrastruktura publike

f) hapësirat publike

g) hapësirat e gjelbërta dhe rekreative

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, sipas Rregulloren e Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z.F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:

1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z.F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.J.L, me detyrë inspektor i IVMT-së.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt: 1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumeshti dhe ambiente ndihmëse ", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA 2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë.

Në dokumentat e ngarkuar në sistemin e-leje, mungojnë mendimet e intitucioneve. Në lejen e zhvillimit është marrë vetëm mendimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por jo i institucioneve të tjera, të përcaktuara më poshtë: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Vendore ASHK, OSHEE, PMNZSH, Ujësjiellës Kanalizime. 2."Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1854/1, datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë. Në dokumentat e ngarkuar në sistemin e-leje, mungojnë mendimet e intitucioneve. Duhet marrë mendimi i të gjitha autoritetet publike të specializuara si: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Vendore ASHK, OSHEE, PMNZSH, Ujësjiellës Kanalizime.

3. "Ndërtim Lokal Shërbimi Ikat + Ndërtim Fushë futbollit" me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr.1307/1, datë 22/04/2022, Nr.3933/1, me datë 19/12/2018; Nr.3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr.1044/1 prot., datë 08/04/2020. Në dokumentat e ngarkuar në sistemin e-leje, mungojnë mendimet e intitucioneve. Duhet marrë mendimi i të gjitha autoritetet publike të specializuara si: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Vendore ASHK, OSHEE, PMNZSH dhe kryesisht Ujësjiellës Kanalizime.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Nenit 10/1, Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi, pika 1, përcaktohet se: "Autoriteti vendor përgjegjës dhe sekretariati i KKT-së, sipas fushës përkatëse të kompetencës: a) shqyrtojnë kërkesën për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore;

b) marrin vetë, kryesisht, dhe administrojnë, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, të gjithë dokumentacionin apo informacionin e nevojshëm nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, sipas rastit;

c) sigurojnë përditësimet e infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, atyre elektrike, telefonike, të pikave të depozitimit të mbetjeve, intensitetin e studimit sizmologjik, si shërbim me një ndalesë."

-Në bazë VKM-së 408, të Nenit 14, pika 3, përcaktohet se: "Lejet e ndërtimit jepen vetëm pasi janë marrë lejet dhe autorizimet përkatëse për ndërtimin në fjalë, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi."

Ndikimi/Efekti: Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit pa qenë në konformitet me legjislacionin në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër Nr. 1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:

1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Znj. A.B, me detyrë specialist për projektet, nga data 18.04.2016 e në vazhdim.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër Nr. 2 dhe Nr.3, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohet e njëjta situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse.

Titulli i gjetjes: Mospërputhja ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar tipologjia e ndërtimit nuk përkon me tipologjinë e objekteve të lejuara në njësinë në të cilën zhvillohet, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi me objekt: 1."Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat ", për të cilën është marrë certifikatë përdorimi me Vendimin Nr.1420/1, datë 10/05/2021, me zhvillues dhe aplikues E. B., në fshatin Kozare, Kuçovë. Njësia në të cilën zhvillohet objekti sipas Planit të Përgjithshëm Vendor i pëket njësisë 2/67, kategoria e zhvillimit e cila është 99 % bujqësi dhe me kufizimin ligjor për konservimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore. Objektet

që janë në funksion të bujqësisë duhet të plotësojnë kriteret e Vendimit Nr.283, datë 1.4.2015, i ndryshuar. Në tipologjinë e objekteve për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, që ndërtohen në tokë bujqësore, nuk përcaktohen objekte me funksion tregtar. Në bazë të Vendimit Nr. 283, datë 1.4.2015, kapitulli II, Rregulla dhe kriteret të përgjithshme, tek pika 3 përcaktohet që: "Leja e ndërtimit për objektet e përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi, jepet vetëm me kushtin e ruajtjes dhe mosndryshimit të destinacionit për qëllim bujqësor/blegtoral të objektit për të cilin është lëshuar."Objekti i realizuar nuk ka funksion bujqësor dhe tipologjia e ndërtimit nuk përputhet tipologjinë e lejuar sipas njësisë strukturore.

2."Objekt shërbimi dhoma zhveshje", për të cilën është marrë vendimi Nr.2123/1, datë 07/07/2021, me zhvillues dhe aplikues R.Z dhe E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë.Në të njëjtën sipërfaqe parcele janë marrë edhe disa leje të tjera ndërtimi, me funksion shërbimi, për ndërtime me sipërfaqe deri në 250 m², si më poshtë: "Ndërtim Lokal Shërbimi 1kat + Ndërtim Fushë futbollit" me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr. 1307/1, datë 22/04/2022, Nr.3933/1, me datë 19/12/2018; Nr. 3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr.1044/1 prot.,datë 08/04/2020.Njësia në të cilën zhvillohen objektet, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor i përket njësisë 4/99, kategoria e zhvillimit e cila është 98 % bujqësi dhe me kufizimin ligjor për konservimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore. Në dokumentat e pronësisë të ngarkuara në sistem statusi i parcelës në të cilën zhvillohet objekti është "arë" dhe kategoria që mund të zhvillohen janë objekte që nuk çenojnë tokën bujqësore dhe në funksion të kategorisë së bujqësisë. Duke u bazuar në dokumentin e Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Territorit, pika 3.1.5 përcaktohet se në zonat që i përkasin kategorisë bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndërtimin në tokën bujqësore. Tipologjia e ndërtimit nuk përkon me kategorinë e lejuar në zonë, bujqësisë, në mospërputhje me kategorinë e lejuar në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të rregullores së Planit të Përgjithshëm të Territorit, të miratuar me Vendimin të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 29.12.2016, në pikën 3.1.5, përcaktohet se në zonat që i përkasin kategorisë bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndërtimin në tokën bujqësore.

Në bazë të Vendimit Nr.283, date 1.4.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar, pika 3.

Ndikimi/Efekti:Mungesa e verifikimit të zbatimit të punimeve dhe akt kontrolleve në fazat gjatë zbatimit të objektit, ndikon në ndërtimin e tipologjisë së objekti në mospërputhje me njësinë në të cilën zhvillohet.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendjen e duhur aplikimin e lejeve të ndërtimit në mënyrë që tipologjia e ndërtimit të jetë në përputhje me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm. Gjithashtu Bashkia Kuçovë dhe strukturat përkatëse të marrin masa për të ndjekuar zhvillimin e lejeve të miratuara edhe gjatë fazave të zbatimit, në mënyrë që tipologjia e ndërtimit dhe objekti të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë;2.Z.F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vijim;3.Z.O.Z,me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Investimeve, Pronave Publike dhe e Emergjencave Civile, nga data 01.01.2020 e në vijim.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Aplikimi i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me kategorinë e lejes.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, gjetje e cila u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi me objekt: 1. “Ndërtim Lokal Shërbimi 1 kat + Ndërtim Fushë futbollit” me zhvillues Z.R.Z dhe Z.E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr.3933/1, me datë 19/12/2018 dhe leja me Nr. 1044/1 prot., datë 08/04/2020. - Leja e parë me Nr.3933/1 është marrë me datë 19/12/2018, për objektin “Ndërtim Lokal Shërbimi 1kt + Ndërtim Fushë futbollit”, me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D. Ndonëse objekti ka një sipërfaqe totale ndërtimi 1225 m², kategoria e lejes së ndërtimit në të cilën është aplikuar është tek ndërtimet deri në 250 m², duke ngarkuar në sistem vetëm një pjesë të dokumentacione të nevojshme për leje mbi 250 m². Leja e dytë e ndërtimit për të njëjtin objekt "Ndërtim Lokal shërbimi 1 kt + ndërtim fushe futbollit" është miratuar me datë 08/04/2020, me Nr. 1044/1 prot., por me ndryshimin e të dhënave të sipërfaqes së ndërtimit (1165.2 m²) dhe të gjurmës së planvedosjes. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të objekteve dhe të fushës së futbollit është një sipërfaqe që tejkalon 250 m² ndërtim. Për këtë arsye, kategoria e aplikimit për leje ndërtimi duhet të jetë mbi 250 m², duke plotësuar edhe dokumentacionin e mëposhtëm të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit, të tilla si: projektet e instalimeve, polica e sigurimit për mbulimin e përgjegjësisë profesionale, si dhe mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi në kategorinë e ndryshme të lejes së ndërtimit, ndikon në mosplotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që nevojitet për të miratuar lejen e ndërtimit dhe ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me legjislacionin në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendjen e duhur aplikimin e lejeve të ndërtimit në mënyrë që mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatua 1 praktikë në të cilën u evidentua mungesa e pajisjes me "Certifikatë përdorimi" të objektit pasi ishte në përdorim.

Titulli i Gjetjes:Mungesa e pajisjes me "Certifikatë përdorimi" të objektit me leje ndërtimi në përdorim.

Situata:Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatua mungesën e pajisjes me "Certifikatë përdorimi" të objektit pasi ishte në përdorim. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura me objekt: 1“Ndërtim Lokal Shërbimi 1kat + Ndërtim Fushë futbollit” me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr. 1307/1, datë 22/04/2022, Nr.3933/1, me datë 19/12/2018; Nr. 3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr. 1044/1 prot., datë 08/04/2020. Nga verifikimi në terren i objekteve evidentohet që punimet kanë përfunduar dhe janë në përdorim. Për realizimin e punimeve të lejeve të mësipërme nuk janë mbajtur aktet e piketimit dhe aktet e kontrollit. Pjesë e ndërtimit në të njëjtën parcelë është ndërtuar edhe objekti: "Objekt shërbimi dhoma zhveshje", për të cilën është marrë vendimi Nr. 2123/1, datë 07/07/2021, me zhvillues dhe aplikues R.Z dhe E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, që është pajisur me certifikatë përdorimi.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 50, përcaktohet se: "Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësisë, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve,parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit."

Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 52, pika g, përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit.

VKM-në 408, datë 13.5.2015,“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit,nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi

Ndikimi/Efekti:Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, ndikon në verifikimin e përputhshmërisë së objektit me lejen e ndërtimit të miratuar, mungesën e akteve të kontrollit të objektit gjatë punimeve të ndërtimit, duke ndikuar konformitetin e realizimit të punimeve, në sigurinë dhe në qëndrueshmërinë e objektit.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Kuçovë të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejohet përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z .K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan 2 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara.

Titulli i gjetjes: Miratimi i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar dhe zbatimin e punimeve në terren.

Situata: Nga auditimi i procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura me objekt: 1. "Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1854/1, datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë. Objekti është pajisur me certifikatë përdorimi me Nr.1911/1, datë 16.08.2022. Duke u bazuar në VKM-në 408, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi, sipas pikës j, fotografi të objektit në të gjitha orientimet, të cilat mungojnë në dosjet e dorëzuara të aplikimit në sistem e-leje. Nga verifikimet në terren fasada e objektit të realizuar nuk përputhet me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit. Gjithashtu lartësia e strukturës në raport me projektin, në terren evidentohet më e lartë. Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor.

2. "Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Objekti është pajisur me certifikatë përdorimi me Nr.3379/1, datë 15.11.2022. Duke u bazuar në VKM-në 408, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi, sipas pikës j, fotografi të objektit në të gjitha orientimet, të cilat mungojnë në dosjet e dorëzuara të aplikimit në sistem e-leje. Nga verifikimet në terren fasada e objektit të realizuar nuk përputhet me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit. Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Neni 42/ Certifikata e përdorimit, përcaktohet si më poshtë:

Pika 3, Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Pika 4. Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.

Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Neni 29, pika c, dhënien e certifikatës së përdorimit, sipas nenit 42 të këtij ligji

Duke u bazuar VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi.

Duke u bazuar VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, në të cilën përcaktohet se: "Autoriteti vendor mund të verifikojë konformitetin e akteve të kontrollit sipas shkronjave “a”, “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, sipas gjendjes faktike të objektit, brenda 15 ditëve pune nga depozitimi i tyre. Në mungesë verifikimi nga autoriteti vendor, brenda afatit të mësipërm, subjekti ndërtues mund të kalojë në fazën vijuese. Në rast se konstatohet

mospërputhje e faktit me aktkontrollat e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle."

Ndikimi/Efekti:Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në bazë të rregullores dhe sipas legjislacionit në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi:Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Kuçovë të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.Z.K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. F.P, me detyrë Drejtor ne Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik, nga data 20.10.2015 e ne vazhdim; 3.Z.G.B, me detyrë Specialist i Planifikimit te Territorit, nga data 15.05.2018 - 14.02.2023.

Gjatë auditimit të zhvillimeve të ndërtimit, u konstatuan 1 praktikë e cila nuk ishte pajisur me deklaratë paraprake punimesh.

Titulli i gjetjes:Zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me deklaratë paraprake punimesh.

Situata:Nga verifikimi në terren i objekteve të zhvilluara në hapësirat publike për të cilat janë lidhur kontrata për dhënie në përdorim të tokës, u konstatua si më poshtë: Në vijim të kontratës për dhënie në përdorim të hapësirave publike, lidhur më datë 29.10.2020, ndërmjet Kryetarit të Bashkisë dhe Z.TT, janë zhvilluar punime ndërtimi, përkatësisht një volum i mbyllur në shërbim të barit, me kontruksion metalik e mbyllur me xham, me strehë dhe pedanë druri, pa aplikuar për deklaratë paraprake punimesh.Në datën 26.03.2021, nga inspektimet e zhvilluara në terren nga Policia Bashkiake dhe inspektori i IVMT-së Kuçovë, u konstatuan zhvillimi i punimeve të ndërtimit me konstruksion metalik në hapësirë publike, në bazë të ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997,"Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake e të Komunës, neni 8, pika 6. Me anë të një shkrese drejtuar Z.TT dhe për dijeni IMT-së, Nr.1201/1, datë 06.04.2021, rasti u shyrta nga specialistët e Drejtorisë, duke ju referuar VKM-së 408 dhe Ligjit 107, në zbatim të Nenit 6,"Vendosja e tendave të diellit dhe rjetave kundër mushkonjave","riparim dhe rinovim i dyshemesë" janë punime që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi. Objekti i shërbimit është ndërtuar me konstruksion metalik të çmontueshëm dhe me tendë. Duke u bazuar VKM-në 408, Neni 7, për vijimin e punimeve nevojitet të aplikohet për deklaratë paraprake të punimeve.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Duke u bazuar VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 7, punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh, pika (iii) përcaktohen si më poshtë:

-struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, murature e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 6-mujor;

-vendosja e tendave të diellit dhe pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit dhe rregulloren arkitektonike të qytetit;

Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 51, Inspektimi, pika 3, përcaktohet se: Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve,

edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësi, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

Ndikimi/Efekti:Zhvillimi në terren i punimeve të ndërtimit pa u pajisur me deklaratë paraprake punimesh, ndikon zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në bazë të rregullores dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e DPZHT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi:Nga ana e Bashkisë Kuçovë dhe strukturave përkatëse të merren masa për të verifikuar zhvillimin e ndërtimeve në terren, në mënyrë që të mos lejohen zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me deklaratë paraprake punimesh.

III.2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)³⁶.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me Nr. 119/1 Prot., datë 31.01.2023, i ndryshuar, Nr.119/2, datë 07.03.2023 me objekt: “**Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IVMT), prej datës 01.07.2019 deri më 31.12.2022**, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-*Auditim mbi plotësimi i kriterëve arsimore për punonjësit e IMT, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” etj.*

- *Auditim mbi vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.*

- *Auditim mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT.*

- *Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (neni 81-Inspektimi, pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, etj.).*

1.Në lidhje me plotësimin e kriterëve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” janë konstatuar: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kuçovë, janë 4 punonjës në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten pozicionet e punës dhe arsimit përkatës i kryeinspektorit dhe inspektorëve.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Data e fillimit
1	A.D	Kryeinspektor i IVMT-së	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me titull mësues për lëndët matematikë-fizikë	12.11.2007 e në vazhdim
2	R.B	Inspektor i IVMT-së	Shkolla e Mesme me shkëputje nga puna në degën e ndërtimit	26.11.2007 e në vazhdim
3	J.L	Inspektor	Fakulteti i inxhinierisë së ndërtimit me shkëputje nga puna, profili strukturist (Pa përfunduar studimet)	01.01.2018 e në vazhdim
4	AD	Inspektor (Jurist)	Fakulteti i Drejtësisë Me diplomë Master i Shkencave në Drejtësi	16.03.2021 e në vazhdim

Auditim mbi plotësimi i kriterëve arsimore për punonjësit e IMT, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme”, u konstatuan 3 punonjës të cilët nuk plotësonin kriteret e nevojshme për emërim.

Titulli i gjetjes: Mosplotësimi i kriterëve arsimore i punonjësve të IVMT-së.

Situata:Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kuçovë, nga 4 punonjës të inspektoratit të mbrojtjes së territorit, 3 punonjës nuk e plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë, si më poshtë:1.Z.A.D, me pozicion kryeinspektor, ka përfunduar

³⁶ Observacionet e bëra për sa është trajtuar në këtë çështje, janë të pasqyruara në Kapitullin “Aneksë – Aneksi nr.8”, në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me titull mësues për lëndët matematikë-fizikë; 2.Z.R.B, me pozicion inspektori ka studiuar në shkollën e mesme me shkëputje nga puna në degën e ndërtimit; 3.Z.J.L, me pozicion inspektor ka studiuar me shkëputje nga puna në degën e ndërtimit në fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit; Kryeinspektori nuk ka profilin e duhur arsimor për pozicionin e punës, ndërsa dy inspektorët e tjerë nuk kanë përfunduar arsimin e lartë.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Ligji Nr.183/2014 datë 24.12.2014,nenin 11,të arsimimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit përcaktohet se:

"Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit"

Ndikimi/Efekti:Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e Bashkisë Kuçovë

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:Nga Bashkisë Kuçovë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më lart, për emërimin e punonjësve në kualifikimin e duhur mban përgjegjësi Z. K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë;

2. Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT; Në raport me vendimet e marra nga IVMT për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT janë pasqyruar në tabelën në kapitullin "Anekse-Aneksi nr.8" të Raportit të Auditimit.

Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT,për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara, Inspektoriatin i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kuçovë, gjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, ka marrë 21 vendime për "Dënim me gjobë", ndër të cilat 6 janë likujduar ndërsa 15 nuk janë arkëtuar pasi janë në proces gjyqësor, me një vlerë të debisë për 2 vite, 3,450,000 Lekë.

Titulli i gjetjes:Moslikujdimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kuçovë

Situata:Inspektoriatin i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kuçovë, gjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, ka marrë 21 vendime për "Dënim me gjobë", ndër të cilat 6 janë likujduar ndërsa 15 nuk janë arkëtuar pasi janë në proces gjyqësor, me një vlerë të debisë për 1 vit 3,450,000 Lekë.

Kriteri:Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Ligji Nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar, neni 5.

Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Neni 9/Neni 22.

Ndikimi/Efekti:Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kuçovë nga mos pagesa e gjobave të vendosura nga IMTV.

Shkaku:Mos zbatim i legjislacionit nga IVMT për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 3,450,000 Lekë.

Rekomandimi: Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

Për sa më lart, për zbatimet e punimeve të ndërtimit të trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: 1. Z. K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. A.D, me pozicion Kryeinspektori IVMT-së Kuçovë, nga periudha 12.11.2007 e në vijim;

3.Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të lejeve të ndërtimit u evidentuan rastet e mëposhtme:

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi
1.	Certifikatë përdorimi	Objekt shërbimi dhoma zhveshje	R.Z dhe E.D	Nr. 2123/1, datë 07/07/2021
2.	Certifikatë përdorimi	Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat	EB	Nr.1420/1, datë 10/05/2021
3.	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me deri në 250 m ²	“Objekt për grumbullimin, ruajtjen dhe perpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale”	AQ	Nr. 1307/1, datë 22/04/2022
4.	Ndërtim me konstruksion metalik pa marrë deklaratë paraprake punimesh			

Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimin në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Mospërputhja ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimin në terren.

Situata: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara u konstatuan rritja e numrit të kateve të objekteve, shtim volumesh anësore dhe ndryshime destinacioni nga tipologjia e ndërtimit të miratuar. Me ndryshimet e evidentuara gjatë realizimit të punimeve në terrën, ndërimet nuk zbatojnë lejet e ndërtimit të miratuara dhe nuk respektojnë kondicionet urbane të lejuara në njësinë përkatëse sipas rregullores së planifikimit të territorit në fuqi.

1.“Ndërtim lokal shërbimi 1 kat + ndërtim fushë futbollit”, të miratuar me vendimet Nr. me lejet e ndërtimit me Nr.3933/1, me datë 19/12/2018; Nr. 3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr.1044/1 prot., datë 08/04/2020, me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë. Nga evidentimi i planvendosjes në foton ajrore dhe verifikimet e zhvilluara në terren, konstatohet ndryshimi i gjurmës së ndërtimit dhe shtim volume. Për realizimin e punimeve të lejeve të mësipërme nuk janë mbajtur aktet e piketimit dhe aktet e kontrollit. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Kuçovë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

2.“Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat”, të miratuar me vendimin Nr. 1420/1, datë 10/05/2021, me zhvillues dhe aplikues E. B., në fshatin Kozare, Kuçovë. Nga evidentimi i planvendosjes në foton ajrore dhe verifikimet e zhvilluara në terren, konstatohet ndryshimi i gjurmës së ndërtimit dhe shtim volume. Leja e ndërtimit është marrë për një objekt në lartësinë e dy kateve, ndërsa realizimi është bërë në lartësinë e 3 kateve. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Kuçovë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

3.“Objekt për grumbullimin, ruajtjen dhe perpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale”, të miratuar me vendimin Nr.1307/1, datë 22/04/2022, me zhvillues AQ, Sheqez - Lumas, Kuçovë. Nga verifikimi në terren evidentohet që realizimi i objektit nuk përputhet me projektin arkitektonik të miratuar në lejen e ndërtimit. Trajtimi i fasadave është i ndryshëm

nga projekti i miratuar. Gjithashtu konfigurimi i gjurmës ndryshon, pasi ka një stehë me konstruksion metalik, të integruar si pjesë e volumit. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Kuçovë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

Kriteri: Ligji Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 51, Inspektimi:

1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme:

a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

b) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, neni 12, ushtrimi i kontrollit:

Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

Ndikimi/Efekt: Zbatimi i realizimit të punimeve të ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e

Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

Për sa më lart, për zbatimet e punimeve të ndërtimit të trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: 1. Z. K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. A.D, me pozicion Kryeinspektori IVMT-së Kuçovë, nga periudha 12.11.2007 e në vijim; 3. Z. R.B, me pozicion inspektor i IVMT-së Kuçovë, nga data 26.11.2007 e në vijim; 4.Z. J.L, me pozicion inspektor i IVMT-së, nga data 01.01.2018 e në vazhdim.

Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me përdorimin e objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi dhe ndryshimi i destinacionit të përdorimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit të miratuar.

Titulli i gjetjes: Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi dhe ndryshimi i destinacionit të përdorimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit të miratuar.

Situata: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara u konstatuan rritja e numrit të kateve të objekteve, shtim volumesh anësore dhe ndryshime destinacioni nga tipologjia e ndërtimit të miratuar. Me ndryshimet e evidentuara gjatë realizimit të punimeve në terren, ndërimit nuk zbatohet lejet e ndërtimit të miratuara dhe nuk respektojnë kondicionet urbane të lejuara në njësinë përkatëse sipas rregullores së planifikimit të territorit në fuqi.

1. "Ndërtim Lokal Shërbimi 1kat + Ndërtim Fushë futbollit" me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr. 1307/1, datë 22/04/2022, Nr.3933/1, me datë 19/12/2018; Nr. 3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr. 1044/1 prot., datë 08/04/2020. Nga verifikimi në terren i objektit evidentohet që punimet kanë përfunduar dhe është në përdorim. Pjesë e ndërtimit në të njëjtën parcelë është ndërtuar edhe objekti: "Objekt shërbimi dhoma zhveshje", për të cilën është marrë vendimi Nr. 2123/1, datë 07/07/2021, me zhvillues dhe aplikues R.Z dhe E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën është marrë certifikatë përdorimi. Në planvendosjen e paraqitur në lejen e ndërtimit të objektit: "Objekt shërbimi dhoma zhveshje", gjurma e ndërtimeve të tjera nuk përkon me gjendjen ekzistuese. Gjithashtu tipologjia e ndërtimit nuk përkon me systemin bujqësor dhe banim të lejuar në njësinë 4/99.

2. "Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat", të miratuar me vendimin Nr. 1420/1, datë 10/05/2021, me zhvillues dhe aplikues EB, në fshatin Kozare, Kuçovë. Objekti është pajisur me certifikatë përdorimi me Nr. 1420/1, datë 10.02.21, duke mos qenë në përputhje me parametrat e përcaktuara në planin e detajuar vendor dhe me Vendimin Nr.283. Nga verifikimi i realizimit në terren të objektit, në të cilin evidentohet që tipologjia dhe përdorimi nuk është në funksion të objektit bujqësor. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Kuçovë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

Kriteri: Në bazë Ligjit Nr. 107/2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Neni 50, përcaktohet se:

"Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësi, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të

dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit."

Ligji Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 51, Inspektimi:

1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 52, pika f, përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme:

a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

b) vendos gjopa sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", neni 12, ushtrimi i kontrollit:

Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

Ndikimi/Efekti: Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi ndikon në mungesën e konformitetit të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar, në mungesën e certifikimit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë, si edhe në ndryshimin e tipologjisë së ndërtimit/

ose ndryshimit të funksionit të përdorimit, me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë, në kundërshtim me planifikimin e territorit për njësinë përkatëse.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Për sa më lart, për zbatimet e punimeve të ndërtimit të trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: 1. Z. K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2. Z. A.D, me pozicion Kryeinspektori IVMT-së Kuçovë, nga periudha 12.11.2007 e në vijim; 3. Z. R.B, me pozicion inspektor i IVMT-së Kuçovë, nga data 26.11.2007 e në vijim; 4. Z. J.L, me pozicion inspektor i IVMT-së, nga data 01.01.2018 e në vazhdim.

Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan 2 praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

Titulli i gjetjes: Zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

Situata: Nga verifikimi në terren i objekteve të zhvilluara në hapësirat publike për të cilat janë lidhur kontrata për dhënie në përdorim të tokës, u konstatua si më poshtë: 1. Në vijim të kontratës për dhënie në përdorim të hapësirave publike, lidhur më datë 29.10.2020, ndërmjet Kryetarit të Bashkisë dhe Z. Th.T, janë zhvilluar punime ndërtimi, përkatësisht një volum i mbyllur në shërbim të barit, me kontruksion metalik e mbyllur me xham, me strehë dhe pedanë druri, pa aplikuar për deklaratë paraprake punimesh. Në datën 26.03.2021, nga inspektimet e zhvilluara në terren nga Policia Bashkiake dhe inspektori i IVMT-së Kuçovë, u konstatuan zhvillimi i punimeve të ndërtimit me konstruksion metalik në hapësirë publike, në bazë të ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake e të Komunës, neni 8, pika 6. Me anë të një shkrese drejtuar Z. Th.T dhe për dijeni IMT-së, Nr. 1201/1, datë 06.04.2021, rasti u shlyt nga specialistët e Drejtorisë, duke ju referuar VKM-së 408 dhe Ligjit 107, në zbatim të Nenit 6, "Vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave", "riparim dhe rinovim i dyshemesë" janë punime që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi.

Objekti i shërbimit është ndërtuar me konstruksion metalik të çmontueshëm dhe me tendë. Duke u bazuar VKM-në 408, Neni 7, për vijimin e punimeve nevojitej të aplikohet për deklaratë paraprake të punimeve.

2. "Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat", të miratuar me vendimin Nr. 1420/1, datë 10/05/2021, me zhvillues dhe aplikues EB, në fshatin Kozare, Kuçovë. Nga evidentimi i planvendosjes në foton ajrore dhe verifikimet e zhvilluara në terren, konstatohet ndryshimi i gjurmës së ndërtimit dhe shtim volume. Në krah të objektit që është pajisur me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi, është realizuar një objekt i hapur, me kolona dhe çati, për të cilën nuk është marrë leje ndërtimi, duke u bazuar në me gjurmën në planvendosje. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Kuçovë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

Kriteri: Duke u bazuar VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 7, punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh, pika (iii) përcaktohen si më poshtë:

-struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, murature e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 6-mujor;

-vendosja e tendave të diellit dhe pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit dhe rregulloren arkitektonike të qytetit; Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 50, përcaktohet se: "Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësisë, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit."

Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 51, Inspektimi:

1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës:

Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", neni 12, ushtrimi i kontrollit.

Ndikimi/Efekti: Ndërtimi i objekteve pa u pajisur me leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kondicioneve urbane, në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Kuçovë

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprejten e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Për sa më lart, për zbatimet e punimeve të ndërtimit të trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: 1. Z. K.H, me detyrë Kryetari i Bashkisë Kuçovë; 2.Z. A.D, me pozicion Kryeinspektor i IVMT-së Kuçovë, nga periudha 12.11.2007 e në vijim; 3. Z. R.B, me pozicion inspektor i IVMT-së Kuçovë, nga data 26.11.2007 e në vijim; 4.Z. J.L, me pozicion inspektor i IVMT-së, nga data 01.01.2018 e në vazhdim.

III.2.7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Me shkresën nr.2578/1 prot., datë 17.06.2022 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Kuçovë ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit nr.3065 prot., datë 17.06.2022, për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

2. Bashkia Kuçovë nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-mujsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

Për sa më lart në Bashkinë Kuçovë, nga grupi i auditimit u mbajt akt-verifikimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Kuçovë:

Nga KLSH janë lënë gjithsej **22** rekomandime, të grupuara në:

- **18** masa organizative;
- **3** masa për eliminimin e efekteve negative lidhur me eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike;
- **1** masë disiplinore;

-Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, përgjegjësi i sektorit të Auditit të Brendshëm për djeni të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë ka nxjerrë shkresën me nr. 238 prot., datë 23.01.2023, i cili i është drejtuar Drejtorisë së Financës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Zhvillimit Rural, IMT-së, Shërbimet Publike dhe Transportit, të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë Juridike, ku secila drejtori të dërgojë raport progresin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, sipas çështjeve të strukturuar në plan veprimin me nr. 1354/17 datë 19.08.2022.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 3 janë zbatuar, 1 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 11 nuk janë zbatuar.

Pra janë zbatuar **16 %** e masave organizative dhe **61 %** nuk janë zbatuar.

- Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë **3** rekomandime në vlerën 111,674 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, 3 masat janë në proces zbatimi.

- **1** masë disiplinore, e cila nuk është zbatuar;

Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit. Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Deri më 31.10.2022

1.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme, duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, si dhe të hartohet program për trajnimin dhe për ngritjen profesionale të stafit.

Deri më 31.10.2022

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se nuk janë marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, si dhe nuk janë marrë masa për përditësimin e rregullorjes së brendshme.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar.**

Zbatimi: Rekomandimi 1.2 **nuk është zbatuar.**

2.2. Rekomandim: Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e kartës së auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë e të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit të AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Kuçovë

Deri më 31.10.2022

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për aktivitetin e NJAB Kuçovë, rezulton se struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është plotësuar minimalisht me 3 punonjës, si dhe karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Plani vjetor nuk është hartuar dhe miratuar për vitin 2022, si dhe nuk janë planifikuar sektorë me fusha me risk të lartë.

Zbatimi: Rekomandimi 2.2 **është zbatuar pjesërisht.**

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit përgjatë vitit 2022, rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2022).

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 **nuk është zbatuar.**

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për raportimin në MFE për të gjitha detyrimet e prapambetura, pavarësisht burimit të tyre të financimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2022).

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 **nuk është zbatuar.**

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është zbatuar, pasi nuk rezulton që gjatë vitit 2022, llogaria të ketë pësuar pakësime, si rrjedhojë e kontabilizimit të projekteve në vlerën totale të investimit.

Zbatimi: Rekomandimi 7.1 **nuk është zbatuar.**

8.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) “Aktive afatgjata materiale” e llog. (109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Gjithashtu të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Deri më 31.10.2022

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk rezulton të jetë kryer rivlerësim i AQT të Bashkisë.

Zbatimi: Rekomandimi 8.1 **nuk është zbatuar.**

9.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në “Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA dhe 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport “N” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitale të veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar, pasi llogaria 26 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 **nuk është zbatuar.**

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Kuçovë me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

Gjithashtu DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa për përditësimin e të dhënave me dokumentacionin e nevojshëm, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

Deri më 31.10.2022

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Për zbatimin e rekomandimit të mësipërm nuk na është vendosur në dispozicion dokumentacioni, për vërtetimin e zbatimit të tij.

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 **nuk është zbatuar.**

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se planifikimi i të ardhurave për vitin 2023, mbështetet në bazën e të dhënave të krijuara gjatë vitit lidhur me taksat dhe tarifatat vendore dhe duke u bazuar në realizimin e të ardhurave të vitit paraardhës. Konkretisht plani i të ardhurave për vitin 2022 është 208,975,000 leke dhe realizimi është 203,653,468 lekë, me realizimin 97.5% dhe me diferencën në vlerë absolute 5,321,532 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 12.1 **është zbatuar pjesërisht.**

14.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, me shkresat nr. 98/17 datë. 14.09.2021 dhe shkresat nr. 678/35 datë. 05.08.2021, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të hartojë plan pune të veçantë për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për 11 masa organizative, konkretisht sipas shkresës nr. 98/17 datë. 14.09.2021 rekomandimet nr. (1,2,3,4,11,12 dhe 13) dhe sipas shkresës nr. 678/35 datë. 05.08.2021 rekomandimet nr. (2,3,4 dhe 7);

b-Për 6 masa shpërbllim dëmi në vlerën 1,272 mijë lekë, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Për një masë në vlerën 358,448 mijë lekë për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-^{ve}, si dhe 1 masë në vlerën 13,527 mijë lekë të ardhura të munguara.

Menjëherë

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Për zbatimin e rekomandimit të mësipërm nuk na është vendosur në dispozicion dokumentacioni, për vërtetimin e zbatimit të tij.

Zbatimi: Rekomandimi 14.1 **nuk është zbatuar.**

15.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallit të ofruar nga operatorët ekonomik të shpallur fitues, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të verifikojë nëse malli plotëson ose jo të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në ftesën për ofertë dhe këtë verifikim ta paraqes imtësisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim. Në rastet kur malli nuk i plotëson të gjitha specifikimet e kërkuara, të përcaktohet në procesverbal se cilat janë ato specifikime.

15.2. Rekomandim: Në rastet e ngritjes së komisioneve për shqyrtim të ankesës të bërë nga operatorët ekonomik, të merren masa që komisioni të verifikojë saktë pretendimet e ankimesit, jo duke u mbështetur në konkluzionet e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, por në verifikimin faktik të mallit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël).

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 **nuk është zbatuar.**

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 **nuk është zbatuar.**

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kuçovë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse. Bazuar në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kuçovë** fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Për zbatimin e rekomandimit të mësipërm nuk na është vendosur në dispozicion dokumentacioni, për vërtetimin e zbatimit të tij.

Zbatimi: Rekomandimi **nuk është zbatuar.**

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi z. K.H, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, znj. H.SH, Drejtore e Financës, z.A.C, Përgjegjës i Auditit të Brendshëm.

Kriteri: Ligji nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronja “j”. Shkresa nr.683/26 prot, datë

23.05.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Shkaku: Mosmarrje e masave për vënien në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar në aktivitetin e Bashkisë Kuçovë, ku mangësi të konstatuara në auditimin e mëparshëm vazhdojnë të përsëriten.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e rekomandimeve ende të pa zbatuara/zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimin e procedurave për rekomandimet në proces zbatimi.

II.2.8. Të ndryshme të dalë gjatë auditimit.

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të tij, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Për vitin 2022 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë, sepse kjo rregullore është hartuar në vitin 2017 dhe pas kësaj periudhe janë krijuar struktura të reja, detyrat e të cilave nuk përfshihen në rregullore. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në Bashkinë Kuçovë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Për vitin 2022 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Kuçovë.
- Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësitë e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

1.3.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të ngrejë grup pune për kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune dhe përshtatjen e rregulloreve me ndryshimet e ndodhura në strukturën e bashkisë.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Kuçovë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kuçovë përgjatë vitit 2022, u konstatua se:

- Nuk është hartuar plani vjetor i auditimit të brendshëm për vitin 2022.
- Përgjegjësi i sektorit dhe specialisti i auditit të brendshëm kanë qenë të pa çertifikuar;
- Nuk është kryer auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike, nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar;
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njesisë vendore;
- Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme;
- Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;
- Nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kuçovë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, prokurimet publike.
- Për vitin 2022 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 6 auditime dhe janë kryer 3 gjithësej.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 18-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

- Çertifikimin e audituesve të NJAB;
- Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kuçovë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njesisë vendore në arritjen e objektivave institucionale.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

- Nuk janë marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;
- Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

-Nuk dokumentohet plotësisht procesi i përgatitjes, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kuçovë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Gjithashtu tavanet përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Kuçovë.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kuçovë.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 91%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kuçovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se në fund të vitit 2022 rezultojnë të pa likuiduara gjithsej 23 fatura tatimore (investime, mallra dhe shërbime) për vlerën 179,208,871³⁷ lekë. Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kavajë ndaj palëve të treta raportuar në MFE, përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore dhe shpenzime korrente, shpenzime kapitale në vlerën 38,540,547 lekë. Nga përlllogaritjet e

³⁷ Analitikisht pasqyruar në kapitullin Anekse-Aneksi nr.2 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2022, që duhej të raportohet në MFE duhet të ishte në vlerën 39,566,837 lekë, pra vlera prej 1,026,290 lekë nuk është raportuar si detyrim i prapambetur. Drejtoria Financës në raportin e shkallës së vështirësisë financiare, nuk ka përfshirë vlerën e detyrimeve të vendimeve gjyqësore.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky detyrim në 4 raste.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Pikat 8, 106 dhe 107 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Në vijimësi

5.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 11 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 3, shkronjën “a” të pikës 3 në nenin 36, pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 79, nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 dhe pikën 4, shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 6 të nenit 39, pikën 2 të nenit 40, pikën 2 të nenit 41, pikat 1 dhe 2 të nenit 44, pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Në procedurat e prokurimit për vitin 2023 dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 6 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke sjellë në total lidhjen e 6 kontratave me vlerë 436,874 mijë lekë pa TVSH, me OE të cilët janë shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin

e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës “Rikonstruksion i shkollave 9 vjeçare “Shaban Plaku” dhe Kopështi Fshati Tapi, si dhe “Rustem Patriku” Fshati Vodëz”, Drejtoria e Planifikimit/Zhvillimit të Territorit Koordinimit – Zhvillimit Strategjik pranë Bashkisë Kuçovë me shkresë nr. 1491/1 prot., datë 10.05.2021, drejtuar Kontraktorit “A” SHPK dhe Mbikëqyrësit të punimeve “D” SHPK, ka paraqitur kërkesën e Zyrës Arsimore Kuçovë, Shkollës 9 – vjeçare “Veis Rustem Patriku”, Vodëz, mbi disa problematika të evidentuara pas përfundimit të punimeve.

Po ashtu, kjo drejtori me shkresë nr. 424 prot., datë 08.02.2022, drejtuar kontraktorit “A”, ka përsëritur kërkesën për ndërhyrje për zgjidhjen e problematikave të trajtuara duke lënë një afat 30 ditor. Problematikat si më sipër, janë përcjellë edhe me shkresë nr. 505 prot., datë 08.02.2023, duke paraqitur edhe raste konkrete të mos përmbushjes së kontratës dhe konkretisht: Mungojnë portat e volejbollit e basketbollit, tualetet janë pa përfunduar, janë dëmtuar pajisjet hidrosanitare nuk janë përfunduar pusetat në oborrin e shkollës, në sistemin elektrik mungojnë priza dhe çelësa si dhe sistemi i ngrohjes (kaldaja qendrore) ka problematika të ndryshme dhe nuk funksionon.

Në këtë shkresë theksohet se në rast të mos plotësimit të këtyre problematikave të evidentuara, nuk do të hartohet certifikata e përkohshme dhe nuk do të likuidohet asnjë pagesë. Shkresat e mësipërme janë konceptuar dhe miratuar nga z. F.P dhe z. GB. Pavarësisht përgjegjësisë së mbikëqyrësit të punimeve për mos ndjekjen e kontratës sipas parashikimeve ligjore, nga ana e punonjësve të mësipërm duhet të bëheshin njoftimet përkatëse për penalitete sipas kontratës, duke njoftuar dhe Agjencinë e Prokurimit Publik. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit riparimin e defekteve dhe mangësive të konstatuara.

Brenda 3 mujorit të tretë të vitit 2023

9.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve në shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi, sipas zërit 2.25 “F.V Kaldaje çeliku e presuar Q = 180 kv” rezulton se kaldaja e furnizuar nuk është sipas specifikimeve teknike, pasi është parashikuar me lëndë djegësi naftë, ndërkohë që ajo e furnizuar është me lëndë djegëse pëllet. Pavarësisht mangësisë së mësipërme kaldaja nuk është funksionale. Vlera e certifikuar për kaldajën (pa përfshirë sistemin e ngrohjes radiatorë, tubacione aksesorë) është 1,023,709 lekë. Pavarësisht shpenzimeve të realizuara, nuk arrihet ngrohja e ambienteve të shkollës, duke cenuar procesin mësimor në periudha me temperatura të ulëta. Veprim në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të ngrejë një komision me përbërje të specialistëve të fushës, për përcaktimin e devijimeve në furnizimin e vendosjen e kaldajës në Shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi. Të trajtohen mundësitë e funksionimit me lëndë djegëse pellet, megjithëse kaldaja ishte parashikuar të funksiononte me naftë dhe të bëhet rivlerësimi i çmimit si pasojë e ndryshimit të teknologjisë.

Brenda 3 mujorit të tretë të vitit 2023

10.Gjetje nga auditimi: Në dosjen teknike sipas kontratës “Devijimi i Përroit Gegë”, nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit të projektit, nga vendosja e tombinove nëpërmjet hapjes së një tuneli, në gërmimin e trupit të rrugës për vendosjen e tombinos, më pas realizimin e shtresave të rrugës.

Ndryshimi i projektit nuk ka rezultuar me ndryshim të vlerës së kontratës, por eliminimi i punimeve të tunelit është shoqëruar me rritje shumë të madhe të volumit të gërmimeve, i cili nga 9750 m³ të parashikuar, është raportuar i realizuar në sasinë 36177 m³.

Për një gjatësi të konsiderueshme të kanalit, është ndryshuar gjurma nga ku do të ndërtohej. Në gjurmën e ndërtuar, kanali përshkon toka bujqësore me formacion shumë të dobët dhe në pjesën më të madhe argjilor. Në pjesën e pjerrët janë ndërtuar kaskada për uljen e shpejtësisë së ujit, por në pjesën tjetër jo. Kalimi i ujit, sidomos në raste të prurjeve të mëdha përbën rrezik për dëmtimin e brigjeve të kanalit dhe të tokave bujqësore anash tij. Mos parashikimi i masave mbrojtëse, do të kërkojë investime të konsiderueshme për veshje të kanalit me material betoni. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Pika 9. b, 9.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për parashikimin në planin e investimeve të masave mbrojtëse për skarpatat e kanalit të devijimit të përroit Gegë, me qëllim minimizimin e dëmeve dhe rritjen e kostos për ndërhyrje, si pasojë e dëmëve që mund të shkaktohen nga vërshimi i ujit, në raste të prurjeve të mëdha.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës “Rikualifikim urban i Lagjes “Llukan Prifti” është bërë azhurnimi i punimeve nga ku kanë rezultuar shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar aktet përkatëse. Në dosjen teknike të objektit ndodhet procesverbali i datës 16.06.2021, i cili nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit z. F.P dhe Kryetari i Bashkisë z. K.H. Ndër ndryshimet e bëra është mos vendosja e guardrails, si një element i domosdoshëm për sigurinë rrugore. Në dosjen teknike nuk paraqitet dokumentacion mbi argumentimin (miratimin) e ndryshimit. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t’i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës “Rikualifikim urban i Lagjes “Llukan Prifti” është bërë azhurnimi i punimeve nga ku kanë rezultuar shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar aktet përkatëse. Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt, u konstatua se, sipas zërit III.8 “F.V puseta plastike 40 cm x 40 cm”, janë të dëmtuara dhe pa kapakë, dëmtime të cilat dukshëm rezultojnë se janë bërë pas ndërtimit të tyre. Për këtë nga AK nuk janë marrë masa për eliminimin e dëmtimeve, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, e, f. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t’i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

12.2.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë t’i kërkojë kontraktorit riparimin dhe pajisjen me kapakë të pusetave plastike, duke qenë se punimet janë në periudhën e riparimit të defekteve. Të merren masa për njoftimin e organeve kompetente për identifikimin e dëmtuesve dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme të infrastrukturës.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, u konstatua se në:

- Në 3 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;

- Në 7 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përlogaritur fondin limit;
- Në 1 rast nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit;
- Në 1 rast nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim i punimeve të objektit të prokuruar;
- Në 1 rast autoriteti kontraktor ka kërkuar vlerat e treguesve të analizuar, por nuk ka kërkuar që operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë raport analizë nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor;
- Në 7 raste nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore, ky kriter garanton AK që OE ofertues në një procedurë prokurimi publik nuk është i dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1 të nenit 76 të LPP-së;
- Në 7 raste nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar deklaratë mbi konfliktin e interesit, ky kriter garanton autoritetin kontraktor që OE ofertues nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit mbështetur në nenin 27 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021;
- Në 3 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, nuk administrohet asnjë dokument që të vërtetojë specifikimet e kërkuara nga AK;
- Në 5 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 5 raste rezulton se dokumentacioni i dorëzuar nga OE nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 3 raste rezulton se afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk janë përlogaritur penalitet;
- Në 1 rast nuk dokumentohet procesverbali për tërheqjen e OE shpallur fitues dhe për kalimin tek OE i radhës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 në nenin 16, nenin 19, pikën 1 në nenin 27, nenin 31, pika 3 paragrafi 1 në nenin 40, pika 3 në nenin 57, nenin 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; Pikën 5 dhe 16 në Udhëzimin nr. 3 datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, si dhe nenin 32 në ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar; Shkronjat "dh", "e" dhe "ë" të pikës 2 në nenin 26, pikën 1 të nenit 27, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74, nenin 76, nenin 77 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar; Pikën 7, 8 dhe 17 në udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"; Pika 5 dhe pika 6 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 "Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1.Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriteve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën pasqyrohej situata, në lidhje me mospërputhshmerinë e tipit të konstruksionit të lejuar në tokat bujqësore, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumeshti dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"; me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm

Vendor të Bashkisë Kuçovë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet që nuk janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën pasqyrohej situata për ndërtimin e rrugëve të shërbimit në tokat bujqësore në mospërputhje me rregulloren e planit të përgjithshëm të territorit dhe legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumështi dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"; me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 29.12.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga infrastruktura.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek të cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura sipas Vendimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumështi dhe ambiente ndihmëse ", për të cilën është marrë vendimi Nr. 733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Vendimin Nr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të verifikuar lartësitë e lejuara të strukturës së ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe kriteret e përcaktura.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt:1."Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr.1854/1, datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë; 2. "Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr. 1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 37/ Neni 12. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt:"Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi

Nr. 1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Lartësia e objektit zhvillohet në lartësinë e dy kateve. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që lejët e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor dhe në Rregulloren e Planit të miratuar nga Bashkia Kuçovë, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.1439/1, datë 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë; 2. "Ndërtim Magazinë 1 kat mbi objekt ekzistues", për të cilën është marrë vendimi Nr.789/1, datë 17/03/2022, me zhvillues dhe aplikues MF, në fshatin Perondi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me të Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 22, Plani i detajuar vendor, me Planin e Detajuar Vendor të njësisë strukturore 4/104, me Vendimin Nr. 7, datë 31.03.2021, të hartuar nga Bashkia Kuçovë; me Rregulloren e Planit të Detajuar Vendor të Njësisë strukturore 4/104, të miratuar nga Bashkia Kuçovë, me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 29, Nënndarja e parcelës për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, sipas Rregulloren e Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Stallë për mbarështimin e lopëve për prodhim qumështi dhe ambiente ndihmëse", për të cilën është marrë vendimi Nr.733/1, datë 09/03/2022, me zhvillues dhe aplikues FA-2021, në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë; 2."Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr.1854/1,datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë; 3. “Ndërtim Lokal Shërbimi 1kat + Ndërtim Fushë futbollit” me zhvillues Z. R.Z dhe Z. E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr.1307/1,datë 22/04/2022, Nr.3933/1,me datë 19/12/2018; Nr.3762/1 prot., datë 13/11/2019; me Nr. 1044/1 prot., datë 08/04/2020. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 10/1, Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi dhe Neni 14. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20.1.Rekomandimi:Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohet e njëjta situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, përkatësisht në lejen e ndërtimit

të miratuar me objekt:1."Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregtim produktesh bujqësore 2 kat",për të cilën është marrë certifikatë përdorimi me Vendimin Nr.1420/1, datë 10/05/2021, me zhvillues dhe aplikues EB, në fshatin Kozare, Kuçovë; 2."Objekt shërbimi dhoma zhveshje", për të cilën është marrë vendimi Nr.2123/1, datë 07/07/2021, me zhvillues dhe aplikues R.Z dhe E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Rregullores e Planit të Përgjithshëm të Territorit, të miratuar me Vendimin të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2, datë 29.12.2016 dhe me Vendimin Nr.283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendjen e duhur aplikimin e lejeve të ndërtimit në mënyrë që tipologjia e ndërtimit të jetë në përputhje me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm. Gjithashtu Bashkia Kuçovë dhe strukturat përkatëse të marrin masa për të ndjekuar zhvillimin e lejeve të miratuara edhe gjatë fazave të zbatimit, në mënyrë që tipologjia e ndërtimit dhe objekti të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriterë të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: "Ndërtim lokal shërbimi 1 kat + Ndërtim Fushë futbollit" me zhvillues Z.R.Z dhe Z.E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr.3933/1, me datë 19/12/2018 dhe leja me Nr. 1044/1 prot., datë 08/04/2020. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 15, Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi të mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatua 1 praktikë në të cilën u evidentua mungesa e pajisjes me "Certifikatë përdorimi" të objektit pasi ishte në përdorim, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: "Ndërtim lokal shërbimi 1 kat + ndërtim fushë futbollit" me zhvillues Z.R.Z dhe Z.E.D, në fshatin Tapi, Kuçovë, për të cilën janë marrë vendimet për miratim Nr.3933/1, me datë 19/12/2018 dhe leja me Nr.1044/1 prot., datë 08/04/2020. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Neni 52 dhe me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1.Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Kuçovë të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejohet përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të "Certifikatave të përdorimit" u konstatuan 2 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara, përkatësisht në lejen e

ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Magazinë për përpunimin e xhamit", për të cilën është marrë vendimi Nr.1854/1, datë 07/06/2021, me zhvillues dhe aplikues P.G, në fshatin Perondi, Kuçovë; 2."Ndërtim Magazinë 1 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.1439/1, date 23/05/2022, me zhvillues dhe aplikues FK, në fshatin Perondi, Kuçovë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjit Nr.107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 42/ Certifikata e përdorimit dhe me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 27. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

24.1.Rekomandimi: Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Kuçovë të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të zhvillimeve të ndërtimit, u konstatua 1 praktikë e cila nuk ishte pajisur me deklaratë paraprake punimesh. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 51, Inspektimi dhe me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 111-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

25.1.Rekomandimi: Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Kuçovë të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.Gjetje nga auditimi: Në auditimin mbi plotësimin e kriterëve arsimore për punonjësit e IMT-së, u konstatuan 3 punonjës të cilët nuk plotësonin kriteret e nevojshme për formimin arsimor të tyre. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme", Neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 125-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

26.1.Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Kuçovë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Zbatimi i realizimit të punimeve të ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 51 dhe me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 125-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

27.1.Rekomandimi:Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

28.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me përdorimin e objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi dhe

ndryshimi i destinacionit të përdorimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit të miratuar. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 125-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

28.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan 2 praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 125-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

29.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

30.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kuçovë për planifikimin e taksës për tokën bujqësore, rezultoi se kjo taksë është planifikuar 13,056,000 lekë për vitin 2022. Nga përlllogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore, u konstatua se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2022 është bërë për 1,194,120 lekë më tepër. Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

30.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksat e tokës bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

31.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së të Ardhurave Vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Kuçovë dhe NJA për vitin 2022 janë taksuar 12286 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2022 janë taksuar 6376 familje më pak.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kuçovë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 700 lekë * 6376 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,463,200 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DAV Bashkia Kuçovë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018³⁸, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe

³⁸ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kreu II në Paketën Fiskale të Bashkisë Kuçovë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

31.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

B.1. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se janë lënë 18 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 3 janë zbatuar, 1 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 11 nuk janë zbatuar; Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 3 rekomandime në vlerën 111,674 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë në proces zbatimi; Është dhënë 1 masë disiplinore, e cila nuk është zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 125-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Konkretisht rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve në proces, si më poshtë vijon:

B.1. MASA ORGANIZATIVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit. Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Deri më 31.10.2022

1.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme, duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, si dhe të hartohet program për trajnimin dhe për ngritjen profesionale të stafit.

Deri më 31.10.2022

2.2. Rekomandim: Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e kartës së auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë e të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit të AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Kuçovë

Deri më 31.10.2022

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për raportimin në MFE për të gjitha detyrimet e prapambetura, pavarësisht burimit të tyre të financimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

8.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) “Aktive afatgjata materiale” e llog. (109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Gjithashtu të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Deri më 31.10.2022

9.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në “Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA dhe 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport “N” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitale të veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Kuçovë me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

Gjithashtu DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa për përditësimin e të dhënave me dokumentacionin e nevojshëm, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobot dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

Deri më 31.10.2022

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, me shkresat nr. 98/17 datë. 14.09.2021 dhe shkresat nr. 678/35 datë. 05.08.2021, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të hartojë plan pune të veçantë për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për 11 masa organizative, konkretisht sipas shkresës nr. 98/17 datë. 14.09.2021 rekomandimet nr. (1,2,3,4,11,12 dhe 13) dhe sipas shkresës nr. 678/35 datë. 05.08.2021 rekomandimet nr. (2,3,4 dhe 7);

b-Për 6 masa shpërbllim dëmi në vlerën 1,272 mijë lekë, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Për një masë në vlerën 358,448 mijë lekë për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-^{ve}, si dhe 1 masë në vlerën 13,527 mijë lekë të ardhura të munguara.

Menjëherë

15.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallit të ofruar nga operatorët ekonomik të shpallur fitues, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të verifikojë nëse malli plotëson ose jo të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në ftesën për ofertë dhe këtë verifikim ta paraqes imtësisht në procesverbalin e

mbajtur për këtë qëllim. Në rastet kur malli nuk i plotëson të gjitha specifikimet e kërkuara, të përcaktohet në procesverbal se cilat janë ato specifikime.

15.2. Rekomandim: Në rastet e ngritjes së komisioneve për shqyrtim të ankesës të bërë nga operatorët ekonomik, të merren masa që komisioni të verifikojë saktë pretendimet e ankimesit, jo duke u mbështetur në konkluzionet e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, por në verifikimin faktik të mallit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kuçovë në vlerën **1,512,112 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i librezës së masave për shkollën Fshati Tapi, u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit 1.3 “Prishje çati ekzistuese” dhe I.12 “Çati vendi e zakonshme HD deri 8 m, mbuluar me tjegulla vendi”, është certifikuar sasia 492 m². Nga përlogaritjet rezulton se sipërfaqja faktike është 478 m². Gabimi në llogaritje ka ardhur si pasojë e përfshirjes së strehës në mesin e çatisë, nga llogaritja e sipërfaqes me dy seksione. Vlera **67,550 lekë** [14 m² (495 lekë/m² + 4,330 lekë/m²)] është certifikuar padrejtësisht.

- Sipas zërit 1.10 “Shtresë mermeri 2 cm Janina”, është përlogaritur sasia duke marrë në konsideratë gjatësinë e dritareve 1.6 m, ndërkohë që referuar zërit furnizim dhe vendosje dritare gjatësia është 1.45 m. Sasia 3.5 m² (10 ml x 0.35 ml), me vlerë **18,165 lekë** (3.5 m² x 5,190 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

Nga verifikimi i punimeve në objekt u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Në shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi, nuk është realizuar zëri i punimeve 3.58 “F.V shtylla metalike për ndriçim H = 7 m, d = 160 mm” në sasinë 10 copë. Vlera **188,540 lekë** (10 copë x 18,854 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit 3.59 “Ndriçues smart 250 w, 230 v”, nga 10 të parashikuar janë vendosur vetëm 4. Vlera **140,316 lekë** (6 copë x 23,386 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht.

Nuk janë punimet sipas zërit 3.65 “F.V puseta plastike 40 x 40 cm”. Vlera 33,990 lekë (10 copë x 3,399 lekë/copë), është certifikuar padrejtësisht. Sipas zërit 3.56 “Konstruksione metalike të thjeshta për portën hyrëse”, është certifikuar sasia 1 ton. Nga përlogaritjet mbi dimensionet e realizuara në objekt, rezulton se pesha faktike është 0.19 ton. Vlera **108,345 lekë** (0.81 ton x 133,760 lekë/ton), është certifikuar padrejtësisht. Nga verifikimi sipas zërit 3.49 “Shtresë asfaltbetoni me ngjyrë, t = 4 cm...”, rezulton se nuk është realizuar shtresë asfaltbetoni, por shtresë betoni, me një shtresë boje në sipërfaqe të saj. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike dhe përcaktimet në projektin e zbatimit. Bazuar në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manueleve teknike të çmimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, sipas zërit 2.262/4 “Shtresë betoni C 16/20” është përcaktuar çmimi 8,525 lekë/m³. Referuar trashësisë 4 cm, çmimi 8,525 lekë i korrespondon sasisë 25 m², duke përcaktuar një çmim të përafërt 341 lekë/m³. Duke marrë në konsideratë lyerjen e sipërfaqes së betonit sipas zërit 2.237/a “Lyerje beton me hyperdesimo”, çmimi përcaktohet 797 lekë/m². Në këto kushte, punimet e realizuara konsiderohen me çmim 1,138 lekë/m² (341 lekë/m² + 797 lekë/m²). Vlera **123,060 lekë** [420 m² x 1,431 lekë/m² – 1,138 lekë/m²], është certifikuar padrejtësisht.

Nuk janë realizuar zërat 3.52 “F.V porta + rrjetë basketbolli” copë 2 dhe 3.53 “F.V tabelë + rrjet voleybolli”, copë 1. Vlera **157,060 lekë** (125,380 lekë + 31,680 lekë), është certifikuar padrejtësisht.

- Nga verifikimi i punimeve në Kopshtin e Fshatit Tapi, rezulton se nuk janë realizuar punimet sipas zërit 5.87 “Shtresë me pllaka grez porcelanato”, në sasinë 46 m². Pllakat e shtruara nuk janë sipas specifikimeve dhe janë realizuar me punime të kryera më parë në këtë objekt. **Vlera 100,096 lekë** (46 m² x 2,176 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

Nga verifikimi i punimeve në Shkollën 9 vjeçare të Fshatit Vodëz, rezulton se fusha e basketbollit nuk është realizuar me asfalt me bojë, por shtresë betoni, me lyerje në sipërfaqe. **Vlera 123,060 lekë** [420 m² x (1,431 lekë/m² – 1,138 lekë/m²)], është certifikuar padrejtësisht.

- Sipas zërit 10.167 “F.V kanxhella rrethimi” ishte parashikuar që mbi muret prej betoni të rrethimit të vendoseshin kanxhella me çmim 2,394 lekë/ml. Nga verifikimi i punimeve rezulton se në vend të kanxhellave, është ndërtuar mur me blloqe betoni, në lartësi nga 70 deri 90 cm, me gjerësi 20 cm. Bazuar në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit pika 2.88 “Mur me blloqe betoni 20 cm, deri në 3 m...”, çmimi për këtë zë punimi është 7,395 lekë/m³, ose 1,479 lekë/m². Duke marrë në konsideratë lartësinë mesatare 80 cm, për çdo metër rrethim është ndërtuar 0.8 m² mur me blloqe betoni. Çmimi i referencës duhet të jetë 1,183 lekë/ml (1,479 x 0.8). **Vlera 226,420 lekë** [187 ml x (2,394 lekë/ml – 1,183 lekë/ml)], është certifikuar padrejtësisht. Nga verifikimi i disa zërave të realizuar në objekt u konstatuan diferenca si më poshtë: Nga verifikimi sipas zërit 10.175 “F.V shtylla metalike për ndriçim”, rezulton se nuk është realizuar vendosja e 7 shtyllave të parashikuara. **Vlera 131,978 lekë** (7 x 18,854 lekë/copë). Po ashtu nuk janë vendosur ndriçuesit smart. **Vlera 163,702 lekë** (Vlera 7 copë x 23,386 lekë), është certifikuar padrejtësisht. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për zbritjen në situacionin përfundimtar dhe pagesën përkatëse të vlerës **1,512,112 lekë**, certifikuar më tepër kontraktorit “A” Sh.P.K.

Menjëherë

C. MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore në datën 31.12.2022 është 23,346,297 lekë për 592 subjekte, që përfshin debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 dhe të viteve të mëparshme, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar 82 subjekte debitor për vlerën 1,850,387 lekë. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga DAV Bashkia Kuçovë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës sigurose për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për 65% të debitorëve të rezultuar, por nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **23,346,297 lekë** për **592** subjekte (principal dhe kamatë vonesë).

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kuçovë me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përlogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përlogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 84 subjekte debitorë për vlerën 965,162 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 116 subjekte për vlerën 21,717,246 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Gjithashtu u konstatua se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Lidhja 2, tabela 2 në VKM nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar; Paketa fiskale e vitit 2022, pika 17, shkronja “b”; Neni 3 dhe neni 4 në Ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 21,717,246 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2.2.Rekomandimi: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitorë për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është 15,579 mijë lekë për 544 subjekte, nga të cilat 223 subjekte për vlerën 6,483 mijë lekë janë krijuar në vitin 2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Kuçovë, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Kuçovë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t’i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës debitorë prej 15,579 mijë lekë.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezulton se përgjatë vitit 2022 në territorin e Bashkisë Kuçovë dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregëtimin e karburantit nga 15 stacione shitje. Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 3 prej tyre për një periudhë 1-2 vite është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Në fund të vitit 2022, gjithsej rezultojnë 3 subjekte debitor për vlerën 1,500 mijë lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Kuçovë, si rrjedhojë e mosrilecencimit/moslikuidimit të tarifës së licencimit të tregëtimit të karburantit. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga DAV dhe Policisë Bashkiake. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017. Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. Rregullore e brendshme e Bashkisë Kuçovë “Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit”, pika 1, si dhe shkronja d, si dhe “Policia Bashkiake”, neni 5 dhe neni 8; Pika 10 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kuçovë, për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.

4.2.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,500 mijë lekë.

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kuçovë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kuçovë) u konstatua se nga DAV, Drejtoria e Mjedisit, si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Kuçovë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përllogaritjet e kryera rezulton se për vitin 2022 në 8 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit në vlerën 534,934 lekë gjithësej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun II, pika 2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kuçovë të vitit 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 534,934 lekë.

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022, u konstatua se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3578 familje debitorë për vlerën 52,670,603 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë krijuar 3222 familje debitorë për vlerën 1,613,391 lekë. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifave për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultoi se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Kuçovë, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A Berat –Kuçovë, i cili vepron si agjent tatimor për llogaritë të Bashkisë Kuçovë. Përjashtuar familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Sa i përket familjeve debitorë, rezultoi se nga DAV dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Berat –Kuçovë, për arkëtimin e tyre.

6.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare prej 52,670 mijë lekë.

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kuçovë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive vlera debitorë është 18,593,279 lekë dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3285 familje debitorë për vlerën 22,337,349 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 është krijuar 3,744,070 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksën e tokës bujqësore, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kuçovë në arkëtimin e kësaj takse. Sa i përket familjeve debitorë, rezultoi se nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitorë. DAV Bashkia Kuçovë arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari ose personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë bashkisë për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-47, të Raportit Përfundimtar të*

Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 22,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kuçovë, gjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, ka marrë 21 vendime për "Dënim me gjobë", ndër të cilat 6 janë likuajduar, ndërsa 15 nuk janë arkëtuar pasi janë në proces gjyqësor, me vlerë debitore 3,450,000 Lekë. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligji Nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar; Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" neni 9/neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 125-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Kryeinspektori i IMTV Kuçovë, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbauesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa) të palëve të treta ndaj Bashkisë Kuçovë. Për çdo rast, kur nga përmbauesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, Bashkia Kuçovë t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penaltitetet ndaj përmbauesve.

V.ANEKSE

Aneksi nr.1 – Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin trajtuar nga faqja nr.15 deri në faqen nr.18 të raportit përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1: *“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.*

- Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Për vitin 2022 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme e cila nuk është e protokolluar në Bashkinë Kuçovë por është e miratuar nga ish Kryetari i Bashkisë z. S. K. në vitin 2018.

Për vitin 2022 numri i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.31, me nr. 4181 prot., datë 17.12.2021 si dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 86 datë 23.12.2021 “Mbi kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar për punonjësit e bashkisë dhe të njësisve shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat.

-Struktura organizative ka pësuar ndryshime nga viti në vit nga të cilat janë krijuar shumë drejtori/ sektorë dhe agjenci. Nuk janë përcaktuar ndarja e detyrave konkrete ligjore që do kryhet dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti si dhe të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Këto drejtori/ sektorë nga ana e tyre nuk kanë hartuar rregullore të veçantë të funksionimit të tyre çka bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi rregullorja aktuale që qarkullon në bashki nuk i ka të përcaktuara detyrat për funksionet e reja që i janë deleguar nga qeverisja qendrore, njësit administrative të krijuar në zbatim të reformës territoriale, pavarësisht se në rregulloren aktuale që përdoret ka përshkrim të detyrave për disa nga drejtorit kryesores si: Drejtoria e të Ardhurave Lokale, Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik etj.

- Nga institucioni nuk ka program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk është përcaktuar procedura e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, si dhe nuk janë përcaktuar detyrat për njësinë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Kuçovë për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrdhënieve me Publikun), duke i’u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrdhëniet e punës me Kod Pune. Për vitin 2022 janë kryer vlerësimet e punonjësve.

Në lidhje me parimin 2: *“Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.*

- Nga Bashkia Kuçovë nuk ka një Plan të Kontrollit të Brendshëm (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të

kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

- Për vitin 2022, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga struktura në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi të fondeve të alokuara.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3: *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.*

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar struktura e Bashkisë Kuçovë, ç’ka ndikon negativisht në linja të qarta raportimi, komunikimi dhe llogaridhënie.

- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht sektori i menaxhimit të kontratave me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit sa kontrata për punë publike janë lidhur, subjektet, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Kuçovë apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave. Kjo mangësi evidentohet edhe në mungesën e komunikimit ndërmjet sektorit të urbanistikës dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitetet në Bashkinë Kuçovë.

- Lidhur me strukturën organizative të Bashkisë Kuçovë, ndërmarrjes dhe institucioneve në varësi, përgjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndryshime.

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 86 datë 23.12.2021. Miratuar në total numri 374 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara konfirmuar nga prefekti i qarkut Berat, me shkresën nr. 03/2 prot., datë 14.01.2022, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

- Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

Në lidhje me parimin 4: *“Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave”.*

- Në Bashkinë Kuçovë nuk është hartuar *“Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”*, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme, por vetëm nga trajnimet e zhvilluara nga ASPA.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtore e Financës dhe Buxhetit.

Në lidhje me parimin 5: *“Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.*

- Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar *“Delegimi i kompetencave”* në zbatim të ligjit 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative”* si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi nuk ka patur raste të delegimit të detyrave.

- Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor”*, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 *“Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 *“Për proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”*, për vitin 2022 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaximit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Kuçovë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Nuk administrohen proçesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.

Në lidhje me parimin 6: *“Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”.*

- Nga Bashkia Kuçovë përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxhetet vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 *“Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”*.

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.*

- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Në Bashkinë Kuçovë nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

-Në Bashkinë Kuçovë nuk është krijuar regjistri i riskut.

-Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të proçesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Mbetet problematike menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorat e drejtorive përkatëse të institucionit.

Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar ku citohet se: *“Titullari*

i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

- Në Bashkinë Kuçovë, Sektori i Financës dhe Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.*

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.*

Bashkia Kuçovë nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhërshpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e

inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Kuçovë, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

- Bashkia Kuçovë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.*

- Bashkia Kuçovë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Komunitetin.

- Në Bashkinë Kuçovë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Në strukturën e Bashkisë Kuçovë është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

Në lidhje me parimin 12: *“Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.*

- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, kjo evidentuar nga lista e projekteve në PBA 2022-2024, të cilët nuk i nënshtrohen një analize kosto-përfitim.

- Ekzistojnë procedurë kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedurë janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e sektorit të financës.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *“Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.*

Bashkia Kuçovë disponon faqen e saj zyrtare në web www.bashkiakucove.gov.al ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut,

planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë.

Për vitin 2022 nga Bashkia Kuçovë (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajshme me qira, buxhetin etj.), janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit por mungon dokumenti justifikues i konsultimeve publike.

Në lidhje me parimin 14: *“Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor”*. Në rregulloren e brendshme nuk janë parashikuar mënyrat e komunikimit brenda institucionit.

Në lidhje me parimin 15: *“Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”*.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email. Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”*.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia Kuçovë lidhur me pyetëtorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2022 nuk e ka raportuar në MFE.

-Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në lidhje me parimin 17: *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”*.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa proçedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Në rregulloren e brendshme nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, si përshëmbull shkëmbimin e informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet të cilat janë pajisur me leje për

kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitetet në Bashkinë Kuçovë.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Kuçovë për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

-Për vitin 2022 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Në Bashkinë Kuçovë nuk është hartuar “Harta e procesit për proceset kryesore të veprimtarisë së institucionit”.

-Për vitin 2022 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

“Menaxhimi i Riskut”

-Nuk është hartuar rregjistri dhe strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e të cilave të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Kuçovë.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengojn marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

-Në Bashkinë Kuçovë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program kontabiliteti. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL.

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Kuçovë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Aneksi nr.2 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.21 deri në faqen nr.47 të raportit përfundimtar të auditimit.

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr.	Emërtimi i Objektivit	Data e lidhjes së kontratës	Numri i faturës	Data e Fatutës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit	Shlyerjet gjatë vitit	Gjendja 31.12.2022
1	Rikonstruksion i rrugës "Murat Daulle	14.01.2021	16	31.08.2021	12,998,780		12,998,780	0
	Rikonstruksion i rrugës "Murat Daulle	14.01.2021	3	29.03.2022		22,457,741		22,457,741
2	Rikualifikim urban i lagjes "Li.Prifti"	04.02.2021	13	30.04.2021	6,000,000		6,000,000	0
	Rikualifikim urban i lagjes "Li.Prifti"	04.02.2021	18	31.05.2021	5,500,000		5,500,000	0
	Rikualifikim urban i lagjes "Li.Prifti"	04.02.2021	91	31.08.2021	21,360,000		21,360,000	0
	Rikualifikim urban i lagjes "Li.Prifti"	04.02.2021	116	30.09.2021	8,156,400		6,239,000	1,917,400
	Rikualifikim urban i lagjes "Li.Prifti"	04.02.2021	150	30.10.2021	5,541,600		0	5,541,600
	Rikualifikim urban i lagjes "Li.Prifti"	04.02.2021	56	29.03.2022			5,950,120	5,950,120
3	Ndërtim i shkollës 18 Tetori	04.07.2019	79298358	31.03.2020	9,996,223		9,996,223	0
4	Rikualifikim urban i lagjes 1 Maj	16.01.2019	46396177	30.06.2019	62,288		62,288	0
			43696193	06.12.2019	34,337,712		34,337,712	0
5	Përmirësim i banesave për familjet në nevojë	30.07.2021	56	21.06.2022		1,599,767		1,599,767
6		19.05.2015	19153382	30.06.2016	105,600			105,600
	Totali i detyrimit				104,058,603	24,057,508	102,444,123	37,572,228

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për mallrat dhe shërbimet (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr.	Emërtimi i Objektivit	Data e lidhjes së kontratës	Numri i faturës	Data e Fatutës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1.	Qendra Ekonomike e Arsimit							
	Blerje produkte ushqimore dhe materiale pastrimi	12.04.2018	143	30.09.2021	325,068		325,068	0
	Blerje produkte ushqimore dhe materiale pastrimi	12.04.2018	192	28.10.2021	389,766		389,766	0
			271	28.11.2021	412,725		412,725	0
	Blerje gazoili	13.03.2019	9	22.11.2021	16,085		16,085	0
	Blerje gaz i lëngshëm	Blerje e vogël	168	08.09.2022		19,530		19,530
			190	04.10.2022		70,794		70,794
	Materiale të tjera e të përgjithshme	Blerje e vogël	127	16.09.2022		53,200		53,200
	Materiale të tjera e të përgjithshme	Blerje e vogël	38	10.10.2022		30,000		30,000
	Blerje kancelarie	Blerje e vogël	306	20.20.2022		160,000		160,000
	Transport i nxënësve	14.02.2022	448	02.08.2022		300,000		300,000
2.	Bashkia							
	Komisioni Ad hoc				40,000			40,000
	Mirëmbajtje e varrezave publike	01.11.2021	50	26.11.2021	100,170		100,170	0
	Mirëmbajtje e varrezave publike	01.11.2021	141	31.10.2022		55,995		55,995
	Mirëmbajtje e veprave ujore	22.12.2021	1	18.01.2022		238,800		238,800
3.	Ndërmarrja Komunale							
	Shpenzime per mirembajtjen e rrugeve Rurale	08.08.2018	96	12.05.2021	419,000		419,000	0
	Shpenzime per mirembajtjen e rrugeve Rurale	08.08.2018	249	18.11.2021	224,400		224,400	0
	Totali i detyrimit				1,927,214	928,319	1,887,214	968,319

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet (Nga transferta të kushtëzuara, si investime nga Ministri të linjës, FSHZH)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Data e lidhjes së kontratës	Numri i faturës	Data e Faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Ndërtim i ujësjellesit në 7 fshatra, Lumas	08.02.2021	570	04.08.2022	13,106,858		13,106,858	0
		08.02.2021	293	29.07.2022		50,781,030	19,149,339	31,631,691
		08.02.2021	420	14.10.2022		100,537,947		100,537,947
	Përmirësim i banesave të familjeve në nevojë	03.08.2020	1	27.02.2021	1,073,983		1,073,983	0
		24.12.2014	03783172	17.04.2016	72,000			72,000
		12.07.2013	09635344	12.05.2016	14,820			14,820
	Përmirësim i banesave për familjet në nevojë	08.10.2021	56	21.06.2022		2,269,381		2,269,381
	Supervizim i ujesjellesit Lumas	15.12.2020	81	08.11.2022		1,196,195		1,196,195
	Detyrime për shpërbllim lindje (Min. Brendshme për punonjës të GJ.Civile)				3,920,000			3,920,000
	Totali i detyrimit				18,187,661	154,784,553	33,330,180	139,642,034

Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërbllim page, për punonjësit e larguar nga puna

Objekti i Vendimit	Vendime të ardhura gjatë vitit 2022		Likuiduar gjate vitit 2022	Mbetja date 31.12.2022
	Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit		
2	3	4	5	6=4-5
Shpërbllim dëmi nga zgjidhja e kontratës së menjëhershme të punës.	Nr. 236, dt. 12.10.2022	438,720		438,720
Shpërbllim dëmi nga zgjidhja e kontratës së menjëhershme të punës.	Nr. 26, dt. 07.12.2022	587,570		587,570
		1,026,290		1,026,290

Aneksi nr.3 – Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave trajtuar nga faqja nr.21 deri në faqen nr.47 të raportit përfundimtar të auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore

Emërtimi	Viti 2022	
	Plan	Fakt
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biz. e vogël	500,000	487,054
Ndërtesa banimi	7,130,000	4,580,981
Ndërtesa të tjera	4,318,000	3,297,429
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	13,056,000	6,017,860
Të ardhura nga taksa mbi truallin	19,080,000	18,944,910
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	200,000	84,105
Taksa e ndikimit në infr. nga ndërtimet e reja dhe legalizimet	7,000,000	8,306,439
Takse Tabele	600,000	350,802
Takse Reklame	130,000	377,405
Taksa per qarkullimin e mjeteve të përdorura	15,000,000	15,273,270
Taksa pronësisë për pasuritë e paluajtshme		3,492
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	4,700,000	10,414,563
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	2,300,000	4,152,221
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje	11,920,000	8,642,671
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione	11,193,000	10,801,000
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	14,013,000	13,899,335
Të ardhura për ndriçimin publik nga Familje	7,142,000	5,187,745
Të ardhura ndriçimi publik nga Institucione	384,000	320,000
Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	3,774,000	2,823,676
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	2,900,000	2,104,976
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione	2,960,000	6,291,000
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	4,331,000	3,243,460
Të ardhura nga tarifa për arsim nga Familje	3,500,000	2,542,730
Të ardhura nga tarifë arsimit nga Institucione	121,000	81,000
Të ardhura nga tarifë arsimit nga Biznesi	1,015,000	1,145,808
Nga Tarifatat e licencimit të transportit	400,000	228,470
Nga tarifa parkimi.	350,000	349,000
Nga tarifë dhënie licensa për tregtimin e naftës.	2,020,000	1,820,000
Nga tarifa e ndotjes	34,822,000	31,820,400
Nga tarifa e mirembajtjes se kanal.kullues	2,330,000	867,167
Nga shfrytëzimi I lendeve drusore	700,000	206,500
Te ardhura nga qera toke bujqësore	2,478,000	2,207,840
Te ardhura nga qera toke pyjore	1,300,000	184,090
Nga tarifatat e shërbimeve që kryen e MNZ	-	246,000
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	9,405,000	7,861,339

Tarifa nga kopshtet	3,480,000	3,196,610
Tarifa nga cerdhet	1,500,000	1,481,940
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	-	2,013,493
Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve (Q.Objekt)	-	10,000
debitor	10,073,000	10,617,990
T.priv.banese	2,000,000	-
Q.ban.social	350,000	-
T.miremb.varreza	500,000	-
Energy	-	361,407
Vertetim	-	106,470
Cert.perd	-	631,470
T.vend.per ujin	-	109,140
T.kontr.territori	-	90,000
T.piketim objekt	-	10,000
Kamatvonesa, sekuestrime	-	70
Sponsorizime	-	9,860,211
TOTAL	208,975,000	203,653,539

Burimi: DAV Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tarifa e ndotjes së mjedisit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private³⁹, për 2022

Nr	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	Vlera e tenderit/Sip e punimeve	Vendndodhja	Kohëzgjatja e punimeve		Tarifa e ndotjes Sipas vlerës së tenderit/150 lekë/m ² /12 muaj (Lekë)
				Statusi 31.12.2022		
				Filluar	Mbaruar	
1	Ndërtim i ujesjellesit: Lumas, Pellumbas	422,451,858	Bashkia Kuçovë, NJA Lumas dhe Perondi	12.03.2021	Proces	100,000
2	Permiresim i banesave egzistuese per komunitete te varfra e te pafavorizuara	14,998,837	Bashkia Kuçovë	18.10.2021	18.02.2022	100,000
3	Ndërtim banesa sociale, shtese kati	26,842,505	Bashkia Kuçovë	19.10.2022	Proces	100,000
4	Ndërtim magazine –	495 m ²	Bashkia Kuçovë	15.06.22	17.10.22	24,750
5	Magazine	1200 m ²	Bashkia Kuçovë	02.07.2021	06.05.2022	165,000
6	Magazine Bujqesore	247.5 m ²	Bashkia Kuçovë	02.08.22	Proces	15,468
7	Ndërtim magazine	81.13 m ²	Bashkia Kuçovë	02.11.21	08.09.22	10,141
8	Godine Banimi	87 m ²	Bashkia Kuçovë	22.06.2021	Proces	19,575
Total						534,934

Burimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e të Ardhurave dhe Njësia e Prokurimit, Bashkia Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.6 – Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm trajtuar nga faqja nr.133 deri në faqen nr.138 të raportit përfundimtar të auditimit.

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër :					Nga rekomandimet gjithsej:				Sa me dëme ekonomike			
		Rekom. gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(Në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1	Masa organizative	18	3	2	2	11								
2	Masa efekt adm. e fondeve publike	3			3			111,674				111,674		
3	Masa disiplinore	1			1									
Totali		22	3	2	5	12		111,674				111,674		

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për efekt. Adm. Fondeve publike			
Rekomanduar Gjithsej	Zbatuar	(Në proces)	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
111,674		111,674	

³⁹ Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi për llogari të investitorit privat.

Aneksi nr.7 – Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, trajtuar nga faqja nr.111 deri në faqen nr.125 të raportit përfundimtar të auditimit.

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje			
Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i lejeve të miratuara
1	Certifikatë përdorimi	31	28
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	130	122
3	Leje infrastrukture	6	3
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	33	31
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	7	5
6	Leje për ndryshim funksioni	1	1
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	2
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	2	1
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	0	0
11	Leje zhvillimi	57	57
12	Njoftim për fillim punimesh	33	33
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	0	0
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ²	9	8
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	3	3
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	4	3
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	1	1

Lejet e ndërtimit

Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Leja e ndërtimit	Data e lejes së ndërtimit	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi sipas subjektit
1	Ndërtim Magazinë 1kt	1439/1	23/05/2022	495	11,711,671
2	Stallë për mbarëshkrimin e lopëve për prodhim qumeshi dhe ambiente ndihmëse	733/1	9/5/2022	1026	37,185,811
3	Magazinë për përpunimin e xhamit	1854/1	10/6/2021	1200	18,068,160
4	Ndërtim shtesë kati	3162/1	17.10.2022	729.3	23,540,598
5	Ndërtim Magazinë 1 kt mbi objekt ekzistues	789/1	17/03/2022	383.76	3,772,883
6	Ndërtim shtese kati	2994/1	21/09/2021	720	10,171,968
7	Ndërtim Magazinë bujqesore	3284/1	18/11/2022	81	2,147,603
8	Ndërtim objekt banimi	2828/1	26/09/2022	105	3,672,681
9	Ndërtim objekt banimi 2kt	2645/1	9/9/2022	165	5,886,826
10	Ndërtim objekt banimi	1891/1	30/06/2022	81	3,058,054
11	Ndërtim objekt banimi	1671/1	29/06/2022	81	3,037,092
12	Magazinë bujqesore	1438/1	23/05/2022	247.5	6,296,434
13	Rikonstruksion+ ndërtim shtese anesore	1339/1	13/05/2022	76.44	1,528,721
14	Objekt grumbullimi, perpunimi te produkteve bujqesore	1307/1	22/04/2022	249	3,533,362
15	Ndërtim Magazinë	1092/1	6/5/2022	171	4,047,077
16	Ndërtim Magazinë 1kt	1091/1	6/5/2022	90	3,510,559
17	Ndërtim objekt banimi	989/1	11/4/2022	105	4,592,473
18	Ndërtim Magazinë	627/1	4/3/2022	221	5,462,443
19	Ndërtim Magazinë	54/1	21/02/2022	112	2,558,382
20	Ndërtim objekt banimi	4270/1	24/01/2022	72	3,058,088
21	Ndërtim objekt sherbimi 1kt	4229/1	10/1/2022	47	2,369,489
22	Objekt grumbullimi, perpunimi te produkteve bujqesore	3394/1	19/10/2021	81	2,499,797
23	Ndërtim objekt banimi	3163/1	28/09/2021	72	4,384,688
24	Objekt grumbullimi, perpunimi te produkteve bujqesore	2655/1	12/8/2021	140	3,257,073
25	Ndërtim objekt banimi 2kt	2312/1	19/07/2021	71.49	1,955,518
26	Ndërtim objekt banimi	2229/1	5/7/2021	99.75	2,312,164
27	Ndërtim Magazinë	2028/1	24/06/2021	81.13	15,785,177
28	Ndërtim objekt banimi	1857/1	7/6/2021	105	2,884,934
29	Ndërtim objekti 2kt mbi toke dhe 1 kt nentoke	1701/1	25/05/2021	172.4	7,396,710
30	Objekt grumbullimi, perpunimi te produkteve bujqesore	1572/1	17/05/2021	163	2,248,324
31	Godine Banimi	1542/1	14/05/2021	87	500

32	Ndërtim objekt banimi 1kt	1281/1	14/04/2021	99.75	2,325,771
33	Ndërtim objekt banimi 1kt	1048/1	25/03/2021	94	2,716,332
34	Ndërtim objekt banimi 2kt	1027/1	26/03/2021	157.59	6,038,596
35	Ndërtim objekt banimi 1kt	579/1	18/02/2021	99	2,729,021
36	Ndërtim Grop Septike	525/1	22/02/2021	245	2,329,300
37	Ndërtim shtese anesore	148/1	2/2/2021	65.14	2,103,529
38	Ndërtim Shtese kati	2963/1	3/10/2022	88	2,828,169
39	Ndërtim Shtese kati	890/1	29/03/2022	93	2,816,928
40	Ndërtim Shtese kati	626/1	17/03/2022	45.9	1,387,219
41	Ndërtim Shtese kati Magazinë	2522/1	29/07/2021	96	2,658,667
42	Ndërtim Shtese kati	2392/1	27/07/2021	111.5	1,791,060
43	Rikonstruksion +shtese 1t	2313/1	13/07/2021	16	1,266,517
44	Ndërtim shtesë kati	1321/1	6/5/2021	79.1	2,116,124
45	Ndërtim shtesë kati	2829/1	28/09/2022	83.8	2,828,169
46	Rikonstruksion objekti	3887/1	28/12/2021	74.9	2,000,147
47	Permirsimi objekteve ekzistuese per komunitete e pafavorizuara	3453/1	18/10/2021	x	20,835,657
48	Rikonstruksion objekti	2678/1	24/09/2021	108	2,180,040
49	Rikonstruksion garazhdi+ cati	608/1	1/3/2021	129	1,293,955
50	Rikonstruksion objekti	391/1	1/3/2021	61	2,890,039
51	Ndryshim destinacioni nga apartament ne njesi tregtare	3419/1	17/11/2022	50	243,243

Certifikata përdorimi

Nr.	Objekti	Nr. certifikatës	Data e miratimit
1	Magazinë	3703/1	20.12.22
2	Magazinë	3379/1	15.11.2022
3	Magazinë	2964/1	17.10.2022
4	Shtëpi banimi	2163/1	14.07.2022
5	Magazinë	1911/1	16.08.2022
6	Magazinë	1435/1	19.05.2022
7	Magazinë	591/1	04.04.22
8	Shtëpi banimi	374/1	09.02.22
9	Shtëpi banimi	143/1	08.02.2022
10	Shtëpi banimi	136/1	08.02.2022
11	Shtëpi banimi	138/1	08.02.2022
12	Shtëpi banimi	4239/1	24.02.2022
13	Magazinë	3870/1	24.11.2021
14	Shtëpi banimi	3800/1	1/12/2021
15	Magazinë	3787/1	28/12/2021
16	Stallë	3785/1	19/11/2021
17	Njësi shërbimi	3595/1	9/11/2021
18	Magazinë	3481/1	16/11/2021
19	Shtëpi banimi	3164/1	18/11/2021
20	Shtëpi banimi	2681/1	1/9/2021
21	Shtëpi banimi	2330/1	27/07/2021
22	Shtëpi banimi	2250/1	7/7/2021
23	Shtëpi banimi	2213/1	7/7/2021
24	Njësi shërbimi	2123/1	7/7/2021
25	Shtëpi banimi	1623/1	14/06/2021
26	Magazinë	1420/1	10/2/2021
27	Magazinë	1224/1	14/06/2021
28	Shtëpi banimi	70/1	25/01/2021

Aneksi nr.8 – Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IVMT), trajtuar nga faqja nr.125 deri në faqen nr.133 të raportit përfundimtar të auditimit.

Nr.	Vendim I gjobes	Date e gjobes	Gjobitur (leke)	Paguar	NR. Serial 00000	Gjendja e Gjobjës:	Nr. Vendimi Prishje
1	101	05.03.2021	500000		68	Proces gjyqësor	31.05.03.2021
2	102	10.03.2021	500000		69	Proces gjyqësor	32.10.03.2021
3	103	23.04.2021	50000		70	Proces gjyqësor	33.23.04.2021
4	104	07.05.2021	50000		71	Proces gjyqësor	34.07.05.2021
5	105	20.09.2021	50000		72	Proces gjyqësor	35.20.09.2021
6	106	23.09.2021	500000		73	Proces gjyqësor	36.22.10.2021
7	107	22.10.2021	500000		74	Proces gjyqësor	37.26.10.2021
8	108	26.10.2021	50000	50000	75	Paguar	
9	109	24.11.2021	500000		76	Proces gjyqësor	38.24.11.2021
10	110	14.12.2021	50000		77	Proces gjyqësor	39.14.12.2021
			2,750,000	50,000			

Nr.	Nr. Vendimi	Date e gjobes	Vlera e gjobes	Paguar	Nr. Serise	Gjendja e gjobes	Nr. Vendimi Prishje
1	111	07.01.2022	50000		78	Proces gjyqësor	40.07.01.2022
2	112	12.01.2022	50000	50000	79	Paguar	41.12.01.2022
3	113	13.01.2022	50000		80	Proces gjyqësor	
4	114	13.01.2022	50000	50000	81	Paguar	
5	115	13.01.2022	50000	50000	82	Paguar	
6	116	17.01.2022	100000	100000	83	Paguar	
7	117	18.01.2022	500000		84	Proces gjyqësor	42.18.01.2022
8	118	18.07.2022	50000		85	Proces gjyqësor	43.18.07.2022
9	119	05.10.2022	50000		86	Proces gjyqësor	44.05.10.2022
10	120	04.11.2022	300000	300000	87	Paguar	45.04.11.2022
11	121	16.12.2022	50000		88	Proces gjyqësor	46.16.12.2022
			1,300,000	550,000			

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT